



Funded by  
the European Union



Regional Cooperation Council

# Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje në Ballkanin Perëndimor: tendencat kyçe dhe shqetësimet kryesore







Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), e financuar nga BE-ja, e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Ky botim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, nëpërmjet projektit *Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor*, të financuar nga Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II).

**Për më shumë informacion, kontaktoni:**

Drejtuese e SEESAC  
Bulevar Zorana Đinđića 64  
11000 Belgrade, Serbia  
Tel.: +381 11 415 5300  
[www.seesac.org](http://www.seesac.org)

**Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë**

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinionin nga ana e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian, për sa i përket: 1) statusit ligjor të secilit vend, territor ose zonë, ose të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) përcaktimit të vijave kufitare ose kufijve të tij.

**Redaktoi:**

Dragan Božanić

**Dizajni dhe paraqitja grafike:**

KNAP

**Përkthimi:**

Alba Global

**Vendi dhe viti i botimit:**

Beograd 2025

**Printimi:**

Bigraf Plus, Beograd

**Qarkullimi:**

50 copë

ISBN-978-86-7728-396-4

© SEESAC 2025 - Të gjitha të drejtat të rezervuara

---

## Falënderime

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për ministrinë e brendshme dhe drejtorinë e policisë në Ballkanin Perëndimor për mbështetjen dhe kontributin e tyre në zbatimin e këtij hulumtimi, si përmes sigurimit të të dhënave sasiore, po ashtu dhe përmes informacioneve të vyera të ndara nga përfaqësuesit e tyre, të cilat kanë mundësuar një njohje të hollësishme të përgjigjes institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje.

U jemi gjithashtu po aq mirënjohës organizatave të grave për pjesëmarrjen e tyre në diskutimet në grupet e fokusit, si dhe për sigurimin e informacioneve kritike nga perspektiva e të mbijetuarave të dhunës në familje, në veçanti lidhur me rolin e armëve të zjarrit në këtë kontekst. Në këto organizata përfshihen *Qendra për Nisma Ligjore Qytetare*, *Qendra "Strehëza Edlira Haxhiymeri"*, *Shërbimi Ligjor Falas Tiranë*, *"Të ndryshëm & Të barabartë"*, *"Medica Zenica"*, *"Fondacioni i Demokracisë Vendore"*, *"Fondacioni Lara Bijeljina"*, *"Gratë e Bashkuara Banja Luka"*, *"Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve"*, *Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*, *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut*, *Shoqata e Avokatëve të Rinj në Maqedoni*, *OJQ "Safe life Tuzi"*, *OJQ "Numri i ndihmës për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës"*, *"Shtëpia e Sigurt për Gratë në Podgoricë"*, *"Qendra për të Drejtat e Grave"*.

Zbatimi me sukses i këtij hulumtimi është bërë gjithashtu i mundur përmes mbështetjes në faza të ndryshme të zbatimit të hulumtimit nga ekspertët në vijim: Jasminika Frishchikj, Kosana Beker, Elona Dini dhe Maja Branković Đundić. Gjithashtu, u ofrua mbështetje për zhvillimin e diskutimeve në grupet e fokusit nga Ivan Mehmedović, Raisa Shehu dhe Stojan Mishev.

Zbatimi i hulumtimit është pasuruar ndjeshëm nga mbështetja e anëtarëve të ekipit të SEESAC, Violeta Gaši, Tatjana Višacki, Jana Ilić dhe Andreja Marčenko. Për më tepër, janë dhënë komente të vyera mbi draftin e raportit nga Juliana Buzi, Vesna Cipruš dhe Martin Van Der Meij.

# Përmbajtja

LISTA E SHKURTIMEVE	11
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	12
STRUKTURA E RAPORTIT	15
KAPITULLI 1    HYRJE	16
KAPITULLI 2    METODOLOGJIA KËRKIMORE	19
KAPITULLI 3    DHUNA NË FAMILJE – SHKALLA E PROBLEMIT	25
KAPITULLI 4    NDIKIMI I KEQPËRDORIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT NË KONTEKSTIN E DHUNËS NË FAMILJE	33
4.1 Sfidat në identifikimin e shpeshtësisë së keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje	34
4.2 Karakteristikat e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje	38
4.3 Pasojat vdekjeprurëse të incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje	44
4.4 Plagosjet	53
4.5 Kërcënimet	53
4.6 Përmbledhje e të dhënave administrative	54
4.7 Autorët e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje	55
4.8 Punonjësit e sektorit të sigurisë nën petkun e autorëve të incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje	57
4.9 Vrasjet-vetëvrasjet/femicidi-vetëvrasjet	58
KAPITULLI 5    KARAKTERISTIKAT E ARMËVE TË ZJARRIT TË PËRDORURA NË KONTEKSTIN E DHUNËS NË FAMILJE DHE PROCEDURAT INSTITUCIONALE	62
5.1 Lloji i armëve të përdorura në kontekstin e dhunës në familje	63
5.2 Miratimi, rinovimi dhe revokimi i lejes duke marrë në konsideratë dhunën në familje	66

---

<b>KAPITULLI 6</b>	<b>KËNDVËSHTRIM PËRTEJ SHIFRAVE: TË DHËNA CILËSORE MBI ARMËT E ZJARRIT DHE DHUNËN NË FAMILJE</b>	<b>68</b>
<b>6.1</b>	<b>Roli i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje</b>	<b>69</b>
6.1.1	Shtrëngimi, kontrolli dhe pengesat ndaj raportimit	69
6.1.2	Aspektet kulturore dhe normalizimi i zotërimit të armëve të zjarrit	70
6.1.3	Armët e zjarrit si faktorë rreziku	70
6.1.4	Sfidat specifike për grupet e cënueshme	71
6.1.5	Punonjësit e sektorit të sigurisë nën petkun e autorëve	72
<b>6.2</b>	<b>Përgjigja institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje</b>	<b>72</b>
6.2.1	Procedurat e policisë dhe vlerësimi i rrezikut	72
6.2.2	Sfidat në menaxhimin e informacionit	74
6.2.3	Kapaciteti dhe bashkëpunimi ndërsektorial	74
6.2.4	Përgjigja e sistemit gjyqësor	75
<b>6.3</b>	<b>Rregullimi i çështjes së mbajtjes me leje të armëve të zjarrit nga civilët: Miratimi dhe revokimi i lejes</b>	<b>76</b>
6.3.1	Kuadri ligjor dhe verifikimet e së shkuarës	76
6.3.2	Vlerësimi i aftësisë (fizike-mendore)	78
6.3.3	Monitorimi i ruajtjes së armëve, rinovimi i lejes dhe arsyet për mbajtjen	78
6.3.4	Siguria e personelit të angazhuar në miratimin e lejeve	78
<b>KAPITULLI 7</b>	<b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b>	<b>79</b>
7.1	Konkluzione	80
7.2	Rekomandime	84

## Lista e figurave

<b>Figura 1:</b>	Niveli i përhapjes së llojeve të ndryshme të dhunës ndaj grave (në %) që nga mosha 15 vjeç
<b>Figura 2:</b>	Niveli i përhapjes së llojeve të ndryshme të dhunës psikologjike nga partneri intim, në %
<b>Figura 3:</b>	Kontaktimi i policisë nga viktimat pas incidentit më të rëndë të dhunës nga partnerët aktualë/të mëparshëm, apo nga një jo partner
<b>Figura 4:</b>	Si e ka zbuluar policia incidentin më të rëndë (të gjithë autorët)?
<b>Figura 5:</b>	A njihni dikë (në familjen, lagjen apo komunitetin tuaj) që ka përjetuar dhunë në familje?
<b>Figura 6:</b>	Deri në çfarë mase bini dakord me pohimin në vijim: Dhuna në familje përfaqëson një kërcënim të rëndë ndaj sigurisë.
<b>Figura 7:</b>	Numri i incidenteve të dhunës në familje të raportuara në polici, 2019-2021
<b>Figura 8:</b>	Numri i incidenteve të dhunës në familje të raportuara në polici, 2019-2021
<b>Figura 9:</b>	Numri i incidenteve të lidhura me armët e zjarrit në Ballkanin Perëndimor (BP), sipas llojit të incidentit, 2019-2023
<b>Figura 10:</b>	Numri i incidenteve të lidhura me armët e zjarrit në BP (me përjashtim të armëve të kapura), sipas llojit të incidentit dhe vitit, 2019-2023
<b>Figura 11:</b>	Viktimat e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje në BP, sipas gjinisë, 2019-2023
<b>Figura 12:</b>	Përqindja e viktimave gra në incidentet e lidhura me armët e zjarrit në BP, sipas llojit të incidentit, 2019-2023
<b>Figura 13:</b>	Përqindja e viktimave burrave në incidentet e lidhura me armët e zjarrit në BP, sipas llojit të incidentit, 2019-2023
<b>Figura 14:</b>	Pjesa e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në raport me numrin total të incidenteve në BP, sipas gjinisë së viktimave dhe vitit
<b>Figura 15:</b>	Incidentet e lidhura me armët e zjarrit në BP, sipas autorit (partnerët intimë dhe anëtarët e tjerë të familjes), 2019-2023
<b>Figura 16:</b>	Numri i incidenteve të lidhura me armët e zjarrit në BP, të kryera nga partnerët intimë dhe anëtarët e tjerë të familjes, sipas vitit

<b>Figura 17:</b>	Viktimat e incidenteve me armë zjarri të kryera nga partnerët intimë në BP, sipas gjinisë dhe vitit
<b>Figura 18:</b>	Viktimat e incidenteve me armë zjarri të kryera nga anëtarët e tjerë të familjes në BP, 2019-2023
<b>Figura 19:</b>	Vendndodhja e detajuar e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, 2019-2023
<b>Figura 20:</b>	Numri i vdekjeve me armë zjarri, sipas llojit të incidentit në BP, 2019-2023
<b>Figura 21:</b>	Numri i vdekjeve me armë zjarri, sipas llojit të incidentit dhe juridiksionit, 2019-2023
<b>Figura 22:</b>	Numri i vdekjeve me armë zjarri në BP, sipas llojit të incidentit dhe vitit
<b>Figura 23:</b>	Numri i grave dhe burrave të vrarë me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas vitit
<b>Figura 24:</b>	Viktimat gra nga armët e zjarrit në BP, sipas llojit të incidentit, 2019-2023
<b>Figura 25:</b>	Viktimat burra nga armët e zjarrit në BP, sipas llojit të incidentit, 2019-2023
<b>Figura 26:</b>	Ndikimi i ndryshëm gjinor i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje në BP, 2019-2023
<b>Figura 27:</b>	Vrasjet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas autorit, 2019-2023
<b>Figura 28:</b>	Përqindja e grave të vrara me armë zjarri në BP nga partnerët intimë aktualë dhe të mëparshëm, 2019-2023
<b>Figura 29:</b>	Shqipëria, 2019-2023
<b>Figura 30:</b>	Bosnjë-Hercegovina, 2019-2023
<b>Figura 31:</b>	Kosova <sup>1</sup> , 2019-2023
<b>Figura 32:</b>	Mali i Zi, 2019-2023
<b>Figura 33:</b>	Maqedonia e Veriut, 2019-2023
<b>Figura 34:</b>	Serbia, 2019-2023
<b>Figura 35:</b>	Numri i plagosjeve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas vitit dhe gjinisë së viktimës

1 Për sa i përket Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, referencat për Kosovën kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 (1999) së Këshillit të Sigurimit. Për sa i përket Bashkimit Evropian, ky emërtim nuk cenon qëndrimet lidhur me statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

<b>Figura 36:</b>	Autorët e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas gjinisë, 2019-2023
<b>Figura 37:</b>	Autorët e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas gjinisë dhe vitit
<b>Figura 38:</b>	Autorët e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas gjinisë, 2019-2023
<b>Figura 39:</b>	Autorët burra të incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas moshës, 2019-2023
<b>Figura 40:</b>	Numri i rasteve të femicidit-vetëvrasjes në incidentet e dhunës me armë zjarri nga partneri intim, 2019-2023
<b>Figura 41:</b>	Numri i rasteve të vrasjes/vetëvrasjes në incidentet me armë zjarri kundër anëtarëve të tjerë të familjes, 2019-2023
<b>Figura 42:</b>	Nëse do të kishit armë në shtëpi, a do të ndiheshit...?, sipas gjinisë, 2024
<b>Figura 43:</b>	Lloji i armëve të zjarrit të përdorura në incidentet e dhunës në familje në BP, 2019-2023
<b>Figura 44:</b>	Statusi ligjor i armëve të përdorura në incidentet e dhunës në familje në BP, 2019-2023
<b>Figura 45:</b>	Numri i incidenteve me armë zjarri në të cilat autorët kanë përdorur armët e gjuetisë në kontekstin e dhunës në familje në BP, 2019-2023

## Lista e tabelave

<b>Tabela 1:</b>	Niveli i përhapjes së dhunës fizike dhe/ose seksuale që nga moshë 15 vjeç, sipas llojit të autorëve
<b>Tabela 2:</b>	Numri i incidenteve të raportuara të dhunës në familje në të cilat është regjistruar se autori i dhunës në familje ka pasur një armë zjarri në zotërim, qoftë të ligjshme apo të jashtëligjshme
<b>Tabela 3:</b>	Viktimat e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje, sipas gjinisë, vitit dhe juridiksionit
<b>Tabela 4:</b>	Numri i viktimave sipas llojit të incidentit në BP, sipas gjinisë dhe vitit
<b>Tabela 5:</b>	Perceptimet mbi armët e zjarrit në shtëpi (në %), sipas juridiksionit, 2025
<b>Tabela 6:</b>	Llojet e armëve të zjarrit të kapura dhe të konfiskuara në rastet e dhunës në familje në Shqipëri, në % dhe copë, 2019-2021

**Tabela 7:** Llojet e armëve të zjarrit të kapura dhe të konfiskuara në rastet e dhunës në familje në Bosnjë-Hercegovinë, në % dhe copë, 2019-2021

## Lista e kutive

<b>Kutia 1:</b>	Përdorimi i hulumtimeve/kërkimeve për të informuar përgjigjen institucionale dhe për të rritur parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje
<b>Kutia 2:</b>	Të kuptuarit e vrasjes-vetëvrasjes/femicidit-vetëvrasjes
<b>Kutia 3:</b>	Perceptimet mbi armët e zjarrit në shtëpi

## Lista e shkurtimeve

<b>AVMP</b>	Platforma e monitorimit të dhunës me armë
<b>BH</b>	Bosnjë-Hercegovina
<b>OShC</b>	Organizatë e shoqërisë civile
<b>MB</b>	Ministria e Brendshme
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>KBR</b>	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
<b>AVL</b>	Armë të vogla dhe të lehta
<b>EJL</b>	Evropa Juglindore
<b>SEESAC</b>	Zyra Qendrore e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta
<b>QMS</b>	Qendër e Mirëqenies Sociale
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>BP</b>	Ballkani Perëndimor

# Përmbledhje ekzekutive

Në Ballkanin Perëndimor janë realizuar përpjekje afatgjata, të cilat janë fokusuar në dokumentimin e ndikimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe në përmirësimin e masave parandaluese. Përmes hulumtimeve të detajuara dhe bashkëpunimit me institucionet rajonale, SEESAC ka ofruar analiza novatore mbi rolin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, ka mbështetur politikëbërjen dhe përmirësimet ligjore, si dhe ka zhvilluar mjete dhe udhëzime praktike për të forcuar përpjekjet e lidhura me parandalimin dhe përgjigjen.

Megjithatë, keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje vazhdon të ketë efekte negative të sigurisë së grave dhe burrave në Ballkanin Perëndimor dhe përbën një sfidë specifike në kontekstin e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL). Ky raport paraqet një analizë gjithëpërfshirëse mbi ndikimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe dokumenton gjerësisht natyrën e tij me bazë gjinore. Në këtë mënyrë, raporti synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi rolin e armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe mbi rreziqet specifike që ato përfaqësojnë në këtë kontekst.

Edhe pse qëllimi kryesor i analizës është të mbështesë politikëbërësit dhe agjencitë ligjzbatuese në trajtimin e sfidave të identifikuara, si dhe në rritjen e sigurisë dhe mirëqenies së grave dhe burrave në Ballkanin Perëndimor, ajo është zhvilluar gjithashtu edhe për organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, grupet e shoqërisë civile, hulumtuesit dhe grupet e tjera të interesit në rajon.

Analiza përdor një qasje gjithëpërfshirëse që ndërthur disa metoda, duke përfshirë analizën

sasiore të të dhënave të marra nga Platforma e Monitorimit të Dhunës me Armë (AVMP), si dhe të dhënat e mbledhura nga Ministrinë e Jashtme në Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, analiza plotësohet me informacione cilësore nga 15 diskutimet në grupet e fokusit të realizuara në mbarë rajonin me oficerët e policisë të angazhuar në rastet e dhunës në familje, oficerët përgjegjës për dhënien e lejeve për armë zjarri dhe përfaqësuesit e organizatave të grave. Këto diskutime mbështeten në përvojat praktike të punës me të mbijetuarat e dhunës në familje, duke ofruar njohuri të thelluara mbi ndikimin e armëve të zjarrit të viktimat. Informacionet nga diskutimet theksojnë në veçanti aspektet që shtrihen përtej të dhënave sasiore dhe shpeshherë janë të vështira për t'u identifikuar si pasojë e mungesës së të dhënave dhe mosraportimit të dhunës në familje. Për më tepër, u diskutuan gjerësisht sfidat e lidhura me përgjigjen institucionale dhe praktikatat e mira.

Duke përdorur evidenca të kombinuara, analiza nënvizon ndikimet negative dhe të gjera të keqpërdorimit të armëve të zjarrit të gratë dhe burrat në rajon, duke përfshirë lëndimet fizike me pasoja fatale dhe jofatale, si dhe traumën psikologjike. Gjetja gjithëpërfshirëse e analizës është që tendencat e identifikuara të lidhura me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje vijojnë të shfaqen në mënyrë alarmante, çka dokumenton rreziqet komplekse që paraqesin e armët e zjarrit në këtë kontekst.

Gjetjet e prezantuara në këtë raport nënvizojnë ndikimin e shumëfishtë të armëve të zjarrit të sigurisë dhe mirëqenies së viktimave të dhunës në familje, duke dokumentuar

një sërë mënyrash përmes të cilave ato intensifikojnë faktorët ekzistues të rrezikut dhe rrisin ndjeshëm mundësinë e pasojave fatale. Armët e zjarrit përdoren si mjete shtrëngimi/kërcënimi dhe kontrolli në marrëdhëniet abuzive, duke përforcuar pabarazitë gjinore dhe të pushtetit. Prania e tyre redukton akoma më tej probabilitetin e kufizuar që viktimat të raportojnë dhunën. Kjo është veçanërisht e dukshme në rastet që përfshijnë zotërimin e armëve të zjarrit të jashtëligjshme, ku viktimat mund të zgjedhin të mos e raportojnë dhunën si pasojë e frikës nga hakmarrja dhe shqetësimeve lidhur me pasojat e mundshme ligjore për autorët. Armët e zjarrit reduktojnë gjithashtu aftësinë e viktimave për të rezistuar dhe për t'u vetëmbrojtur. Këto aspekte, së bashku me shkallën e lëndimeve të shkaktuara me armë zjarri, rrisin më tej probabilitetin e pasojave fatale. Përmes evidencave të siguruar, raporti tregon gjithashtu se aspektet kulturore të lidhura me armët e zjarrit, si pjesë të identitetit të burrave, mund të pengojnë ndjeshëm raportimin e dhunës në familje dhe të keqpërdorimit të armëve të zjarrit.

Këto gjetje mbështeten fuqimisht nga provat empirike, siç tregohet nga diferenca e konsiderueshme ndërmjet numrit të incidenteve të regjistruara të dhunës në familje me armë zjarri dhe numrit tejet të lartë të viktimave. Edhe pse gjatë periudhës 2019-2023, incidentet e dhunës në familje me armë zjarri përbënin vetëm 3,1% të të gjitha incidenteve të raportuara me armë zjarri, gjatë të njëjtës periudhës, dhuna në familje ka qenë shkaku kryesor i vdekjeve me armë zjarri në rajon. Numri i personave të vrarë në incidentet e dhunës në familje me armë zjarri (përkatesisht 152, nga të cilët 93 gra dhe 59 burra) ishte më i lartë se në çdo kontekst tjetër, duke përfshirë veprimtaritë kriminale (144) dhe mosmarrëveshjet në publik (135). Viti 2020, i cili u karakterizua nga fillimi i pandemisë së COVID-19, regjistroi numrin më të lartë të viktimave, duke theksuar nevojën për studime të mëtejshme mbi ndikimin e kushteve specifike, si izolimi/karantinimi, në shtimin e rreziqeve.

Analiza konstaton se keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje prek si gratë po ashtu dhe burrat. Megjithatë, shkalla e ekspozimit dhe modelet e viktimizimit ndryshojnë ndjeshëm, dhe janë gratë ato që

preken në mënyrë joproporcionale. Nga totali i grave të vrara me armë zjarri në rajon, 68,4% janë vrarë në kontekstet e dhunës në familje, ndërsa në rastin e burrave kjo shifër është 10,9%. Modele të ngjashme janë dokumentuar edhe në juridiksionet individuale në Ballkanin Perëndimor. Në kontekstin e dhunës në familje, gratë ishin më të rrezikuara nga përdorimi i armëve të zjarrit nga partnerët e tyre intimë. Nga totali i grave të vrara me armë zjarri në Ballkanin Perëndimor, 50,7% janë vrarë nga partneri i tyre intim (ndërsa në rastin e burrave kjo shifër është 0,6%), çka tregon natyrën me bazë gjinore të dhunës me armë ndaj grave. Ndryshe nga sa më lart, dhuna kundër burrave zakonisht nuk është me bazë gjinore dhe burrat janë përgjithësisht të rrezikuar nga anëtarët e tjerë meshkujt të familjes. Konfliktet lindin nga mosmarrëveshjet në familje, problemet e pronësisë, dhunën e rrënjësor ndër breza etj. Në kontekstin e dhunës nga partneri intim, gratë kanë tre herë më shumë gjasa që të vriten me armë zjarri nga partnerët e tyre aktualë se sa nga partnerët e mëparshëm. Megjithatë, numri i konsiderueshëm i grave të vrara nga partnerët e tyre të mëparshëm tregon se dhuna nuk ndalon detyrimisht pas ndarjes dhe madje shpeshherë edhe përshkallëzohet, pasi abuzuesit i përdorin armët e zjarrit si një mjet për të rivendosur kontrollin mbi viktimën.

Edhe pse të dhënat mbi armët e zjarrit disponohen kryesisht për vrasjet, vrasjet e grave (femicidi), plagosjet dhe sulmet, armët e zjarrit përdoren gjithashtu si mjete për të kryer forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, ku përfshihen dhuna psikologjike dhe seksuale (si përdhunimi), lëndimi emocional, shtrëngimi dhe abuzimi ekonomik. Edhe pse këto forma të dhunës shpesh pasohen nga incidente fatale, raportimi i tyre vazhdon të jetë në nivele tejet të ulëta. Gratë nga grupet e cënueshme, si p.sh. ato që jetojnë në zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë rome, përballen me pengesa shtesë në raportimin e dhunës, dhe ende mungon informacioni lidhur me ekspozimin e tyre ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit.

Dhuna me armë në kontekstin familjar kryhet përgjithësisht nga meshkujt. Një tendencë e vazhdueshme tregon se burrat përbëjnë 98% të autorëve të rasteve të dhunës në familje me armë zjarri.

Analiza ofron gjithashtu informacion mbi karakteristikat e armëve të përdorura për kryerjen e dhunës në familje. Armët e dorës janë lloji i armëve të zjarrit që përdoren më shpesh në dhunën në familje, pasuar nga pushkët dhe shotganët, disa AVL, armët automatike/ushtarake, lëndët plasëse dhe armët me ajër. Në rastet kur ka pasur të dhëna të disponueshme mbi llojet e pronësisë së armëve të zjarrit, është konstatuar në mënyrë të përsëritur se janë raportuar më shpesh armë zjarri pa leje se sa armë zjarri me leje, çka nënvizon sfidat e lidhura me trajtimin e armëve të zjarrit të jashtëligjshme. Megjithatë, duke pasur parasysh nivelet e larta të mosraportimit të rasteve të dhunës në familje, analiza sugjeron se këto të dhëna duhen trajtuar me kujdes, pasi mund të ketë mungesë raportimi edhe në rastet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit me leje, veçanërisht kur ato nuk përdoren për sulme ose kur nuk rezultojnë në kërcënim për jetën.

Për sa i përket përgjigjes institucionale, raporti nënvizon progres të konsiderueshëm në forcimin e kuadrove ligjorë dhe të politikave me qëllim luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje, duke përfshirë të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në këtë kontekst. Këto zhvillime pasqyrohen më tej në praktikën e nëpunësve të agjencive ligjzbatuese në mbarë rajonin, të cilët janë gjithnjë e më të vëmendshëm në identifikimin dhe trajtimin e faktorëve të rrezikut të lidhur me dhunën në familje, duke përfshirë ato të lidhur me zotërimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit.

Pavarësisht këtyre përparimeve, mbeten ende disa sfida. Vlerësimet e rrezikut nuk realizohen në mënyrë sistematike dhe, në disa raste, zbatohen në mënyrë të papërshtatshme. Gjithashtu, oficerëve ligjzbatues shpeshherë u mungon informacioni mbi faktin nëse armët e kapura janë konfiskuar në mënyrë të përhershme apo u janë kthyer autorëve, çka mund të komprometojë sigurinë e tyre dhe të viktimave. Për më tepër, aksesit i kufizuar në regjistrat e armëve dhe mangësitë në bazat e të dhënave për zotërimin e armëve të zjarrit mund të pengojnë kryerjen në mënyrë efektive të vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rasteve.

Mbeten ende sfida në bashkëpunimin ndërsektorial, megjithatë, janë identifikuar

gjithashtu praktika pozitive në rajon. Këtu përfshihen angazhimi proaktiv nga oficerët e policisë, rritja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, promovimi i të nxënimit mes kolegëve dhe shkëmbimi i përvojave.

Po ashtu, në rajon janë zbatuar disa reforma ligjore të konsiderueshme dhe është rregulluar gjerësisht mbajtja e armëve të zjarrit nga civilët. Procedurat për shqyrtimin e aplikimeve për marrjen e një lejeje për armë zjarri janë në përgjithësi të rrepta dhe të mirërregulluara në mbarë rajonin. Megjithatë, disponueshmëria e kufizuar e të dhënave nuk mundëson që të përcaktohet se deri në çfarë mase këto procedura marrin në konsideratë shqetësimet e dhunës në familje, edhe pse provat ekzistuese sugjerojnë se këta faktorë rrallëherë përdoren si bazë për refuzimin e aplikimeve. Në mbarë rajonin është theksuar gjerësisht rëndësia e realizimit të verifikimeve të së shkuarës që shtrihen përtej shqyrtimeve të bazave të të dhënave administrative dhe që përfshijnë vizitat në terren dhe intervistat. Procesi i lëshimit të vërtetimeve të aftësisë për miratimin e lejeve për armë zjarri, si dhe bashkëpunimi me institucionet e kujdesit shëndetësor, përballet me sfida të shumta në të gjitha juridiksionet në Ballkanin Perëndimor dhe kërkon një përgjigje urgjente.

Raporti përmbillet me rekomandime strategjike, të organizuara në gjashtë grupe, për të ulur dhe parandaluar keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje: (1) Rritja e ndërgjegjësimit, si dhe ulja e përhapjes dhe qarkullimit të armëve të zjarrit në zotërim të jashtëligjshëm, (2) Përmirësimi i vlerësimit të rrezikut dhe i përgjigjes operacionale, (3) Forcimi i procedurave të lidhura me miratimin e lejeve për armë zjarri, (4) Përmirësimi i sistemeve të monitorimit dhe mbajtjes së regjistrave/regjistrimit të të dhënave, (5) Përmirësimi i qasjes së ndërlidhur me në qendër të mbijetuarat, (6) Bashkëpunimi rajonal dhe ndarja e praktikave më të mira. Në të gjitha këto rekomandime, raporti nënvizon nevojën për ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve për të garantuar zbatim të qëndrueshëm dhe efektiv.



# Struktura e raportit

Kjo analizë është e strukturuar në shtatë kapituj.

**Kapitulli i parë** prezanton shkurtimisht kontekstin specifik në Ballkanin Perëndimor në të cilin është realizuar analiza, si dhe paraqet një përmbledhje të shkurtër të hulumtimit të mëparshëm në këtë fushë.

**Kapitulli i dytë** përshkruan qasjen kryesore metodologjike të aplikuar në analizë, si dhe objektin dhe qëllimin e saj.

**Kapitulli i tretë** synon të japë informacione bazë rreth dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në rajon në përgjithësi, si një element për të kuptuar mënyrën se si armët e zjarrit përshkallëzohen rreziqet në këtë kontekst. Analiza e paraqitur këtu mbështetet në analizat e mëparshme të realizuara në rajon, ku spikat Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave.

**Kapitulli i katërt** ofron një analizë të detajuar të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe Platforma e SEESAC për Monitorimin e Dhunës me Armë, duke u fokusuar në rolin e armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe ndikimin e tyre joproporcional te gratë dhe burrat.

**Kapitulli i pestë** fokusohet në karakteristikat e armëve të përdorura në incidentet e dhunë në familje në rajon, dhe përgjigja ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duke përfshirë të dhënat zyrtare për armët e zjarrit të kapura dhe të sekuestruara, si dhe lejet e revokuara për armë zjarri.

**Kapitulli i gjashtë** integron gjetjet nga diskutimet në grupet e fokusit me oficerët e policisë të angazhuar në rastet e dhunës në familje, oficerët e përfshirë në miratimin e lejeve


për armë zjarri për civilët dhe përfaqësuesit e organizatave të grave. Ky kapitull synon të ofrojë dhe të dokumentojë informacione cilësore rreth ndikimit të armëve të zjarrit te gratë dhe burrat, duke kontribuar kështu në kapërcimin e sfidave të lidhura me mosraportimin e tyre. Gjithashtu, kapitulli diskuton mbi sfidat e lidhura me parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe praktikatat e mira të identifikuara në mbarë rajonin.

Në përfundim, bazuar në kapitujt e mëparshëm, vjen **kapitulli i shtatë** i cili përmbledh gjetjet kryesore nga analiza dhe ofron rekomandime të bazuara në evidenca për të përmirësuar më tej parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, duke përfshirë ato të paraqitura nga pjesëmarrësit në diskutimet në grupet e fokusit.

---

Kapitulli 1

# Hyrje



Në Ballkanin Perëndimor, hulumtimet kanë dokumentuar gjerësisht ndikimet gjinore të armëve të vogla, çka nënvizon rolin e armëve të zjarrit në përshkallëzimin e dhunës në familje dhe rreziqet e rënda që përbëjnë jo vetëm ndaj sigurisë të grave, por edhe të burrave. Këto gjetje kanë qenë thelbësore për të formësuar përgjigjen me politika dhe strategjitë praktike që synojnë parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, si dhe rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së personave më të prekur, qofshin gra apo burra.

Në fillim të vitit 2007, SEESAC realizoi një përpjekje pioniere për të eksploruar lidhjet ndërmjet zotërimit të armëve të zjarrit dhe dhunës në familje, përmes një studimi<sup>2</sup> krahasues të legjislacionit përkatës dhe mekanizmave të zbatimit. Një studim rajonal<sup>3</sup> për aspektet gjinore dhe AVL-të, i realizuar në vitin 2016, shqyrtoi më tej rolin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, duke e identifikuar atë si shqetësimin kryesor për kontrollin e AVL-ve. Studimi ofroi gjithashtu rekomandime të bazuara në prova, të cilat kanë informuar dhe udhëhequr përgjigjet me politika dhe procesin e programimit.

Duke u mbështetur në anketat për AVL-të<sup>4</sup> të realizuara në rajon, analiza e vitit 2019<sup>5</sup> për keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje nënvizoi shtrirjen dhe kompleksitetin e problemit. Analiza konstatoi se 61% e grave të vrara në Evropën Juglindore (EJL), janë vrarë nga një anëtar i familjes, ndërsa në rastin e burrave të vrarë nga një anëtar i familjes kjo shifër është 12,4%. Gratë janë prekur në mënyrë joproportionale nga dhuna nga partneri intim. Përkatësisht, 38,6% e grave janë vrarë nga partnerët e tyre intimë, ndërsa në rastin e burrave kjo shifër është vetëm 1,2%. Gjatë periudhës së analizuar, armët e zjarrit kanë qenë shpeshherë mjeti i zgjedhur për të kryer dhunë në familje:

37,7% e vrasjeve nga anëtarët e familjes janë kryer me armë zjarri dhe 43,5% e grave në EJL janë vrarë me armë zjarri nga partnerët e tyre intimë.

Që nga viti 2020, SEESAC ka publikuar Raportet e Monitorimit të Dhunës me Armë - "In Focus",<sup>6</sup> një seri raportesh tematike të bazuara në të dhënat nga AVMP-ja, të cilat shqyrtojnë incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në EJL. Raportet ofrojnë një panoramë periodike të incidenteve të kryera nga partnerët intimë dhe anëtarët e ngushtë të familjes, dhe kanë qenë thelbësore në dokumentimin e ndikimit joproportional të keqpërdorimit të armëve të zjarrit te gratë, në veçanti në kontekstin e dhunës nga partneri intim.

Në kuadër të zbatimit të Udhërrëfyesit për Kontrollin e AVL-ve në Ballkanin Perëndimor, zyrat e UNDP-së në rajon kanë realizuar gjithashtu hulumtime të konsiderueshme rreth kësaj fushe. Për shembull, UNDP në Serbi, ka realizuar një sërë hulumtimesh që nënvizojnë ndikimet negative të keqpërdorimit të armëve të zjarrit te gratë dhe rolin e tyre specifik në vrasjet e grave,<sup>7</sup> duke përfshirë një analizë të të dhënave administrative<sup>8</sup> dhe të praktikave të kuadrit rregullator,<sup>9</sup> si dhe një hulumtim mbi përgjigjen e drejtësisë penale në rastet e vrasjeve të grave të kryera me armë zjarri. UNDP në Maqedoninë e Veriut ka analizuar vrasjet e grave, duke hedhur dritë edhe mbi rolin e armëve të zjarrit në këtë aspekt.

Nga ana tjetër, organizatat e grave në rajon kanë dokumentuar prej kohësh ndikimin e armëve të zjarrit në sigurinë dhe mirëqenien e grave. Prej shumë vitesh, ato kanë shërbyer si burimi kryesor i informacionit, dhe shpeshherë i vetmi, për vrasjet e grave, duke përfshirë ato të kryera me armë zjarri.

2 SEESAC. 2007. *Mbajtja e armëve të zjarrit dhe dhuna në familje në Ballkanin Perëndimor: Një studim krahasues i legjislacionit dhe mekanizmave të zbatimit*. Beograd: SEESAC.

3 SEESAC. 2016. *Gjinia dhe AVL-të në Evropën Juglindore*. Beograd: SEESAC.

4 Anketimet për AVL-të të SEESAC mund t'i gjeni në: <https://www.seesac.org/SALW-Surveys/>

5 SEESAC. 2019. *Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje në Evropën Juglindore*. Beograd: SEESAC.

6 Raportet e Monitorimit të Dhunës me Armë - "In Focus" janë të disponueshme në bazën e të dhënave të SEESAC: <https://www.seesac.org/Armed-Violence/>

7 Lacmanović. Vedrana. 2021. *Analizë e rasteve të vrasjeve të grave të kryera me armë zjarri (qershor 2017 - qershor 2020)*. Beograd: UNDP.

8 Stepanov, Biljana. 2022. *Nasilje u porodici – šta govore podaci*. Beograd: UNDP në Serbi.

9 Stevanović Govedarica, Gordana. 2021. *Armët e vogla dhe të lehta, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje: Analizë e praktikës dhe e kuadrit rregullator*. Beograd: UNDP në Serbi.

Më pas, në vitet 2021 dhe 2022, SEESAC realizoi një analizë gjinore në shkallë të gjerë<sup>10</sup> të legjislacionit dhe politikave për kontrollin e armëve të vogla në Ballkanin Perëndimor, me qëllim vlerësimin dhe rritjen e përgjegjshmërisë gjinore të legjislacionit dhe politikave. Kjo analizë dokumentoi se ligjet për armët e zjarrit janë përmirësuar ndjeshëm për të garantuar trajtimin e dhunës në familje. Ajo konstatoi se ligjet për mbrojtjen nga dhuna në familje kanë njohur gjithnjë e më tepër rreziqet që paraqet keqpërdorimi i armëve të zjarrit. Për më tepër, strategjitë për kontrollin e AVL-ve në rajon përfshinin masa specifike për përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe dhunën nga partneri intim, si dhe për rishikimin e praktikave institucionale dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale për të luftuar këtë problematikë.

Megjithatë, analiza identifikoi gjithashtu mangësi në përgjigjet operationale, të cilat duhen adresuar. Këtu përfshihen nevoja për të forcuar proceset e miratimit të lejeve për armë zjarri duke integruar në këto procese verifikimet gjithëpërfshirëse të së shkuarës dhe duke përmirësuar vlerësimet e rrezikut të dhunës në familje, për të garantuar që këto vlerësime të marrin në konsideratë, në mënyrën e duhur, rreziqet që paraqesin armët e zjarrit, në veçanti ato në zotërim të jashtëligjshëm. Për më tepër, shpeshherë praktikatat për regjistrimin e të dhënave për armët e zjarrit nuk përfshijnë ndarjen e të dhënave sipas gjinisë dhe informacione të detajuara për keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, duke penguar kështu zhvillimin e zgjidhjeve me ndjeshmëri gjinore. Analiza nënvizoi gjithashtu nevojën për hulumtime të mëtejshme për të kuptuar nivelin e zbatimit të legjislacionit përkatës, për të identifikuar sfidat e vazhdueshme, si dhe për të përmirësuar masat parandaluese kundër keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe dhunën nga partneri intim.

Për të mbështetur autoritetet në kapërcimin e sfidave të identifikuara, në përmbushjen e

angazhimeve strategjike dhe në përmirësimin e përpjekjeve për të parandaluar keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, SEESAC, në kuadër të projektit rajonal *Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor*, të financuar nga Bashkimi Evropian, ofron asistencë gjithëpërfshirëse për institucionet me qëllim trajtimin e kësaj çështjeje në mënyrë efektive. Kjo mbështetje e vë theksin te përmirësimi i përgjigjeve operationale për të luftuar keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje.


Në kuadër të këtyre përpjekjeve, SEESAC nisi një analizë rajonale të keqpërdorimit të zjarrit në dhunën në familje. Gjetjet e saj, të cilat janë prezantuar në këtë raport, synojnë të dokumentojnë tendencat dhe shqetësimet kryesore lidhur me rolin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, të identifikojnë sfidat kryesore në praktikatat institucionale për parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, si dhe të ofrojnë rekomandime të bazuara në evidenca për përmirësim të mëtejshëm. Edhe pse në fazat e hershme, analiza ishte thelbësore në zhvillimin e udhëzimeve praktike për të rritur nivelin e parandalimit të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, përmes zhvillimit të udhëzimeve specifike për oficerët e parë në vendngjarje dhe profesionistët e përfshirë në miratimin e lejeve për armë zjarri për civilët. Procesi me pjesëmarrje, i orientuar drejt veprimeve, i cili shërbeu si bazë për kryerjen e analizës, kontribuoi ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve kryesore të interesit dhe në përmirësimin e përgjigjeve operationale.

10 Analiza gjinore e legjislacionit dhe politikave për kontrollin e AVL-ve në Ballkanin Perëndimor – raportet e disponueshme në: <https://www.seesac.org/News-Gender-in-Security-Sector/gender-analysis-of-salw-control-legislation-and-policies-in-the-western-balkans-reports/>

---

Kapitulli 2

# Metodologjia kërkimore



## Qëllimi

Qëllimi i kësaj analize është të kontribuojë në rritjen e nivelit të parandalimit të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe në përmirësimin e sigurisë së grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, në Ballkanin Perëndimor.

Analiza synon në mënyrë specifike:

- të dokumentojë dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi rolin e armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe mbi rreziqet specifike të pranisë së armëve të zjarrit në këtë kontekst,
- të dokumentojë ndikimin joproporcional të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje te gratë, si dhe modelet e ndryshme të ekspozimit ndaj rrezikut për gratë dhe burrat,
- të dokumentojë tendencat kritike të lidhura me këtë problematikë,
- të identifikojë sfidat kryesore në parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, duke përfshirë në përgjigjen institucionale,
- të propozojë një grup rekomandimesh të bazuara në evidenca për të përmirësuar përgjigjen institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje.

Pyetjet kryesore të hulumtimit janë:

- Cila është shkalla e problemit? Cila është shpeshtësia dhe cilat janë karakteristikat e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, në veçanti në kontekstin më të gjerë të dhunës me armë në rajon?
- Cili është dimensionin gjinor i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje? Si ndikon ai te gratë dhe burrat?
- Deri në çfarë mase kontribuojnë praktikatat aktuale për të parandaluar në mënyrë efektive keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje? Cilat janë tendencat dhe sfidat kryesore në përgjigjen institucionale?
- Si të përmirësohet më tej parandalimi i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje?

## Shtrirja gjeografike

Analiza përfshin Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Duke qenë se UNDP në Serbi ka kryer një hulumtim të ngjashëm përmes projektit *Redukto rrezikun-Rrit sigurinë - Drejt zhdukjes së keqpërdorimit të AVL-ve në kontekstin e dhunës në familje*, duke përfshirë analizën e të dhënave administrative të periudhës 2017-2020, Serbia nuk është përfshirë në mbledhjen e të dhënave dhe në diskutimet në grupet e fokusit. Megjithatë, të dhënat e marra nga AVMP-ja garantojnë përfaqësimin e Serbisë në analizën rajonale.

## Metodologjia dhe burimet e të dhënave

Metodologjia e përdorur në këtë analizë mbështetet në përvojat e mëparshme dhe në një gamë të gjerë hulumtimesh mbi dhunën në familje dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit në këtë kontekst, në Ballkanin Perëndimor.

Zhvillimi i metodologjisë është bazuar në një qasje të shumëfishtë, ku përfshihen:

- **Intervistat me informatorët kyçë janë realizuar me hulumtues** nga Ballkani Perëndimor që kanë përvojë në analizimin e lidhjes ndërmjet dhunës në familje dhe armëve të zjarrit. Këto intervista synonin të identifikonin çështjet kyçe për t'u analizuar, të ndanin përvoja në mbledhjen e të dhënave dhe të trajtonin sfidat kryesore të hasura në këtë fushë.
- **Shqyrtimi i detajuar i literaturës** synonte të ofronte një panoramë gjithëpërfshirëse dhe njohuri mbi situatën aktuale të hulumtimeve rreth rolit të armëve të zjarrit në dhunën në familje. Ky proces ishte thelbësor për të rafinuar pyetjet e hulumtimit, për të vendosur në kontekst problemin dhe për të zhvilluar një metodologji kërkimore të qëndrueshme.
- **Konsultimet rajonale mbi draftin e metodologjisë** u realizuan në vitin 2023 me grupin rajonal të punës për parandalimin e përdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje përmes vlerësimit të rrezikut dhe me grupin rajonal të punës për zhvillimin e një instrumenti për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri. Grupet e punës përbëheshin nga përfaqësues të ministrive të brendshme dhe drejtorive të policisë, të cilët merreshin me rastet e dhunës në familje, miratimin e lejeve për armë zjarri dhe kryerjen e verifikimeve të së shkuarës. Gjithashtu, ato përfshinin përfaqësues të departamenteve

të analitikës/statistikave, apo të një njësie të ngjashme përgjegjëse për regjistrimin e të dhënave, ose për mbledhjen dhe analizimin e

të dhënave me qëllim parandalimin e dhunës në familje. Bazuar në kontributet e tyre, drafti i metodologjisë u rishikua më tej dhe u finalizua.

## Burimet e të dhënave

Duke qenë se keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje është një fenomen i shumanshëm me karakteristika dhe dinamike specifike, analiza përdor një gamë të gjerë burimesh të të dhënave, ku përfshihen.

### 1. Të dhënat e mbledhura përmes Platformës së Monitorimit të Dhunës me Armë

Platforma e Monitorimit të Dhunës me Armë (AVMP) monitoron në mënyrë sistematike incidentet me armë zjarri në Evropën Juglindore. Ajo ka mbledhur të dhëna të detajuara që nga viti 2014 nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Të dhënat nga AVMP-ja mbledhen në mënyrë të përditshme nga një kombinim i burimeve zyrtare, duke përfshirë nga faqet e internetit të institucioneve ligjzbatuese dhe ministrive të brendshme, si dhe nga mediat online dhe të shkruara. Të dhënat mbi incidentet me armë zjarri kategorizohen në përputhje me përkufizimet e standardizuara për të garantuar konsistencë dhe krahasueshmëri ndërmjet juridiksioneve dhe periudhave të raportimit. Çdo incident shqyrtohet dhe analizohet duke përdorur një metodologji të zhvilluar nga SEESAC. AVMP-ja ka siguruar të dhëna, ndër të tjera, mbi llojin e incidenteve, armët e zjarrit të përdorura, gjininë e viktimës dhe të autorit, marrëdhënien midis tyre dhe vendndodhjen e incidentit. Analiza integron gjetjet kryesore të Raporteve të Monitorimit të Dhunës me Armë - "In Focus" të SEESAC lidhur me incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në EJK, duke mbuluar rastet nga viti 2019 e në vijim.

### 2. Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit për ministrinë e brendshme

Pyetësori u hartua për të mbledhur të dhëna administrative nga institucionet përkatëse

për periudhën 2019-2021. Këtu përfshiheshin informacionet rreth incidenteve të raportuara të dhunës në familje, akuzave të ngritura për vepra penale dhe kundërvajtje, rasteve në të cilat autorët kanë pasur në zotërim ose kanë keqpërdorur armë zjarri dhe rasteve të përdorimit të armëve të zjarrit në këto kontekste. Për më tepër, u kërkuan të dhëna mbi gjininë, moshën dhe marrëdhëniet e viktimave dhe të autorëve, duke përfshirë të partnerëve intimë dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Gjithashtu, u mbledhën informacione mbi llojin dhe ligjshmërinë e armëve të zjarrit të kapura. Në vijim, pyetësori kërkoi të dhëna mbi numrin e lejeve për armë zjarri të miratuara, rinovuara dhe revokuara, duke i kushtuar vëmendje të veçantë aspekteve të lidhura me dhunën në familje.

### 3. Diskutimet në grupet e fokusit

Nga data 21 mars deri më 27 prill 2023, SEESAC organizoi 15 diskutime në grupe fokusi ku u përfshinë 68 oficerë policie të cilët ishin përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe për miratimin e lejeve për armë zjarri, si dhe 17 organizata të grave. Qëllimi i grupeve të fokusit ishte identifikimi i sfidave kryesore në parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, dokumentimi i mënyrave të shumta në të cilat armët e zjarrit ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe shkëmbimi i ideve mbi forcimin e përgjigjeve institucionale dhe trajtimin e rreziqeve të lidhura me armët e zjarrit në kontekstet e dhunës në familje. Për të mbështetur këtë proces, u zhvilluan udhëzues gjithëpërfshirës për diskutimet. Puna në grupet e fokusit rezultoi në 15 raporte të detajuara.

Diskutimet në grupet e fokusit u organizuan në Sarajevë, Tiranë, Podgoricë, Prishtinë dhe Shkup.

#### 4. Burimet dytësore të të dhënave

Krahas burimeve të të dhënave të përmendura më sipër, u morën të dhëna të tjera nga Anketa e OSBE-së mbi Sigurinë dhe Mirëqenien e Grave, nga Barometri i Sigurisë (SecuriMeter), i cili është një anketim i opinionit publik rreth sigurisë që kryhet rregullisht nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, si dhe nga anketimi për perceptimin i SEESAC.

#### 5. Afati kohor

Të dhënat e analizuar të AVMP-së mbulojnë periudhën 2019-2023, ndërsa të dhënat e siguruar nga ministritë e brendshme në rajon i referohen periudhës 2019-2021.

#### 6. Sfidat

Sfidat në realizimin e kësaj analize lidheshin kryesisht me kufizimet në disponueshmërinë e të dhënave dhe në veçanti me faktin që të dhënat e mbledhura nga institucionet përkatëse nuk ishin të krahasueshme në nivel rajonal. Analiza hasi pengesa lidhur me ndryshimet e konsiderueshme në mënyrën e mbledhjes, regjistrimit dhe raportimit të të dhënave në juridiksione të ndryshme. Praktikata e ndryshme dhe shpeshherë jo të standardizuara të regjistrimit të të dhënave e bënë të vështirë përfitim të një panorame rajonale gjithëpërfshirëse mbi keqpërdorimin e armëve të zjarrit në kontekstet e dhunës në familje. Për shembull, në përgjithësi disponoheshin të dhëna për veprën penale të vrasjes. Si rezultat i numrit të lartë të rasteve të vrasjes-vetëvrasjes, në të cilat, si pasojë e vetëvrasjes së autorëve, nuk ishin ngritur akuza penale, këto shifra shpeshherë nuk pasqyronin numrin real të personave, në veçanti të grave, që kishin humbur jetën në kontekstet e dhunës në familje. Siç është dokumentuar në këtë raport, kjo vlen veçanërisht për incidentet me armë zjarri. Ndryshe nga të dhënat administrative, AVMP-ja regjistron të dhëna mbi humbjet e jetëve, të cilat janë shumë më të larta se shifrat e raportuara në kuadër të veprës penale të vrasjes. Në disa raste, veprat penale të lidhura me dhunën në familje, pra veprat penale të kryera nga të afërmit, klasifikohen si “vepra penale të tjera” dhe jo si dhunë në familje. Kjo

e vështirëson njohjen e plotë të fenomenit dhe kërkon përpjekje shtesë për marrjen e të dhënave të sakta. Për më tepër, kufizimet në të dhënat mbi praktikata për miratimin e lejeve për armë zjarri pengojnë marrjen e njohurive të përshtatshme mbi mënyrën se si trajtohen shqetësimet e lidhura me dhunën në familje.

Për të tejkaluar këto problematika, analiza ka përdorur një gamë të gjerë të burimeve të të dhënave, siç është shpjeguar më sipër. Në veçanti, për të tejkaluar mangësitë në disponueshmërinë e të dhënave, si dhe për të mundësuar një panoramë dhe krahasueshmëri në nivel rajonal, të dhënat e AVMP-së u përdorën më gjerësisht se sa ishte parashikuar.

Sfidat në disponueshmërinë e të dhënave nënvizojnë nevojën për përmirësimin e praktikave të mbledhjes dhe ndarjes së të dhënave. Trajtimi i këtyre sfidave është thelbësor për të rritur njohuritë mbi keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe për të zhvilluar strategji parandaluese efektive. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale, nxitja e bashkëpunimit ndërmjet agjencive dhe zbatimi i mekanizmave të standardizuar të raportimit janë hapa thelbësorë drejt tejkalimit të këtyre sfidave dhe garantimit të sigurisë dhe mirëqenies së individëve të prekur. Procesi i analizës konfirmoi gjithashtu se përfshirja e Njësive Qendrore për Armët e Zjarrit në mbledhjen e të dhënave mund të kontribuojë në përmirësimin e praktikave në këtë fushë.

## Kutia 1:

## Përdorimi i hulumtimeve/kërkimeve për të informuar përgjigjen institucionale dhe për të rritur parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje

Mbështetur në gjetjet e hershme, SEESAC, në bashkëpunim me autoritetet në rajon, nisi zhvillimin e dy grupeve të udhëzimeve praktike për oficerët e policisë dhe profesionistët e tjerë përkatës.

- **Udhëzimet për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve që lidhen me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje.**<sup>11</sup> Ato përfshijnë një grup listash kontrolli praktike që synojnë të ndihmojnë oficerët e policisë për të vlerësuar rreziqet e keqpërdorimit të armëve në zotërim të ligjshëm dhe të paligjshëm në kontekstin e dhunës në familje dhe për t'iu përgjigjur këtyre rreziqeve me shpejtësinë e nevojshme. Bazuar në këtë qasje, Udhëzimet ofrojnë një panoramë të veprimeve të lidhura me armët e zjarrit që duhet të ndërmerren në secilin hap të procedurave të policisë, ku përfshihen “treguesit e ndërhyrjes me rrezik të lartë”, “marrja e një raporti”, “vlerësimi i rreziqeve”, “ndërhyrja” dhe “pas incidentit”.

- **Udhëzimet për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri.**<sup>12</sup> Përmes një grupi listash kontrolli praktike, ato janë projektuar për të mbështetur profesionistët në integrimin e perspektivës gjinore në procesin e miratimit të lejeve për armë zjarri. Ky integrim synon të parandalojë në mënyrë efektive keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave në veçanti, si dhe të parandalojë keqpërdorimin e armëve të zjarrit nga grupet më të prirura drejt këtyre sjelljeve, më konkretisht meshkujt e grupmoshës 18-30 vjeç. Ato përmbajnë udhëzime të detajuara mbi mënyrën e: shqyrtimit të një aplikimi nga perspektiva gjinore, kryerjes së verifikimeve të së shkuarës, marrjes së vendimeve të informuara dhe me ndjeshmëri gjinore, si dhe garantimit të monitorimit të vazhdueshëm të pajtueshmërisë me kërkesat ligjore për armën.

Të dyja udhëzimet janë hartuar përmes një procesi të gjerë rajonal. Fillimisht, u krijuan dy grupe rajonale pune për zhvillimin e secilit prej udhëzimeve, një grup pune i përbërë nga oficerë policie me përvojë të gjerë në trajtimin e dhunës në familje<sup>13</sup> dhe një grup tjetër i përbërë nga oficerë të angazhuar në miratimin e lejeve për armë zjarri dhe oficerë që realizojnë verifikimet e së shkuarës.<sup>14</sup> Diskutimet në grupet e fokusit të realizuara në kuadër të kësaj analize, si dhe analiza e të dhënave të AVMP-së dhe e të dhënave të mbledhura nga institucionet, informuan në një masë të madhe hartimin e udhëzimeve, duke garantuar që zgjidhjet e propozuara të jenë të bazuara në evidenca dhe t'iu përgjigjen sfidave aktuale. Udhëzimet mbështeten gjithashtu në produktet e njohurisë të zhvilluara në kuadër të projektit Redukto rrezikun, Rrit sigurinë - Drejt zhdukjes së keqpërdorimit të AVL-ve në kontekstin e dhunës në familje, të zbatuar nga UNDP në Serbi, dhe përfshijnë përvoja nga Australia, Kanadaja dhe Zelanda e Re.

11 SEESAC. 2024. *Udhëzimet për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve që lidhen me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje*. Beograd: SEESAC

12 SEESAC. 2024. *Guidelines for Gender Responsive Firearms Licence Approval*. Beograd: SEESAC

13 [https://www.seesac.org/News\\_1/western-balkan-authorities-raise-institutional-capacities-for-effective-prevention-and-combatting-of-use-of-firearms-in-domestic-violence/](https://www.seesac.org/News_1/western-balkan-authorities-raise-institutional-capacities-for-effective-prevention-and-combatting-of-use-of-firearms-in-domestic-violence/)

14 [https://www.seesac.org/News\\_1/western-balkan-authorities-to-make-firearms-licensing-gender-sensitive/](https://www.seesac.org/News_1/western-balkan-authorities-to-make-firearms-licensing-gender-sensitive/)

Një tjetër raund konsultimesh<sup>15</sup> u organizua me anëtarët e grupeve të punës për të diskutuar strukturën dhe përmbajtjen e draftit të udhëzimeve, si dhe për të propozuar ndryshime me qëllim garantimin e zbatimit të tyre praktik. Për më tepër, pesë organizata të grave u angazhuan në procesin e vlerësimit mes ekspertësh dhe i kushtuan vëmendje të veçantë garantimit të trajtimit në mënyrë të përshtatshme të shqetësimeve të lidhura me sigurinë e viktimave të dhunës në familje.


Pas finalizimit të udhëzimeve, SEESAC realizoi dy trajnime rajonale të trajnuesve dhe krijoi një grup rajonal të përbërë nga 29 trajnues, të cilët, realizuan më pas 10 trajnime në institucionet e tyre përkatëse dhe trajnuan më tepër se 130 oficerë policie në mbarë rajonin në vitin 2025.

15 [https://www.seesac.org/News\\_1/regional-consultations-on-practical-tools-to-prevent-the-misuse-of-firearms-in-gender-based-violence\\_1/](https://www.seesac.org/News_1/regional-consultations-on-practical-tools-to-prevent-the-misuse-of-firearms-in-gender-based-violence_1/)

---

## Kapitulli 3

# Dhuna në familje – shkalla e problemit



Njohuritë mbi format, përhapjen, dinamikat dhe modelet e dhunës në familje<sup>16</sup> dhe dhunës ndaj grave, si dhe mbi faktorët strukturorë që nxisin këtë lloj dhunë, sigurojnë kontekstin thelbësor për identifikimin e rreziqeve specifikeve të lidhura me armët e zjarrit në këtë kontekst. Këto njohuri mundësojnë një vlerësim më të saktë të mënyrës se si disponueshmëria dhe përdorimi i armëve të zjarrit përshkallëzojnë dhunën dhe rrisin cenueshmërinë e viktimave, në veçanti të grave.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur gjithashtu si Konventa e Stambollit, e përkufizon dhunën në familje si të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes apo ambientit familjar, ose ndërmjet bashkëshortëve apo partnerëve të mëparshëm ose aktualë, pavarësisht faktit nëse autori jeton aktualisht në të njëjtën banesë me viktimën, ose ka jetuar më parë në të njëjtën banesë me të.

Gratë dhe vajzat janë të ekspozuara ndaj një rreziku më të lartë të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore se sa burrat. Dhuna ndaj grave në ambientet familjare ndryshon nga llojet e tjera të dhunës sepse është me bazë gjinore, pra është dhunë që ushtrohet ndaj një gruaje për vetë faktin sepse ajo është grua, ose prek gratë në një masë më të madhe, në mënyrë joproporcionale. Ajo përfaqëson të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, pavarësisht nëse ndodh në jetën publike ose private.

Dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj

grave. Ajo është një manifestim i marrëdhënieve historike të pabarabartë të pushtetit ndërmjet grave dhe burrave që ka çuar në dominimin dhe diskriminimin e grave nga burrat dhe në pengimin e përparimit të plotë të grave.

Dhuna në familje, veçanërisht dhuna nga partneri intim e ushtruar nga burrat, i referohet një modeli të marrëdhënies ku individët përdor sjellje abuzive për të fituar ose ruajtur pushtetin dhe kontrollin mbi partneret. Si e tillë, dhuna në familje përbën gjithmonë abuzim të pushtetit dhe kontrollit nga autori. Taktikat e përdorura nga autorët përfshijnë shtrëngimin dhe kërcënimet, abuzimin emocional, izolimin, frikësimin, si dhe përdorimin e privilegjeve mashkullore<sup>17</sup> dhe të fëmijëve për të fituar dhe ruajtur kontrollin mbi partneren.<sup>18</sup> Prania dhe përdorimi i armëve të zjarrit janë instrumente efektive për të ushtruar pushtetin dhe kontrollin në këtë kontekst.

Rrallë ndodh që incidentet e dhunës në familje të jenë raste të izoluara dhe në përgjithësi, shpeshtësia dhe ashpërsia e tyre përshkallëzohet dhe rrezikon të kulmojë në lëndime të rënda fizike ose edhe në vdekje. Për rrjedhojë, për të parandaluar dhunën në familje është thelbësore të kuptohen dinamikat dhe fazat e saj.

Forma më ekstreme dhe më e rëndë e dhunës ndaj grave është femicidi (e njohur gjithashtu si feminicidi), pra vrasja e qëllimshme, me motive gjinore, e grave dhe vajzave. Femicidi nënkupton vrasjen e një gruaje nga një burrë, të nxitur nga urrejtja ndaj grave, përbuzja, kënaqësia, ndjesia e pronësisë dhe pushteti mbi gratë. Femicidi ndryshon në mënyra specifike nga vrasja e burrave. Për shembull, shumica e rasteve të vrasjeve të grave (femicidit) kryhen nga partnerët ose ish-partnerët, dhe përfshijnë abuzim të vazhdueshëm në shtëpi, kërcënime apo kanosje, dhunë seksuale, apo situata në të cilat gratë kanë

16 Përkufizimet në këtë kapitull janë marrë nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

17 Privilegjet mashkullore janë sistemi i avantazheve dhe të drejtave që disponojnë burrat si pasojë e gjinisë së tyre dhe bazohet në idenë dhe praktikën e dominimit të dominimit të burrave ndaj grave. Duke nënshtruar sistematikisht gratë, burrat fitojnë avantazhe ekonomike, politike, sociale, arsimore dhe praktike, të cilat në përgjithësi nuk janë të disponueshme për gratë. Dhuna në familje mund të nxisë privilegjet mashkullore në shoqërinë e ditëve të sotme. Ajo përforcon pozitën e pushtetit që u atribuohet burrave, duke bërë kështu që gratë të vazhdojnë të vuajnë pasojat e saj. Privilegjet mashkullore rriten përmes mënyrave të objektivizimit të grave, si dhe përmes perceptimit se ato kanë rolin t'u shërbejnë nevojave të partnerëve të tyre meshkuj. Burrat mund ta marrin për të mirëqenë se u takon e drejta e ushtrimit të kontrollit ndaj grave. Diçka e tillë krijon një ndjesi autoriteti që shfaqet përmes kanosjes, ndëshkimit dhe taktikave të tjera të kontrollit. (Burimi: *Domestic Violence and Male Privilege*).

18 Për detaje të mëtejshme, shihni Amandra Kippert (2021). What are the Power and Control Wheels?.

më pak pushtet ose më pak burime se partnerët e tyre.<sup>19</sup>

Shpeshherë, dhuna justifikohet nga qëndrimet, normat dhe pritshmëritë sociale dhe kulturore, të cilat mbështesin përdorimin e dhunës nga burrat për të ruajtur pushtetin dhe kontrollin mbi partneren ose ish-partneren e tyre. Studimet e kanë lidhur dhunën gjinore me pranimin social të dominimit mashkullor, me krijimin e stereotipave për rolet gjinore, si dhe me pranimin e dhunës si një mënyrë normale për të zgjidhur konfliktin. E njëjta gjë është dokumentuar në Ballkanin Perëndimor. Stereotipat gjinorë mund të nxisin dhunën ndaj grave, si dhe zotërimin dhe përdorimin e armëve, ndërsa mbizotërimi i qëndrimeve pozitive ndaj

zotërimit të armëve në një komunitet mund të pengojë përpjekjet për të ulur dhunën në familje me armë zjarri.

Edhe pse dhuna në familje mund t'i ndodhë si grave po ashtu dhe burrave, modelet, nivelet e ekspozimit dhe shkaqet e viktimizimit të grave dhe burrave në kontekstin familjar ndryshojnë ndjeshëm. Në kontekstin familjar, gratë janë më të rrezikuara ndaj dhunës së ushtruar nga partnerët intimë, qoftë aktualë ose të mëparshëm, ndërsa burrat janë përgjithësisht të rrezikuar nga anëtarët e tjerë të familjes, kryesisht nga anëtarët e tjerë meshkuj. Dhuna ndaj burrave zakonisht nuk ka bazë gjinore dhe lidhet me mosmarrëveshjet familjare, problemet e pronësisë, dhunën e rrënjosur ndër breza etj.

## Përhapja e dhunës në familje në Ballkanin Perëndimor


Dhuna në familje është e pranishme në Ballkanin Perëndimor dhe sjell një ndikim të dëmshëm joproportional në sigurinë dhe mirëqenien e grave. Përhapja dhe karakteristikat e dhunës ndaj grave në kontekstin familjar janë dokumentuar gjerësisht nga anketa e udhëhequr nga OSBE, e cila mbetet burimi më i fundit i të dhënave të krahasueshme në nivel rajonal.<sup>20</sup>

Sipas anketës, më tepër se gjysma e grave në Ballkanin Perëndimor janë përballur me një formë dhune duke filluar nga mosha 15 vjeç. Përqindja më e lartë e grave që kanë raportuar një nga format e dhunës është dokumentuar në Shqipëri me 67%, pasuar nga Serbia me 62%, Kosova me 58%, Maqedonia e Veriut me 54%, Mali i Zi me 51% dhe Bosnjë-Hercegovina me 48%. Niveli i lartë i përhapjes së dhunës ndaj grave krijon shqetësime specifike lidhur me praninë e armëve të zjarrit dhe rolin e tyre në ushtrimin e kësaj dhune.

19 Organizata Botërore e Shëndetësisë. 2012. *Understanding and addressing violence against women*.

20 Për më shumë informacion, shihni raportin kryesor të Anketës së udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave. Raporti paraqet gjetjet e krahasueshme ndër-rajonale të anketës së OSBE-së mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave, e cila u krye në vitin 2018 në juridiksione të përzgjedhura në Evropën Juglindore dhe Lindore. Anketa kombinoi komponentin sasior dhe cilësor dhe u krye me synimin për të ofruar të dhëna të krahasueshme mbi format e ndryshme të dhunës së përjetuar nga gratë në fëmijëri dhe gjatë gjithë jetës së tyre. Ajo shqyrtoi dhunën e përjetuar nga gratë në situata konflikti ose jo konflikti, si dhe ndikimin e dhunës të gratë dhe vajzat, duke përfshirë pasojat e saj të afatgjata. Të anketuarve iu bënë pyetje rreth normave dhe qëndrimeve në lidhje me dhunën ndaj grave për të kuptuar më mirë shkaqet në themel të dhunës.

**Figura 1:**  
**Niveli i përhapjes së llojeve të ndryshme të dhunës ndaj grave (në %) që nga mosha 15 vjeç**



Burimi: Anкета e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave, 2019

Forma më e përhapur e dhunës së përjetuar nga gratë në të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor është dhuna psikologjike nga partneri intim, pasuar nga ngacmimi seksual.

Një problematikë tejet serioze është edhe niveli i përhapjes së dhunës fizike. Përqindja e grave që kanë përjetuar dhunë fizike ndryshon në rajon, nga 14% në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, në 15% në Bosnjë-Hercegovinë, 19% në Mal të Zi, e deri në 22% në Shqipëri dhe Serbi. Gratë në Ballkanin Perëndimor kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një partner intim se sa nga një jo partner. Për më tepër, gratë kanë më shumë gjasa të

raportojnë se kanë përjetuar shumicën e formave të dhunës nga një ish-partner se sa nga partneri i tyre aktual. Siç është konstatuar, kjo tendencë mund të lidhet me faktin se gratë janë më të gatshme të zbulojnë dhunën nga marrëdhëniet e mëparshme se sa në marrëdhëniet aktuale, ose mund të tregojë se dhuna ka qenë një faktor që ka kontribuar në përfundimin e marrëdhënieve të kaluara, siç është raportuar shpeshherë nga gratë.<sup>21</sup> Përndjekja renditet ndër format më të përhapura të dhunës me të cilën përballen gratë dhe përqindja e grave që e kanë përjetuar këtë lloj dhune varion nga 5% deri në 13%.

Tabela 1:

### Niveli i përhapjes së dhunës fizike dhe/ose seksuale që nga mosha 15 vjeç, sipas llojit të autorëve

	Partneri/ja aktual/e, %			Ish-partneri/ja, %			Partneri/ja, %			Jo partneri/ja, %		
	Dhunë fizike	Dhunë seksuale	Dhunë fizike dhe/ose seksuale	Dhunë fizike	Dhunë seksuale	Dhunë fizike dhe/ose seksuale	Dhunë fizike	Dhunë seksuale	Dhunë fizike dhe/ose seksuale	Dhunë fizike	Dhunë seksuale	Dhunë fizike dhe/ose seksuale
Shqipëria	17	3	18	22	6	23	19	4	19	11	1	11
Bosnjë-Hercegovina	6	2	6	11	4	11	10	4	11	7	1	8
Mali i Zi	11	3	12	15	2	15	17	3	17	8	1	9
Maqedonia e Veriut	6	2	7	10	4	12	9	3	10	6	2	7
Serbia	9	3	10	17	5	18	17	5	17	8	2	9
Kosova	8	4	9	15	6	18	9	4	11	7	1	8


Burimi: Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave, 2019

Anketa dokumentoi gjithashtu se format e ndryshme të dhunës së përdorur nga partnerët intimë janë rrallëherë një përvojë e izoluar. Shpeshherë, gratë konstatuan se kishin përdorur dhunë më shumë se një herë, duke iu referuar në veçanti dhunës nga ish-partnerët.<sup>22</sup>

Për sa i përket dhunës psikologjike nga partneri intim, sjellja kontrolluese është forma më e përhapur në të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, pasuar me një diferencë jo shumë të madhe nga sjellja abuzive, dhuna ekonomike, si dhe përdorimi apo abuzimi i fëmijëve për qëllime shtrengimi apo shantazhi.

Figura 2:

### Niveli i përhapjes së llojeve të ndryshme të dhunës psikologjike nga partneri intim, në %



Burimi: Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave, 2019


Anketa dokumentoi një sërë formash të sjelljeve kontrolluese që mund të ndikojnë ndjeshëm në jetët e grave, mund të kufizojnë autonominë e tyre dhe mund të kenë implikime të thella për lirinë e tyre personale, shëndetin dhe mirëqenien në përgjithësi.

Dhuna ka ndikime shkatërrimtare dhe të shumfishta në mirëqenien e grave, si dhe ka pasoja të rënda fizike dhe efekte psikologjike. Hematomat dhe gërvishtjet ishin ndër pasojat fizike të raportuara më shpesh, pasuar nga plagët, ndrydhjet dhe djegiet. Në shumicën e rasteve, lëndimet raportoheshin si rezultat i incidentit më të rëndë të shkaktuar nga një ish-partner.<sup>23</sup> Dhuna shkakton pasoja psikologjike negative dhe afatgjata tek të mbijetuarat. Në shumicën e të mbijetuarave të dhunës fizike dhe/ose seksuale janë zhvilluar të paktën një nga simptomat

psikologjike afatgjata, kryesisht ankthi dhe depresioni, pasuar nga ndjesia e cenueshmërisë, humbja e vetëbesimit, pagjumësia etj.<sup>24</sup>

Pavarësisht nivelit të përhapjes, rastet e dhunës, ngacmimit seksual dhe përndjekjes shpeshherë nuk raportohen në institucione. Anketa dokumentoi se edhe pas incidenteve më të rënda të dhunës fizike dhe/ose seksuale, në shumicën e rasteve policia nuk është informuar, siç tregohet në figurën 3 më poshtë. Viktimat kanë shumë më tepër gjasa që t'i raportojnë incidentet më të rënda kur ato kryhen nga një jo partner se sa nga një partner intim. Për më tepër, dhuna e ushtruar nga partnerët aktualë ka gjasat më të mëdha që të mos raportohet dhe niveli i raportimit të kësaj lloji dhune është shumë më i ulët se sa dhuna e kryer nga ish-partnerët.

**Figura 3:**  
**Kontaktimi i policisë nga viktimat pas incidentit më të rëndë të dhunës nga partnerët aktualë/të mëparshëm, ose nga një jo partner**



Burimi: Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave, 2019

Në vijim, anketa tregon se gratë kanë më shumë gjasa që ta raportojnë në polici dhunën nga një ish-partner nëse dhuna ka qenë arsyeja

kryesore për përfundimin e marrëdhënies, çka sugjeron se viktima do të duhet të përballet me

23 Po aty, faqja 86.  
24 Po aty, faqja 88.

një nivel të rëndë dhune përpara se të kërkojë ndihmën e policisë.<sup>25</sup>

Policia ka akoma më pak gjasa që të informohet nga persona të tjerë rreth rasteve të rënda të dhunës. Në rastin e dhunës nga ish-partneri, vetëm 4% e grave që identifikuan incidentin e tyre më të rëndë raportuan se dikush tjetër e kishte informuar policinë, apo se autoritetet kishin marrë dijeni rreth situatës pa e raportuar dikush. E njëjta gjë vlen për 3% të grave në rastet dhunës nga një jo partner dhe për pak më tepër se 0,5% të grave në rastet e dhunës nga partneri aktual. Gjasat e raportimit të dhunës në polici ose në organizata të tjera variojnë bazuar në natyrën e dhunës së përjetuar. Gratë kanë më pak gjasa që të kontaktojnë autoritetet nëse incidenti i tyre më i rëndë përfshin vetëm kërcënime, qoftë


fizike apo seksuale. Megjithatë, kur incidenti përfshin dhunë fizike ose seksuale, rriten gjasat për raportimin në polici ose në organizata të tjera. Viktimat e krimeve seksuale kanë më pak gjasa që të raportojnë në polici, krahasuar me viktimat që përjetojnë dhunë fizike. Kjo tendencë ndikohet nga niveli i lartë i ndjenjës së turpfit dhe sikletit të lidhur me dhunën seksuale.<sup>26</sup>

Në shumicën e rasteve, incidenti më i rëndë raportohet nga vetë të mbijetuarat dhe vetëm në raste përjashtimore nga persona të tjerë.

Gjithashtu, gratë zgjedhin të mos kontaktojnë shërbime të tjera, dhe në rastet kur vendosin të raportojnë incidentin e tyre më të rëndë, ka më shumë gjasa që të kontaktojnë institucionet e kujdesit shëndetësor.

Figura 4:

### Si e ka zbuluar policia incidentin më të rëndë (të gjithë autorët)?



Burimi: Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave, 2019

Anketa dokumentoi faktorë të shumfishtë që kontribuojnë në mosraportimin e dhunës, dhe arsyeja më e zakonshme që gratë nuk e kontaktojnë policinë apo ofruesit e tjerë të shërbimeve pas përjetimit të dhunës, është se vendosin ta zgjidhin vetë incidentin. Faktorë të tjerë janë ndjenja e turpfit, shqetësimet financiare, mungesa e besimit tek institucionet, mungesa e njohurive mbi shërbimet e specializuara dhe në

veçanti frika nga hakmarrja, çka rrit shqetësimet e viktimave se raportimi mund të rezultojë në përshkallëzim të dhunës nga autori.<sup>27</sup>

Një anketim i opinionit publik mbi sigurinë në Ballkanin Perëndimor dokumentoi më tej përhapjen e lartë të dhunës në familje. Në vitin 2022, 40% e të anketuarve në rajon u shprehën se njihnin dikë në familjen, lagjen apo komunitetin e tyre që kishte përjetuar dhunë në familje.


25 Po aty, faqja 95.

26 Po aty, faqja 99.

27 Po aty, faqja 103.

Figura 5:

**A njihni dikë (në familjen, lagjen apo komunitetin tuaj) që ka përjetuar dhunë në familje?**




Burimi: Barometri i Sigurisë (SecuriMeter) i KBR-së, 2022

Rezultatet e anketës tregojnë një rritje të ndërgjegjësimit të publikut mbi rëndësinë e parandalimit dhe luftimit të dhunës në familje në Ballkanin Perëndimor. Në tërësi, në rajon,

72% e konsiderojnë dhunën në familje si një kërcënim të rëndë të sigurisë në juridiksionin e tyre, krahasuar me 25% të të anketuarve që nuk e konsiderojnë të tillë.

Figura 6:

**Deri në çfarë mase bini dakord me pohimin në vijim: Dhuna në familje përfaqëson një kërcënim të rëndë ndaj sigurisë.**



Burimi: Barometri i Sigurisë (SecuriMeter) i KBR-së, 2022

---

## Kapitulli 4


# Ndikimi i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje

## 4.1 Sfidat në identifikimin e shpeshtësisë së keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje

Sipas të dhëna të paraqitura nga ministrinë e brendshme në rajon, numri total i incidenteve të dhunës në familje të raportuara në polici ka

mbetur konstant në nivel rajonal gjatë periudhës së raportimit, me përjashtim të vitit 2021 kur është dokumentuar një rritje e lehtë.

**Figura 7**  
Numri i incidenteve të dhunës në familje të raportuara në polici, 2019-2021




Burimi: Ministrinë e brendshme në Ballkanin Perëndimor

Numri i incidenteve<sup>28</sup> të raportuara në Shqipëri dhe Kosovë është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë periudhës së raportimit,

ndërkohë që është ulur në Bosnjë-Hercegovina<sup>29</sup> dhe në Malin e Zi.

**Figura 8**  
Numri i incidenteve të dhunës në familje të raportuara në polici, 2019-2021



Burimi: Ministrinë e brendshme në Ballkanin Perëndimor

28 Për Maqedoninë e Veriut nuk disponoheshin të dhëna specifike.

29 Në Bosnjë-Hercegovinë, të dhënat janë dorëzuar nga Republika e Sërpskas, rrethi Brčko i BH-së, Kantoni i Sarajevës, Kantoni i Zenica-Doboj, Kantoni i Hercegovinës Perëndimore, Kantoni i Una-Sana, Kantoni i Tuzlës, Kantoni i Posavinës dhe Kantoni 10.

Në Shqipëri, ka pasur një rritje të qëndrueshme të kërkesave të banorëve për urdhra mbrojtjeje. Në vitin 2019, numri i kërkesave ishte 1792, një numër ky i cili u rrit në 1886 në vitin 2020 dhe në 2046 në vitin 2021. Po ashtu, numri i urdhrave të mbrojtjes të lëshuar shfaqti një tendencë në rritje, nga 2836 urdhra në vitin 2019, në 2816 në vitin 2020 dhe 3151 në vitin 2021.

Në Bosnjë-Hercegovinë, 3580 vepra penale të dhunës në familje rezultuan në akuza penale.

Në Kosovë, gjatë periudhës 2019-2021, policia ngriti 6358 akuza penale për dhunë në familje, përkatësisht 1859 në vitin 2019, 2061 në vitin 2020 dhe 2438 në vitin 2021.

Gjatë të njëjtës periudhë, u ngritën 931 akuza penale për dhunë në familje në Mal të Zi, përkatësisht 305 në vitin 2019, 315 në vitin 2020 dhe 311 në vitin 2021. Në të njëjtën periudhë, u ngritën 4476 akuza për kundërvajtje, përkatësisht 1548 në vitin 2019, 1474 në vitin 2020 dhe 1454 në vitin 2021.

Në Maqedoninë e Veriut, statistikat zyrtare nuk gjenerojnë të dhëna statistikore mbi numrin e çështjeve të depozituara, por mbi veprat penale dhe kundërvajtjet e kryera. Për sa i përket veprave penale, janë kryer 989 në vitin 2019, 992 në vitin 2020 dhe 1056 në vitin 2021. Për sa i përket kundërvajtjeve, janë kryer 470 në vitin 2019, 486 në vitin 2020 dhe më pas është

regjistruar ulje në 379 në vitin 2021. Lidhur me dhunën në familje, janë marrë 3196 ankesa ("poplaka") në vitin 2019, 3759 në vitin 2020 dhe 3761 në vitin 2021.

Disponueshmëria e kufizuar e të dhënave na pengon të kuptojmë shpeshësinë e pranisë dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje. Për shembull, në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, kishte të dhëna të disponueshme vetëm për rastet në të cilat armët e zjarrit ishin përdorur si mjet për kryerjen e një vepre penale, çka do të thotë se numri i tyre mund të jetë shumë më i ulët se numri i rasteve të dhunës në familje në të cilat autori ka zotëruar një armë zjarri, pavarësisht nëse është përdorur apo jo. Në Bosnjë-Hercegovinë, jo të gjitha njësitë i dorëzuan këto të dhëna. Edhe pse janë të kufizuara, të dhënat e disponueshme treguan se, ndryshe nga numri i konsiderueshëm i rasteve të raportuara të dhunës në familje, numri i rasteve në të cilat është regjistruar se autori ka pasur një armë zjarri në zotërim, qoftë të ligjshme apo të jashtëligjshme, ka vijuar të jetë relativisht i ulët gjatë kësaj periudhe.

Për shembull, në Shqipëri, vetëm 1,4% e rasteve të raportuara të dhunës në familje përfshinin një autor që zotëronte një armë zjarri të ligjshme ose të jashtëligjshme. Në Bosnjë-Hercegovinë, kjo shifër është 3,3%, ndërsa në Kosovë 0,2%.

Tabela 2

### Numri i incidenteve të raportuara të dhunës në familje në të cilat është regjistruar se autori i dhunës në familje ka pasur një armë zjarri në zotërim, qoftë të ligjshme apo të jashtëligjshme

	2019	2020	2021
Shqipëria	23	24	16
Bosnjë-Hercegovina	66	75	76
Kosova	5	8	Nuk ka
Mali i Zi	Nuk ka	2	2
Maqedonia e Veriut	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Burimi: Ministrinë e brendshme në Ballkanin Perëndimor

Në terma absolutë, gjatë të njëjtës periudhë, në Shqipëri u regjistruan 31 raste në të cilat autorët kishin në zotërim dhe kishin keqpërdorur<sup>30</sup> armë zjarri, dhe 32 raste në të cilat zotëroheshin armë zjarri, por nuk ishin përdorur. Në Bosnjë-Hercegovinë, të dhënat e pjesshme të dorëzuara nga njësi të ndryshme konstatuan 26 raste të keqpërdorimit të armëve të zjarrit, si dhe 194 raste në të cilat autorët kishin armë zjarri në zotërim, por nuk i kishin përdorur. Mali i Zi raportoi katër raste të keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe një rast në të cilën kishte armë zjarri në përdorim, por nuk ishte përdorur. Në Maqedoninë e Veriut, këto të dhëna nuk gjenerohen përmes statistikave zyrtare. Megjithatë, sipas mjeteve të kryerjes së veprës penale, në fushën e dhunës në familje, në vitet 2019 dhe 2020 u regjistruan pesë vepra penale të kryera me armë zjarri, ndërsa në vitin 2021, u regjistruan 11 vepra penale të këtij lloji. Gjatë periudhës së raportimit, nuk u regjistruan vepra penale të kryera me armë zjarri


në fushën e dhunës në familje. Këto të dhëna nuk disponoheshin për Kosovën.

Këto shifra të ulëta mund të pasqyrojnë gjithashtu praktikat për regjistrimin e të dhënave, të cilat nuk kapin plotësisht realitetin në terren, çka nënvizon nevojën për analizë të mëtejshme.

Një tendencë e ngjashme e nivelit të ulët të raportimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje shfaqet qartësisht edhe në të dhënat e gjeneruara përmes AVMP-së, të cilat tregojnë se **keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje raportohet shumë më pak krahasuar me llojet e tjera të incidenteve**, duke përfshirë incidentet që ndodhin në kontekstin kriminal, mosmarrëveshjet në publik apo të shtënat për shkaqe të papërcaktuara. Gjatë periudhës 2019-2023, **incidentet e lidhura me armët e zjarrit në kontekstin e dhunës në familje përbënin vetëm 3,1% të të gjitha incidenteve të raportuara me armë zjarri**, një tendencë e cila vijoi gjatë të gjithë periudhës.

Figura 9

### Numri i incidenteve të lidhura me armët e zjarrit në Ballkanin Perëndimor (BP), sipas llojit të incidentit, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Gjatë të njëjtës periudhë, AVMP-ja dokumentoi një rritje të qëndrueshme të numrit të raportuar të incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje. Më

konkretisht, numri i këtyre incidenteve u rrit me 72%. Kjo rritje mund të ketë ardhur si pasojë e rritjes faktike të incidenteve, ose si pasojë e përmirësimit të mekanizmave të raportimit, duke


30 Për qëllime të këtij hulumtimi, keqpërdorimi i armëve të zjarrit i referohet çdo lloj forme të përdorimit të armëve të zjarrit për qëllime të kërcënimit, kanosjes, kontrollit, shtrëngimit, dhunës psikologjike, dhunës seksuale, dhunës ekonomike, sulmit, plagosjes apo vrasjes, dhe të dhënat janë kërkuar në përputhje me këtë përkufizim.

përfshirë të shtimit të vëmendjes së mediave ndaj kësaj problematike. SEESAC bëri përpjekje të bashkërenduara për të ndikuar në mënyrë pozitive diskursin publik mbi temën e dhunës në familje, specifikisht të dhunës së kryer me armë zjarri. Për të krijuar një bazë referencë, u realizua analiza e raportimit mediatik mbi këtë fenomen në rajonin e Ballkanit Perëndimor<sup>31</sup>. Në bazë të rezultateve, u organizuan trajnime<sup>32</sup> për përfaqësuesit e ministrive të brendshme, shërbimeve policore, organeve të prokurorisë dhe medias, me qëllimin për t'i ndihmuar ata që të kuptojnë më mirë fenomenin dhe të përmirësojnë mënyrën se si e raportojnë te publiku. U zhvilluan udhëzimet për

komunikimin më të mirë me median mbi temën<sup>33</sup> e dhunës në familje me armë zjarri, për MB-të dhe shërbimet policore. Në Serbi, u realizua një punë pioniere nga UNDP në Serbi, e cila, në vitin 2017, së bashku me Fondin B92, krijoi grupin “Gazetarët kundër Dhunës ndaj Grave”<sup>34</sup>. Në kuadër të punës së tij, dhe me mbështetjen e vazhdueshme të UNDP-së, grupi monitoron cilësinë e mbulimit nga media të rasteve të dhunës ndaj grave, bazuar në tregues të përcaktuar dhe të mirëzhvilluar, ka hartuar Udhëzimet për raportimin mediatik mbi dhunën ndaj grave,<sup>35</sup> si dhe ofron trajtime për përfaqësuesit e mediave<sup>36</sup> për të ndihmuar në përmirësimin e praktikave të tyre të raportimit.

Figura 10

### Numri i incidenteve të lidhura me armët e zjarrit në BP (me përjashtim të armëve të kapura), sipas llojit të incidentit dhe vitit, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

31 SEESAC. 2024. *Analiza e raportimit mediatik mbi keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore ndaj grave nga meshkujt në Ballkanin Perëndimor*. Beograd: SEESAC, 2024.

32 [https://www.seesac.org/News\\_1/seesac-finalizes-the-second-round-of-trainings-on-the-ethics-of-informing-the-public-about-incidents-of-firearms-misuse-in-domestic-violence-context/](https://www.seesac.org/News_1/seesac-finalizes-the-second-round-of-trainings-on-the-ethics-of-informing-the-public-about-incidents-of-firearms-misuse-in-domestic-violence-context/)

33 SEESAC. *Udhëzimet për zyrtarët e ministrive të brendshme dhe të shërbimeve policore rreth komunikimit me median në rastet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore*. Beograd: SEESAC, 2024.

34 <https://novinarkeprotivnasilja.org/>

35 Gligorijević, Jovana, Pavlović, Sanja dhe Cvetićanin Knežević, Hristina. *Udhëzimet për raportimin mediatik mbi dhunën ndaj grave*. Beograd: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, 2021.

36 <https://www.undp.org/serbia/stories/media-training-step-towards-better-reporting-violence-against-women>

Faktorët që kontribuojnë në nivelet vazhdimisht të ulëta të raportimit të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën

në familje, duke përfshirë ndikimin e armëve të zjarrit në stepjen e viktimave që të raportojnë, janë shqyrtuar në detaje në kapitullin 7.

## 4.2 Karakteristikat e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje


### Ndikimet dhe rreziqet e ndryshme gjinore të keqpërdorimit të armëve të zjarrit

Sipas AVMP-së, gratë përbënin shumicën e viktimave (62,8%) në incidentet e regjistruara me armë zjarri në kontekstin familjar gjatë periudhës 2019-2023, krahasuar me burrat (37,2%), ose përkatësisht 342 dhe 203 raste. Gjatë periudhës

në shqyrtim, numri i incidenteve të regjistruara që kanë prekur gratë është rritur nga 48 në 91, çka përfaqëson një rritje prej 89,6%, ndërsa incidentet që prekin burrat janë rritur nga 50 në 57, ose me 14%<sup>37</sup>.

Figura 11

### Viktimat e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje në BP, sipas gjinisë, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Siç konstatohet nga tabela më poshtë, gratë përbëjnë shumicën e viktimave<sup>38</sup> të incidenteve me armë zjarri në dhunën në familje në të gjitha

juridiksionet e Ballkanit Perëndimor. Përqindja e grave në totalin e viktimave varion nga 53,1% në Mal të Zi e deri në 69,9% në Serbi.

37 Në të njëjtën periudhë, nuk është raportuar gjinia e 27 viktimave.

38 Në AVMP, një viktimë përkufizohet si një individ që është kërcënuar, lënduar, apo vrarë si rezultat i përdorimit të armëve të zjarrit/municioneve/lëndëve plasëse. Viktimat përfshijnë gjithashtu individët që kanë qenë të pranishëm në momentin kur është shkrepur një armë zjarri, por që nuk kanë pësuar lëndime nga shkrepja e armës, si dhe individët që kanë qenë të pranishëm gjatë një incidenti ku arma e zjarrit është shfaqur por nuk është përdorur.

Tabela 3

## Viktimat e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje, sipas gjinisë, vitit dhe juridiksionit

Juridiksioni	2019		2020		2021		2022		2023		Burra (%) (2019-2023)	Gra (%) (2019-2023)
	B	G	B	G	B	G	B	G	B	G		
Shqipëria	7	7	7	15	9	13	11	20	15	17	40,5%	59,5%
Bosnjë- Hercegovina	8	12	8	8	2	9	2	5	7	9	38,6%	61,4%
Kosova	2	10	11	11	9	25	10	28	16	15	35%	65%
Mali i Zi	3	1	4	3	3	2	2	1	3	10	46,9%	53,1%
Maqedonia e Veriut	5	3	2	6	4	2	10	9	3	8	46,2%	53,8%
Serbia	10	15	6	22	4	9	7	15	13	32	30,1%	69,9%
<b>TOTALI</b>	<b>35</b>	<b>48</b>	<b>38</b>	<b>65</b>	<b>31</b>	<b>60</b>	<b>42</b>	<b>78</b>	<b>57</b>	<b>91</b>	<b>37,2%</b>	<b>62,8%</b>

Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Përqindja më e lartë e grave në totalin e viktimave është regjistruar në Serbi, pasuar me diferencë të vogël nga Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Shqipëria. Në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, dallimet ndërmjet përqindjes së grave dhe burrave ishin më të ulëta.

Të dhënat zyrtare të disponueshme për viktimat e incidenteve të dhunës në familje me armë zjarri të raportuara në polici në Ballkanin Perëndimor, tregojnë se, në mbarë rajonin, gratë përbëjnë shumicën e viktimave të këtyre incidenteve. Nga viti 2019 deri në vitin 2021, gratë përbënin 71,9% të viktimave të incidenteve të dhunës në familje me armë zjarri në Shqipëri, ndërsa burrat 28,1%, kurse në Mal të Zi, gratë përbënin 80% të viktimave dhe burrat 20%. Një tendencë e ngjashme është konfirmuar gjithashtu nga të dhënat e kufizuara të siguruar nga njësitë në Bosnjë-Hercegovinë,<sup>39</sup> sipas të cilave gratë përbëjnë 72% të viktimave, ndërsa burrat 28%.

\*\*\*

Edhe pse keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje prek si gratë po ashtu dhe burrat, ndikimi joproporcional te gratë dhe natyra me bazë gjinore e këtij fenomeni dalin qartësisht në pah kur shqyrtohen kontekstet specifike dhe modelet e viktimizimit të përjetuara nga gratë dhe burrat në Ballkanin Perëndimor.

Në kontekstin e kriminalitetit me armë zjarri, gratë dhe burrat përjetojnë modele të ndryshme viktimizimi, ndërkohë që niveli dhe konteksti i ekspozimit të tyre ndaj dhunës me armë kanë specifika thellësisht gjinore.


Nga totali i incidenteve me armë zjarri që kanë prekur gratë, të regjistruara nga AVMP-ja, 29,8% kanë ndodhur në kontekstin e dhunës në familje, duke e renditur këtë kontekst në vendin e dytë pas incidenteve kriminale që përbënin 49,1% të totalit. Duke pasur parasysh nivelin e mosraportimit të dhunës në familje, i cili përshkallëzohet më tej nga prania e armëve të zjarrit, përqindja reale e këtyre incidenteve ka gjasa të jetë edhe më e lartë. Për sa i përket

llojeve të tjera të incidenteve, me përjashtim të kategorisë “të tjera/të panjohura”<sup>40</sup>, asnjë kategori tjetër (si p.sh. mosmarrëveshjet në publik, të shtënat aksidentale, të shtënat gjatë festimeve, gjuetia apo mosmarrëveshjet me policinë) nuk tejkalon pesë për qind të totalit të incidenteve me armë zjarri që përfshijnë gratë. Rreziku i lartë që paraqesin armët e zjarrit për gratë thellohet edhe më tej kur shqyrtohen pasojat fatale të këtyre incidenteve, diçka që do të trajtohet më vonë në raport.


Ndryshe nga gratë, burrat kanë më shumë gjasa që të përballen me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e mosmarrëveshjeve në publik, të cilat përbëjnë mbi një të tretën e totalit të incidenteve, përkatësisht 34%. Ato pasohen nga incidentet e kategorizuara si “të tjera/të panjohura” me 27,4%, konteksti kriminal me 23,4%, si dhe të shtënat aksidentale ose gjatë festimeve dhe gjuetia me 6,7%.

Një krahasim i konteksteve tregon se gratë kanë pothuajse pesë herë më shumë gjasa se burrat që të përjetojnë keqpërdorim të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, përkatësisht 29,8% për gratë dhe 6,2% për burrat.

**Figura 12**  
Përqindja e viktimave gra në incidentet e lidhura me armët e zjarrit në BP, sipas llojit të incidentit, 2019-2023



**Figura 13**  
Përqindja e viktimave burrave në incidentet e lidhura me armët e zjarrit në BP, sipas llojit të incidentit, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë


40 Kategoria “Të tjera”, e cila është një kategori e veçantë në llojet e incidenteve me armë zjarri, u referohet vetëvrasjeve, të shtënave në rrethana të papërcaktuara, të shtënave kundrejt kafshëve që nuk lidhen me gjuetinë, shpërthimeve për shkaqe të papërcaktuara, përdorimit të armëve për mbrojtje dhe të gjitha incidenteve të tjera që nuk mund të klasifikohen në një nga kategoritë e mësipërme.

Janë konstatuar ndryshime të konsiderueshme gjatë periudhës së analizuar. Me përjashtim të vitit 2021, përqindja e incidenteve në kontekstin e dhunës në familje është rritur si për gratë po ashtu dhe për burrat. Kjo rritje

ishte më e konsiderueshme te gratë, përqindja e të cilave pothuajse është dyfishuar, nga 20,6% në 40,1%. Në rastin e burrave është regjistruar një rritje më e ulët por gjithsesi e dukshme, përkatësisht nga 6,7% në 8,2%.

Figura 14

### Pjesa e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje, në raport me numrin total të incidenteve në BP, sipas gjinisë së viktimave dhe vitit



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë


### Karakteristikat e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje

Në kontekstin familjar, keqpërdorimi i armëve të zjarrit ndodh më shpesh në kuadër të dhunës nga partneri intim se sa në kuadër të dhunës nga anëtarët e tjerë të familjes. Gjatë

periudhës 2019-2023, në AVMP u regjistruan 266 incidente me armë zjarri në kuadër të dhunës nga partneri intim dhe 186 incidente në kuadër të dhunës nga anëtarët e tjerë të familjes.

Figura 15

### Incidentet e lidhura me armët e zjarrit në BP, sipas autorit (partnerët intim dhe anëtarët e tjerë të familjes), 2019-2023




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Numri i incidenteve të regjistruara të kryera nga partnerët intimë u rrit më ndjeshëm dhe pothuajse u dyfishua në pesë vite, nga 36 në vitin 2019 në 70 në vitin 2023. Numri i incidenteve

të kryera nga anëtarët e tjerë të familjes u rrit gjithashtu ndjeshëm, edhe pse në një masë më të ulët dhe me më tepër luhatje krahasuar me rastet e përfshirjes së partnerëve intimë.

Figura 16

**Numri i incidenteve të lidhura me armët e zjarrit në BP, të kryera nga partnerët intimë dhe anëtarët e tjerë të familjes, sipas vitit**




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

**Dallimet në modelet e viktimizimit nënvizojnë diferencat e konsiderueshme gjinore në përvojat e dhunës në familje.** Të dhënat e AVMP-së tregojnë një tendencë të vazhdueshme sipas së cilës gratë preken në mënyrë joproporcionale nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga partnerët intimë dhe

përbënin 97,7% të viktimave të dhunës me armë zjarri nga partneri intim gjatë periudhës 2019-2023. Siç tregohet nga grafiku më poshtë, numri i burrave të prekur nga dhuna me armë nga partnerët e tyre ka mbetur në nivele vazhdimisht të ulëta dhe në disa vite, nuk janë raportuar fare incidente të tilla.

Figura 17

**Viktimat e incidenteve me armë zjarri të kryera nga partnerët intimë në BP, sipas gjinisë dhe vitit**




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Gratë e grupmoshës 36 deri në 60 vjeç kanë më shumë gjasa që të përjetojnë dhunë në familje me armë zjarri, pasuar nga ato të grupmoshës 19-35 vjeç dhe 61 vjeç e lart. Kjo shpërndarje moshore e viktimave është dokumentuar në rajon nga AVMP-ja e SEESAC dhe nga të dhënat zyrtare të siguruara nga MB-të në rajon.

Nga ana tjetër, burrat kanë më shumë gjasa që të bien viktimat të keqpërdorimit të armëve të zjarrit nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes. Në rastet kur gjinia e viktimave është bërë e ditur, burrat përbënin 72,3% ndërsa gratë 27,7% të totalit të viktimave.

Figura 18

### Viktimat e incidenteve me armë zjarri të kryera nga anëtarët e tjerë të familjes në BP, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Ashtu siç u përmend edhe më lart, gratë dhe burrat e grupmoshës 36-60 vjeç ishin më të ekspozuar ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit, kryesisht nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes.

Edhe pse informacionet e detajuara mbi rrethanat e incidenteve janë të kufizuara, të dhënat e disponueshme tregojnë se në përgjithësi incidentet ndodhin ndërmjet anëtarëve të rrethit të ngushtë familjar, kryesisht ndërmjet baballarëve dhe djemve, pavarësisht nëse janë viktimat apo autorët. Për më tepër, janë regjistruar mosmarrëveshje edhe ndërmjet vëllezërve, si dhe incidente që përfshijnë anëtarët e rrethit më të gjerë familjar, si nipërit, kunetërit dhe kushërirët. Motivet e këtyre incidenteve janë të ndryshme dhe përfshijnë mosmarrëveshjet familjare, konfliktet e pazgjidhura të pronës dhe abuzimin për një kohë të gjatë. Mosmarrëveshjet e lidhura me pronat janë një faktor i rëndësishëm në shumë incidente, duke përfshirë në ato që lidhen me trashëgiminë, mosmarrëveshjet financiare,

konfliktet mbi pronësinë e tokës, dhe në disa raste, problemet e shëndetit mendor.

Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës nga partneri intim ndikon jo vetëm te partneri i dhunuar, por edhe tek anëtarët e tjerë të familjes, apo individët e pranishëm në “vendngjarje”. Gjatë pesë viteve të analizuar, 38 burra dhe 22 gra janë prekur nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, ndërsa gjinia e 20 viktimave të tjera nuk është raportuar. Të dhënat e kufizuara konfirmojnë gjithashtu se edhe fëmijët bëjnë pjesë te personat e prekur.

Për sa i përket vendndodhjes, incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në Ballkanin Perëndimor kishin shumë më tepër gjasa që të ndodhnin në zonat urbane se sa në ato rurale, përkatësisht 65,4% dhe 34,6%. Përgjatë vitit të kaluar, ku incidentet në zonat rurale ishin pak më të shpeshta (52%) se në zonat urbane, dhe Mali i Zi, ku shumica dërrmuese e incidenteve ndodhnin në zonat urbane (90,3%).

Në mbarë rajonin, armët e zjarrit kishte më shumë gjasa të përdreshin në hapësira private, si p.sh. në shtëpi dhe oborre, aty ku u regjistruan 83,2% e të gjitha incidenteve. Këto tendenca vijnë prej kohësh dhe janë në përputhje me

hulumtimin e mëparshëm të SEESAC.

Një në dhjetë incidente kanë ndodhur në rrugë, trotuare, ose parkingje, pasuar nga incidentet në hapësira të tjera publike, si zyrat apo qendrat tregtare.

Figura 19

### Vendndodhja e detajuar e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

## 4.3 Pasoja vdekjeprurëse të incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje

Krejtësisht ndryshe nga nivelet e ulëta të raportimit, keqpërdorimi i armëve të zjarrit ka ndikime të thella dhe të gjera në sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe burrave në rajon, si dhe përbën një sfidë të konsiderueshme në kontekstin e kontrollit të AVL-ve. Efektet e tij kumulative janë të rënda dhe variojnë nga lëndimet fizike me pasojë fatale dhe jo fatale e deri në traumat psikologjike.

Pasojat e rënda të dhunës në familje pasqyrohen nga numri i viktimave nga incidentet me armë zjarri në këtë kontekst. Një analizë e të dhënave të AVMP-së ofron informacione mbi karakteristikat e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, duke mundësuar kuptimin e këtij fenomeni në kuadër të problematikës së gjerë të dhunës me armë në rajon, si dhe


dokumenton pasojat e larta vdekjeprurëse të armëve të zjarrit në këtë kontekst.

Nga viti 2019 deri në vitin 2023, **numri total i vdekjeve nga incidentet me armë zjarri në dhunën në familje (152) ishte më i lartë se në çdo kategori tjetër incidentesh** të mbuluar nga AVMP-ja, duke tejkaluar numrin e viktimave në kontekstet kriminale (144) dhe mosmarrëveshjet në publik (135), të cilat renditeshin përkatësisht në vendin e dytë dhe të tretë, nëse përjashtojmë kategorinë “Të tjera”<sup>41</sup>.

Numri i lartë i viktimave në rastet e dhunës në familje bie në kundërshtim me numrin relativisht të ulët të incidenteve të raportuara, çka nënvizon rreziqet specifike të lidhura me armët e zjarrit, të cilat rrisin gjasat e pasojave fatale.

41 Kategorija “Të tjera”, e cila është një kategori e veçantë në llojet e incidenteve me armë zjarri, u referohet vetëvrasjeve, të shtënave në rrethana të papërcaktuara, të shtënave kundrejt kafshëve që nuk lidhen me gjuetinë, shpërthimeve për shkaqe të papërcaktuara, përdorimit të armëve për mbrojtje dhe të gjitha incidenteve të tjera që nuk mund të klasifikohen në një nga kategoritë e mësipërme.

Figura 20

Numri i vdekjeve me armë zjarri, sipas llojit të incidentit në BP, 2019-2023<sup>42</sup>

Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Janë identifikuar disa faktorë që rrisin probabilitetin e pasojave fatale në një incident të dhunës në familje ku përfshihen armët e zjarrit: shkalla e lëndimeve të shkaktuara nga të shtënat me armë, aftësia e kufizuar e grave për të rezistuar, probabiliteti i ulët për t'u arratisur apo për ndërhyrje nga persona të tjerë, si dhe probabiliteti i lartë i përdorimit të armëve të zjarrit nga abuzuesi.<sup>43</sup>


Në nivel juridiksioni, në Serbi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Maqedoninë e Veriut, numri i viktimave nga incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje tejkalonte numrin e viktimave në të gjitha llojet e tjera të incidenteve. Në Shqipëri, për sa i përket numrit të viktimave, incidentet e dhunës në familje renditeshin në vendin e tretë, pas incidenteve në kontekstet kriminale dhe mosmarrëveshjeve në publik; një

tendencë e ngjashme u vëzhgua në Mal të Zi, ku incidentet e dhunës në familje renditeshin pas kategorisë "Të tjera" dhe kontekstit kriminal, si dhe në Kosovë, ku incidentet e dhunës në familje renditeshin pas kategorisë "Të tjera" dhe mosmarrëveshjeve në publik.

42 Numrat e paraqitur në këtë figurë përfshijnë totalin e viktimave me armë zjarri, pra të burrave, grave dhe personave për të cilët nuk është raportuar gjinia.

43 SEESAC. 2016. *Gjinia dhe AVL-të në Evropën Juglindore*. Beograd: SEESAC., faqja 23.

**Figura 21**  
**Numri i vdekjeve me armë zjarri, sipas llojit të incidentit dhe juridiksionit, 2019-2023<sup>44</sup>**



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë


Në nivel rajonal, numri i viktimave nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje arriti majat në vitin 2020, ndërsa në vitet 2019 dhe 2021, dhuna në familje renditej në vendin e tretë për sa i përket numrit të viktimave. Në vitet 2022 dhe 2023, dhuna në familje renditej në vendin e dytë për sa i përket

numrit të viktimave; megjithatë, vrasjet në masë që ndodhën në vitin 2022 (Cetinje) dhe 2023 (Beograd, Dubona dhe Orašje) patën ndikim të ndjeshëm në këto renditje. Nëse përjashtojmë këto incidente, dhunë në familje do të renditej e para në të dyja vitet për sa i përket numrit të viktimave.

44 Numrat e paraqitur në këtë figurë përfshijnë totalin e viktimave me armë zjarri, pra të burrave, grave dhe personave për të cilët nuk është raportuar gjinia.

Figura 22

### Numri i vdekjeve me armë zjarri në BP, sipas llojit të incidentit dhe vitit




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Në veçanti, viti 2020 regjistroi numrin më të lartë të vdekjeve të grave dhe burrave, një periudhë kjo që përkoi me vitin e parë të pandemisë dhe që u karakterizua nga masat e

rrepta të izolimit në të gjithë rajonin. Kjo thekson nevojën për hulumtime të tjera mbi mënyrën se si kushtet specifike gjatë COVID-19 kontribuan në këto pasoja.

Figura 23

### Numri i grave dhe burrave të vrarë me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas vitit



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë


Ndikimi joproporcional i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje te gratë është veçanërisht i dukshëm nëse i kategorizojmë

viktimat nga armët e zjarrit sipas llojit të incidentit.


Siç ilustron në figurën më poshtë, **68,4% e grave të vrara me armë zjarri në rajon kanë qenë viktime të dhunës në familje**, një shifër kjo pothuajse tetë herë më e lartë se numri i grave të vrara në kontekstin e veprimtarive kriminale (8,8%), i cili është konteksti i dytë më i përhapur, duke përjashtuar kategorinë “Të tjera”.

Ndryshe nga gratë, burrat përballen me rreziqe shumë më të larta që të vriten në kontekste të tjera, si p.sh. në mosmarrëveshjet në publik (24,9%) dhe kontekstin kriminal (24,3%). Megjithatë, një përqindje e konsiderueshme e burrave të vrarë me armë zjarri kanë humbur jetën në kontekstin e dhunës në familje (10,2%).

**Figura 24**  
**Viktimat gra nga armët e zjarrit, sipas llojit të incidentit në BP, 2019-2023**



**Figura 25**  
**Viktimat burra nga armët e zjarrit, sipas llojit të incidentit në BP, 2019-2023**



■ Dhuna në familje ■ Konteksti kriminal ■ Mosmarrëveshje në publik ■ Të shtënata aksidentale/festive/Gjuetia  
 ■ Vrasjet në masë ■ Mosmarrëveshje me policinë ■ Tjetër/i panjohur

Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Një tendencë e tillë është konstatuar prej kohësh në të gjithë rajonin.

Tabela 4

## Numri i viktimave sipas llojit të incidentit në BP, sipas gjinisë dhe vitit

	2019		2020		2021		2022		2023	
	G	B	G	B	G	B	G	B	G	B
Dhuna në familje	18	10	23	17	17	8	16	11	19	13
Konteksti kriminal	4	26	0	27	3	30	0	27	5	21
Mosmarrëveshjet në publik	0	30	0	24	0	29	1	24	0	27
Të shtënat aksidentale/festive/Gjuetia	1	7	2	15	1	19	3	7	0	9
Vrasjet në masë	0	0	0	0	0	0	4	6	9	10
Mosmarrëveshjet me policinë	0	3	0	2	0	1	0	2	0	7
Të tjera	3	23	2	33	2	28	1	19	2	23
<b>Totali</b>	<b>26</b>	<b>99</b>	<b>27</b>	<b>118</b>	<b>23</b>	<b>115</b>	<b>25</b>	<b>96</b>	<b>35</b>	<b>110</b>

Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Është e qartë se modelet e viktimizimit në dhunën në familje shfaqin dallime të konsiderueshme gjinore dhe prekin gratë në mënyrë joproporcionale. Megjithatë, në terma absolutë, një numër i konsiderueshëm i burrave kanë humbur jetën në kontekstin e dhunës në familje.


Në kontekstin e dhunës në familje, gratë ishin më të rrezikuara nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga partnerët intimë aktualë ose të mëparshëm. Pak më tepër se një në dy gra (69 nga 136) të vrara me armë zjarri në Ballkanin Perëndimor, janë vrarë nga partneri i tyre intim.

Në të njëjtën periudhë, tre burra janë vrarë me armë zjarri nga partnerja intime, çka përbën 0,6% të totalit të burrave të vrarë me armë. Dhuna me armë zjarri nga partneri intim cenon gjithashtu sigurinë e personave të tjerë që mund të jenë të pranishëm. Gjatë periudhës së raportimit, 13 persona në total, përkatësisht 4 gra dhe 9 burra, janë vrarë në këtë kontekst.

Gjithashtu, nga totali i personave të vrarë me armë zjarri, 20 gra (14,7%) dhe 47 burra (8,7%) janë vrarë nga anëtarë të tjerë të familjes, kryesisht të gjinisë meshkuj.

Figura 26


## Ndikimi i ndryshëm gjinor i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje në BP, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Siç tregohet qartë, shumica e viktimave nga incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje janë të lidhura me dhunën nga partneri intim, një tendencë kjo që vijon prej kohësh.

**Figura 27**  
**Vrasjet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas autorit, 2019-2023**




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Në kontekstin e dhunës nga partneri intim me armë zjarri, gratë përballen me rrezik më të lartë të humbjes së jetës nga partnerët e tyre aktualë (75% e rasteve) se sa nga ish-partnerët (25% e rasteve). Këto të dhëna nënvizojnë se, edhe pse në disa raste rreziku mund të ulët pas largimit nga personi abuzues, ai mund të rritet

gjithashtu ndjeshëm gjatë ose pas ndarjes, dhe mund të rezultojë në një pasojë fatale, gjasat e së cilës rriten më tej nga prania e armëve të zjarrit. Për më tepër, të dhënat tregojnë mënyrën se si përdoren armët e zjarrit nga abuzuesi në përpjekje për të rivendosur kontrollin mbi viktimën, një çështje e cila diskutohet më tej në kapitullin 7. Hulumtimi i kryer në Serbi tregoi se periudha ndërmjet momentit të largimit nga autori dhe vrasjes së grave të larguara, varioonte nga disa ditë deri në dy vjet.<sup>45</sup>

**Figura 28**  
**Përqindja e grave të vrara me armë zjarri në BP nga partnerët intimë aktualë dhe të mëparshëm, 2019-2023**



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë


45

Lacmanović. Vedrana. 2021. *Analysis of cases of femicide committed with firearms (June 2017 - June 2020)*. Beograd: UNDP.

Ndikimi joproportional i keqpërdorimit të armëve të zjarrit te gratë është i dukshëm në të


gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, siç tregohet më poshtë.

**Figura 29**  
**Shqipëria, 2019-2023**




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

**Figura 30**  
**Bosnjë-Hercegovina, 2019-2023**




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

**Figura 31**  
**Kosova, 2019-2023**




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

**Figura 32**  
**Mali i Zi, 2019-2023**




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

**Figura 33**  
**Maqedonia e Veriut, 2019-2023**



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

**Figura 34**  
**Serbia, 2019-2023**



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë


## 4.4 Plagosjet

Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje ndikon negativisht në mirëqenien fizike të grave dhe burrave në rajon, duke shkaktuar forma të ndryshme të plagosjeve/lëndimeve trupore. Gjatë pesë viteve të analizuar, u regjistruan nga AVMP-ja në total

60 plagosje me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje. Numri i plagosjeve të regjistruara ka shfaqur luhajtje të konsiderueshme. Më konkretisht, ai arriti pikun në vitin 2019, dhe më pas u ul ndjeshëm gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022, si dhe regjistroi sërish rritje në vitin 2023.

Figura 35

### Numri i plagosjeve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas vitit dhe gjinisë së viktimës



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Në përgjithësi, burrat kishin më shumë gjasa se gratë që të pësonin plagosje me armë zjarri, edhe pse shifrat pësuan luhajtje të konsiderueshme gjatë pesë viteve të analizuar. Në veçanti, në vitin 2023, numri i plagosjeve me armë zjarri ndërmjet burrave dhe grave ishte i njëjtë. Në përgjithësi, numri i plagosjeve me armë zjarri të kryera nga anëtarët e tjerë të familjes ishte më i lartë se në kontekstin e dhunës nga partneri intim.

Për sa i përket rreziqeve, të dhënat rikonfirmuan tendencat e dokumentuara më

parë që tregonin se gratë janë më të rrezikuara nga plagosjet me armë zjarri nga partnerët e tyre intimë, pasi 66,7% e plagosjeve të grave kanë ndodhur në kontekstin e dhunës nga partneri intim. Nga ana tjetër, burrat përballen me një tendencë të kundërt, pasi rrezikojnë kryesisht të plagosen me armë zjarri nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes, apo të jenë viktima të tërthorta në dhunën nga partneri intim (93% e numrit total të plagosjeve të shkaktuara te burrat në kontekstin e dhunës në familje).

## 4.5 Kërcënimet

Edhe pse të dhënat mbi keqpërdorimin e armëve të zjarrit disponohen kryesisht për vrasjet/vrasjet e grave, plagosjet dhe sulmet, armët e zjarrit përdoren gjithashtu si një mjet për të kryer forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, si p.sh. dhunë psikologjike, dhunë seksuale, ku

përfshihet përdhunimi, lëndimi emocional, shtrëngimi, si dhe dhunë ekonomike. Edhe pse këto forma të dhunës zakonisht pasohen nga ngjarje fatale, raportimi i tyre vazhdon të jetë në nivele tejet të ulëta.

Të dhënat e kufizuara mbi rastet e regjistruara të përdorimit të armëve të zjarrit për kërcënime ofrojnë vetëm njohuri të pjesshme rreth këtij fenomeni. Gjatë periudhës 2019-2023, u regjistruan në AVMP një total prej 177 kërcënimesh me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje. Pak më tepër se dy të tretat e këtyre incidenteve kishin ndodhur në kontekstin e dhunës nga partneri intim (67,2%), duke sjellë pasoja për partnerët intimë (95 incidente), si dhe persona të tjerë (24 incidente). Për më tepër, 58 kërcënime ishin kryer nga anëtarët e tjerë të familjes.

Gratë përbënin shumicën e viktimave (69,5%), duke përfshirë të gjitha viktimat e dhunës nga partneri intim.

Edhe pse informacionet e detajuara mbi incidentet që përfshijnë kërcënime me armë zjarri, shpeshherë janë të kufizuara, të dhënat e disponueshme tregojnë se këto kërcënime në kontekstin e dhunës në familje apo të mosmarrëveshjeve familjare zakonisht

përfshijnë gjeste verbale apo fizike që synojnë të trembin apo kërcënojnë viktimat. Natyra e këtyre kërcënimeve është e ndryshme, por shpeshherë përfshin kërcënimet e drejtpërdrejta me vdekje, apo taktikat që synojnë të rrisin frikën, si p.sh. shkrepja e armëve të zjarrit apo shfaqja e armëve të tjera të rrezikshme. Edhe pse në shumicën e rasteve këto kërcënime u drejtohen partnerëve intimë, ato shtrihen edhe tek anëtarët e tjerë të familjes, ku përfshihen fëmijët, prindërit dhe motrat/vëllezërit. Në disa raste, fëmijët janë ekspozuar ndaj dhunës apo kërcënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Për më tepër, në disa raste, autorët kanë pasur precedentë penalë të mëparshëm, historik të dhunës në familje, apo urdhra mbrojtjeje të lëshuar kundër tyre, çka pasqyron tendencat e vazhdueshme të sjelljes abuzive.

Edhe pse shumë prej këtyre armëve ishin pa leje, disa autorë kanë përdorur armët e zjarrit me leje për të lënduar apo kërcënuar viktimat e tyre.

## 4.6 Përmbledhje e të dhënave administrative

Në **Shqipëri**, gjatë periudhës 2019-2021, u regjistruan në total 60 individë si viktimat të vrasjeve të lidhura me marrëdhëniet familjare. Nga këto, në 20 raste autori ishte një partner intim, ndërsa në 40 rastet e tjera autori ishin një anëtar tjetër i familjes. Gratë përbënin shumicën e viktimave të vrasjeve në kontekstin familjar, përkatësisht 78,3% (47 nga 60), ndërsa burrat 21,7% (13 nga 60). Gratë përbënin shumicën e viktimave të vrasjeve, qoftë të kryera nga partnerët intimë (95% të të gjitha viktimave), po ashtu dhe nga anëtarët e tjerë të familjes (70% të të gjitha viktimave), por siç është bërë e qartë tashmë, janë veçanërisht të rrezikuara që të vriten nga një partner aktual apo i mëparshëm. Në kontekstin familjar, burrat janë më të rrezikuar që të vriten nga anëtarë të tjerë meshkuj të familjes (30% e viktimave) se sa nga partneret intime (vetëm një rast i tillë u regjistrua në Shqipëri gjatë periudhës përkatëse trevjeçare). Nga totali i vrasjeve të kryera në kontekstin familjar, 38,3% (23 nga 60) ishin kryer me armë zjarri. Nga totali i vrasjeve nga partnerët intimë, 30% janë kryer me armë

zjarri, ndërsa 42,5% e vrasjeve janë kryer nga anëtarët e tjerë të familjes. Gratë përbëjnë shumicën e viktimave të vrara me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje me 69,6% (16 nga 23), ndërsa burrat 30,4% (7 nga 23). Proporcionalisht, një në tre gra (34%, 16 nga 47) të vrara në kontekstin e dhunës në familje janë vrarë me armë zjarri, ndërsa në rastin e burrave kjo shifër është 53,8% (7 nga 13).

Gjatë të njëjtës periudhë, në **Kosovë**, janë vrarë 39 persona në kontekstin e dhunës në familje, 9 nga partnerët e tyre intimë dhe 30 nga anëtarët e tjerë të familjes. Gratë përbënin 43,6% të totalit të personave të vrarë, ndërsa burrat 56,4%. Gratë përbënin shumicën e viktimave nga partnerët intimë (8 nga 9), ndërsa burrat ishin kryesisht të rrezikuar që të vriteshin nga anëtarët e tjerë të familjes, një kontekst ku burrat përbënin 70% të numrit total të viktimave. 11,8% e grave dhe 27,3% e burrave të vrarë në kontekstin e dhunës në familje, janë vrarë me armë zjarri.

Në **Malin e Zi**, gjatë periudhës 2019-2021, u regjistruan 16 persona u vranë në total në

kontekstin e dhunës në familje, nga të cilat nëntë gra (56,2%) dhe shtatë burra (43,8%). Gratë përbënin shumicën e viktimave nga partnerët intimë (3 gra krahasuar me 2 burra) dhe të viktimave nga anëtarët e tjerë të familjes (6 gra krahasuar me 5 burra). **Nuk disponoheshin të dhëna mbi përdorimin e armëve të zjarrit në këto vrasje.**

Në **Maqedoninë e Veriut**, kishin ndodhur 15 vrasje në kontekstin e dhunës në familje, përkatësisht shtatë gra dhe tetë burra. Gjatë periudhës së raportimit, një nga këto vrasje ishte kryer me armë zjarri.

Në **Bosnjë-Hercegovinë**, u ndanë të dhëna nga Republika e Sërpskas, Kantoni i Sarajevës dhe Kantoni i Zenica-Doboj. Nga viti 2019 deri në vitin 2021, në Republikën e Sërpskas, janë vrarë 19 persona në kontekstin e dhunës në familje, 10 nga partnerët e tyre intimë dhe 9 nga anëtarët e tjerë të familjes. Të gjitha viktimat e dhunës nga partnerët intimë ishin gra (10 nga 10), nga të cilat 7 ishin vrarë nga partnerët aktualë, ndërsa tre nga ish-partnerët. Burrat përbënin shumicën e viktimave të vrara nga anëtarët e tjerë të familjes, përkatësisht 77,8% (7 nga 9), ndërsa gratë 22,2% (2 nga 7). Gjashtë nga

10 gra të vrara nga partnerët intimë (60%) ishin vrarë me armë zjarri.

Gjatë të njëjtës periudhë, në Kantonin e Sarajevës, janë vrarë 10 persona në kontekstin e dhunës në familje, katër nga partnerët e tyre intimë dhe 6 nga anëtarët e tjerë të familjes. Gratë përbënin shumicën e viktimave (3 nga 4) të vrara nga partnerët intimë, ndërsa në rastin e burrave vetëm një viktimë ishte mashkull. Për sa i përket vrasjeve të kryera nga anëtarët e tjerë të familjes, edhe në këtë rast gratë përbënin shumicën (4 nga 6), krahasuar me burrat (2 nga 6). Një grua ishte vrarë me armë zjarri, ndërsa pjesa tjetër e viktimave janë vrarë me mjete të tjera. Po ashtu, nga totali i viktimave nga anëtarët e tjerë të familjes, një viktimë (një burrë) ishte vrarë me armë zjarri.

Në Kantonin e Zenica-Doboj, janë vrarë në total gjashtë persona në kontekstin familjar. Shumica e viktimave, përkatësisht pesë gra, ishin vrarë nga partnerët e tyre intimë, ndërsa një burrë ishte vrarë nga një anëtar tjetër i familjes. Nga këto raste, katër gra ishin vrarë me armë zjarri nga partnerët e tyre, dhe viktimë mashkull ishte vrarë me armë zjarri nga një pjesëtar tjetër i familjes.

## 4.7 Autorët e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje


Dhuna me armë në kontekstet familjare ka natyrë thellësisht gjinore pasi burrat janë identifikuar në mënyrë të vazhdueshme si autorë të incidenteve me armë zjarri. Të dhënat e mbledhura nga ministritë e brendshme në rajon dhe të dhënat e marra përmes AVMP-

së konfirmojnë ekzistencën e vazhdueshme të këtyre tendencave.

Gjatë periudhës 2019-2023, të dhënat nga AVMP-ja tregojnë se burrat përbënin 98,1% të autorëve të këtyre incidenteve, ndërsa gratë vetëm 1,9%.

Figura 36

### Autorët e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas gjinisë, 2019-2023




Ky model është dokumentuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha juridiksionet e

Ballkanit Perëndimor dhe, me përjashtim të luhatjeve të vogla, ka qenë konstant çdo vit.

Figura 37

### Autorët e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas gjinisë dhe vitit



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë


Të dhënat nga ministritë e brendshme të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës i konfirmuan këto tendenca. Për shembull, në Shqipëri, të gjithë autorët e rasteve të raportuara të dhunës në familje me armë zjarri ishin meshkuj (36 në vitin 2019, 30 në vitin 2020, 17 në vitin 2021). E njëjta tendence ekzistonte edhe në Malin e Zi (2 në vitin 2020 dhe 2 në vitin 2021). Në Kosovë,

burrat përbënin gjithashtu shumicën (4 në vitin 2019, 7 në vitin 2020 dhe 4 në vitin 2021, ndërsa numri i grave ishte përkatësisht 1, 1 dhe zero).

Burrat përbënin shumicën dërrmuese të autorëve në rastet e dhunës me armë zjarri, qoftë në incidentet që përfshinin partnerët intimë, po ashtu dhe në ato që përfshinin anëtarët e tjerë të familjes.

Figura 38

### Autorët e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas gjinisë, 2019-2023




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Në rastet kur ekzistonin të dhëna të ndara sipas moshës, u konstatua se shumica e autorëve bënin pjesë në grupmoshën 36-60 vjeç, pasuar

nga ata të grupmoshës 19-35 vjeç dhe më pas individët 61 vjeç e lart. Këto tendenca kanë qenë të njëtrajtshme në të gjithë rajonin.

Figura 39

### Autorët burra të incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në BP, sipas moshës, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

## 4.8 Punonjësit e sektorit të sigurisë nën petkun e autorëve të incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje

Gjatë periudhës 2019-2023, u regjistruan nga AVMP-ja 14 incidente me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje që përfshinin punonjës të sektorit të sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Numri më i lartë i incidenteve, përkatësisht gjashtë, u regjistrua në vitin 2019. Në vitet 2020 dhe 2021, numri i këtyre rasteve u ul në tre për çdo vit, ndërsa në vitet 2022 dhe 2023 u regjistrua vetëm një incident në vit. Për sa i përket vendeve të rajonit, Shqipëria dhe Serbia regjistruan secila nga katër raste, pasuar nga Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi me nga dy raste secila. Gjatë kësaj periudhe, nuk u raportuan incidente në Maqedoninë e Veriut.

Për sa i përket autorëve, 11 ishin oficerë policie, nga të cilët dy oficerë të dalë në pension, ndërsa tre rastet e tjera përfshinin pjesëtarë të personelit ushtarak. Shumica e autorëve, përkatësisht 12 nga 14, ishin burra, ndërsa dy ishin gra. Në aspektin e moshës, nëntë autorë ishin të grupmoshës 36-60 vjeç, dy ishin të grupmoshës 19-35 vjeç ndërsa një autor bënte pjesë në grupmoshën 61 vjeç e lart.

14 incidentet rezultuan në 24 viktima, me një numër të barabartë ndërmjet burrave dhe grave, përkatësisht 11 për secilën gjini. Në dy raste, gjinia e viktimave nuk u specifikua. Shumica e viktimave ishin të grupmoshës 36-60 vjeç,

ndërsa pjesa tjetër në grupmoshat 19-35 dhe 61-100 vjeç.

Në këto incidente u vranë 12 persona (7 gra dhe 5 burra), u plagosën pesë (4 burra dhe 1 grua), si dhe u kërcënuan tre të tjerë (një grua, ndërsa për dy të tjerët nuk u raportua gjinia). Tre prej këtyre incidenteve rezultuan në vrasje-vetëvrasje, të kryera nga dy meshkuj dhe një femër që ishin pjesë e sektorit të sigurisë.

Shumica e incidenteve (78,6%) ndodhën në zonat urbane dhe 21,4% në zonat rurale. Për sa i përket vendndodhjeve specifike të këtyre incidenteve, 57,1% u zhvilluan në banesa, apartamente ose oborret përreth tyre, ndërsa një numër më i vogël ndodhën në hapësira publike, si rrugë dhe godina publike. Në tre raste nuk u raportua vendndodhja e saktë.

Shtatë raste përfshinin armë me leje, ndërsa në dy raste u përdorën armë zjarri të jashtëligjshme. Në pesë raste nuk u raportua lloji i statusit të armëve. Vlen të theksohet se në tre incidente u përdorën armët e shërbimit. Armët e dorës ishin lloji i armëve që u raportua më shpesh, të përdorura përkatësisht në tetë raste, ndërsa në një rast u përdor një pajisje shpërthyes dhe në një rast tjetër një pushkë Kallashnikov. Në katër incidente, lloji i armës nuk u specifikua.

Shumica e incidenteve kanë ndodhur në kontekstin e dhunës nga partneri intim, përkatësisht shtatë raste përfshinin partnerët aktualë dhe një rast një ish-partner. Gjashtë rastet e mbetura përfshinin anëtarët e tjerë të familjes, qoftë rrethin e ngushtë apo të gjerë familjar.

Këto raste nënvizojnë sfidat specifike kur punonjësit e sektorit të sigurisë përfshihen në incidentet e dhunës në familje. Aksesit i tyre

në armët e zjarrit, trajnimi i specializuar dhe njohuritë mbi procedurat institucionale mund të intensifikojnë rrezikun e pasojave të rënda. Gjetjet nënvizojnë nevojën për të shqyrtuar me kujdes politikatat mbi kontrollin e armëve të zjarrit, trajnimin për armët e zjarrit dhe mekanizmat e llogaridhënies në sektorin e sigurisë, si dhe masat parandaluese për të reduktuar rreziqet e lidhura me dhunën në familje në këtë kontekst.

## 4.9 Vrasjet-vetëvrasjet/femicidi-vetëvrasjet

Rastet e vrasjes-vetëvrasjes përkufizohen si incidente në të cilat një individ kryen një ose disa vrasje dhe më pas, zakonisht brenda një periudhe prej 24 orësh, kryen vetëvrasje. Femicidi-vetëvrasja (ose femicidi nga partnerët intimë-vetëvrasja) është një kategori e vrasjes/vetëvrasjes ku një autor kryen vetëvrasje pasi vret një grua e cila është, ose ka qenë, partnerja e tij intime.

Në kontekstin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, femicidi/vetëvrasja dhe vrasja/vetëvrasja janë fenomene të shpeshta. Sipas AVMP-së, gjatë periudhës 2019-2023, u regjistruan në total 51 incidente të tilla.


Vrasjet nga partnerët intimë zakonisht pasohen nga vetëvrasja e autorëve meshkuj. Numri i këtyre incidenteve ka arritur në 36 në total gjatë periudhës pesëvjeçare dhe të gjitha

janë kryer nga meshkujt. Duke qenë se gjatë kësaj periudhe janë vrarë 69 gra nga partnerët e tyre intimë, kjo nënkupton se 52,2% e rasteve të femicidit në kontekstin e dhunës nga partneri intim janë shoqëruar me vetëvrasjen e autorit. Gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare, nuk janë regjistruar raste në të cilat një grua të ketë kryer vrasje të partnerit intim dhe më pas të ketë kryer vetëvrasje.

Numri më i lartë i rasteve të femicidit/vetëvrasjes u regjistrua në Serbi, pasuar nga Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Në Malin e Zi, nuk pati raste të femicidit/vetëvrasjes gjatë periudhës në shqyrtim. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe u regjistruan gjatë raste të mbetura në tentativë të femicidit/vetëvrasjes.

Figura 40

### Numri i rasteve të femicidit-vetëvrasjes në incidentet e dhunës me armë zjarri nga partneri intim, 2019-2023




Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Në të njëjtën periudhë, u kryen 15 vrasje/vetëvrasje nga personat që kishin vrarë më parë

një ose disa anëtarë të familjes. Në 14 raste autorët ishin burra, ndërsa në një rast autorja ishte grua.

Figura 41

### Numri i rasteve të vrasjes/vetëvrasjes në incidentet me armë zjarri kundër anëtarëve të tjerë të familjes, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

## Kutia 2

### Të kuptuarit e vrasjes-vetëvrasjes/femicidit-vetëvrasjes

Pavarësisht ndikimit të tyre të rëndë, hulumtimet e thelluara mbi femicidin të pasuar nga vetëvrasja në Ballkanin Perëndimor vazhdojnë të jenë të kufizuara. Për të trajtuar këtë mangësi, UNDP në Serbi realizoi një studim<sup>46</sup> ku shqyrtonte karakteristikat dhe masat për parandalimin e rasteve të femicidit nga partneri intim/vetëvrasjes me armë zjarri. Studimi synonte të jepte njohuri gjithëpërfshirëse mbi këtë çështje, duke hedhur dritë mbi rrethanat që u paraprinin rasteve të femicidit/vetëvrasjes, faktorët kryesorë dhe karakteristikat e këtyre akteve, pasojat e tyre dhe ndërhyrjet e mundshme nga institucionet dhe komuniteti.

Studimi synonte gjithashtu të identifikonte faktorët specifikë të rrezikut të femicidit/vetëvrasjes. Aksesi në armët e zjarrit, qoftë të ligjshme, apo të lidhura me profesionin ose hobi, shfaqet si rreziku kryesor. Faktorë e tjerë të rrezikut të identifikuar në raportimin mediatik për femicidin/vetëvrasjet përfshinin historikun e dhunës në familje dhe sjelljen shtrenguese të autorëve, në veçanti, përndjekjen, xhelozinë dhe kërcënimet, të cilat zakonisht ndodhnin pas ndarjes nga viktimat. Ekspertët nga organet e prokurorisë, departamentet e policisë, qendrat për punë sociale dhe strehëzat, nënvizojnë gjithashtu zotërimin e armëve të zjarrit, problemet me shëndetin mendor, si abuzimi me alkoolin, dhe çrregullimet psikologjike, si sinjale paralajmëruese kritike.

Në shumicën e rasteve të femicidit/vetëvrasjes me armë zjarri nuk kishte raportime të mëparshme për autorin në institucionet përkatëse. Studimi identifikoi tre modele të ndryshme lidhur me (mos)raportimin:

- 1) Rastet “e padukshme”, të cilat ndahen në tre nënkategori:
  - a) Rastet që kanë kaluar tërësisht pa u vënë re nga askush, pra autorët nuk janë perceptuar

46 Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim. *Karakteristikat dhe masat për parandalimin e rasteve të femicidit nga partneri intim/vetëvrasjes me armë zjarri*. Beograd: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, 2023.

si të aftë për të kryer një krim dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë lupës së institucioneve.

b) Rastet në të cilat anëtarët e familjes dhe miqtë e kanë konstatuar sjelljen obsesive të autorit, xhelozinë, dhunën apo abuzimin me alkoolin, dhe viktima është larguar nga autori, megjithatë dhuna nuk është raportuar kurrë pranë autoriteteve.

c) Rastet në të cilat anëtarët e komunitetit të gjerë e kanë njohur mirë autorin, dhe shpeshherë kanë qenë në dijeni të faktit që e ndiqte apo përndiqte partneren, dhe në të cilat qendrat për punë sociale mund të kenë njohur një anëtar të familjes në kontekste të tjera, por sërish dhuna gjatë marrëdhënies nuk është raportuar.

2) Rastet “e paralajmëruara” u referohen dhunës në marrëdhëniet aktuale apo të mëparshme, të karakterizuara nga xhelozia, përndjekja në mënyrë obsesive, apo problemet e rënda psikologjike. Në këto raste, partnerja është larguar nga autori dhe dhuna është raportuar vazhdimisht tek institucionet, të cilat kanë ndërhyrë. Megjithatë, vlerësimet e rrezikut nuk janë kryer, ose kanë qenë jokonsistente, dhe nuk është zbatuar asnjë masë mbrojtëse e koordinuar përpara se të ndodhte femicidi/vetëvrasja.

3) Rastet “profesioni përbën rrezik”, të cilat mund të përfshihen edhe në dy kategoritë e para. Këto përfshijnë rastet kur autorët kanë profesione që u japin akses tek armët e zjarrit, si p.sh. oficerë policie, rojtarë, apo gjuetarë, akses i cili shton rrezikun e dhunës me pasoja fatale.


Kutia 3

**Perceptimet mbi armët e zjarrit në shtëpi**

Edhe pse gjysma e të anketuarve në Ballkanin Perëndimor, gra dhe burra, në të gjitha juridiksionet, besojnë se mbajtja e armëve në shtëpi nuk ndikon në ndjenjën e tyre të sigurisë, burrat dhe gratë shprehin perceptime mjaft të ndryshme lidhur me ndikimin e armëve të zjarrit te siguria. 26,5% e burrave ndihen më të sigurt me armë zjarri në shtëpi, ndërkohë që pothuajse e njëjta përqindje e grave (26,3%) ndihen më pak të sigurta me armë zjarri në shtëpi.

Figura 42

**Nëse do të kishit armë në shtëpi, a do të ndiheshit...?, sipas gjinisë, 2024**



Burimi: Studimi i SEESAC mbi faktorët që nxisin kërkesën dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor, 2025

Janë dokumentuar dallime të konsiderueshme në rajon, siç tregohet në tabelën më poshtë.

Tabela 5

### Perceptimet mbi armët e zjarrit në shtëpi (në %), sipas juridiksionit, 2025

	Juridiksionet											
	Shqipëria		Bosnjë-Hercegovina		Kosova		Mali i Zi		Maqedonia e Veriut		Serbia	
	B	G	B	G	B	G	B	G	B	G	B	G
<b>Më të sigurt</b>	26,1	10,4	29,7	13,1	29,8	13,8	37,7	16,1	20,9	13	23,6	9
<b>Më pak të sigurt</b>	23,8	37,5	14,1	29,6	12,6	21,3	12,8	17,1	25,4	36,6	11,3	18,9
<b>Nuk ka ndryshim</b>	46,8	49	50	44,8	52,5	55,7	45,5	56,1	45,9	39,9	56,8	61,8

Burimi: Studimi i SEESAC mbi faktorët që nxisin kërkesën dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor, 2025

---

## Kapitulli 5

# Karakteristikat e armëve të zjarrit të përdorura në kontekstin e dhunës në familje dhe procedurat institucionale


## 5.1 Lloji i armëve të përdorura në kontekstin e dhunës në familje

Armët e dorës janë lloji i armëve të zjarrit që përdoren më shpesh në incidentet e dhunës në familje. Sipas të dhënave të AVMP-së për periudhën 2019-2023, armët e dorës janë përdorur në pothuajse gjysmën e rasteve të regjistruara në Ballkanin Perëndimor (203 raste, apo 44,9%). Në vendin e dytë renditen pushkët dhe shotganët, të cilat janë përdorur në

71 raste (15,7%). Përdorimi i disa AVL-ve është dokumentuar në 47 incidente në kontekstin familjar (10,4%), pasuar nga përdorimi i armëve automatike/ushtarake të dokumentuara në 41 incidente (9,1%). Lëndët plasëse janë raportuar në 12 incidente (2,7%), ndërsa pistoletat me gaz janë raportuar në 11 raste (2,1%). Pushkët me ajër janë përdorur në 11 incidente.

Figura 43

### Lloji i armëve të zjarrit të përdorura në incidentet e dhunës në familje në BP, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Tendencat rajonale të përmendura më sipër kanë vijuar në mënyrë të qëndrueshme gjatë periudhës pesëvjeçare të analizuar, ndërkohë që armët e dorës kanë vijuar të jenë lloji i armëve që përdoren më shpesh në incidentet e dhunës në familje, pasuar nga pushkët dhe shotganët. Deri në vitin 2023, armët automatike dhe ushtarake renditeshin në vendin e tretë për sa i përket llojeve më të përdorura të armëve, megjithatë, në vitin 2023, ato u tejkaluan nga rastet e përdorimit të disa AVL-ve, të cilat u regjistruan në një numër më të lartë incidentesh.

Këto tendenca u identifikuan në të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, me

përjashtim të Shqipërisë, ku lloji më i përdorur i armëve ishin pushkët/shotganët dhe armët automatike/ushtarake (23 raste për secilën kategori), pasuar nga armët e dorës me një diferencë të ulët (22 raste).

Në rastet kur ka pasur të dhëna të disponueshme mbi statusin e pronësisë së armëve të zjarrit, është konstatuar në mënyrë të përsëritur se armët e zjarrit pa leje janë raportuar më shpesh se armët e zjarrit me leje. Kjo tendencë është dokumentuar në mbarë rajonin dhe gjatë të gjithë periudhës së analizuar, çka nënvizon një problematikë të vazhdueshme lidhur me përhapjen e armëve të zjarrit të jashtëligjshme.

Megjithatë, duke pasur parasysh sfidat në raportimin e dhunës në familje dhe pasojat specifike të dhunës në familje të identifikuar

përmes AVMP-së, nuk duhet nënvlerësuar keqpërdorimi i armëve të zjarrit të zotëruara në mënyrë të jashtëligjshme.

Figura 44

### Statusi ligjor i armëve të përdorura në incidentet e dhunës në familje në BP, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë


### Keqpërdorimi i armëve të gjuetisë në kontekstin e dhunës në familje

Gjatë periudhës 2019-2023, AVMP-ja regjistroi në total 55 incidente në të cilat autorët përkatës (të gjithë burra) përdorën armët e

gjuetisë në kontekstin e dhunës në familje. Incidente të tilla u regjistruan më shpesh në Shqipëri, Serbi dhe Kosovë.

Figura 45

### Numri i incidenteve me armë zjarri në të cilat autorët kanë përdorur armët e gjuetisë në kontekstin e dhunës në familje në BP, 2019-2023



Burimi: Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë

Armët e gjuetisë janë përdorur më shpesh në dhunën nga partneri intim se sa në incidentet e kryera nga anëtarët e tjerë të familjes, me përkatësisht 33 dhe 21 raste të raportuara. Nga këto, 13 incidente kanë rezultuar në viktima, me përkatësisht tetë gra dhe pesë burra të vrarë, ndërsa katër incidente kanë rezultuar në plagosje. Në 35 raste janë përdorur armë zjarri për të kërcënuar viktimat.

\*\*\*

Edhe pse nuk janë disponuar të dhëna të krahasueshme për të gjitha juridiksionet, të dhënat e ndara nga ministritë e brendshme në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë ofrojnë njohuri shtesë mbi llojet e armëve të përfshira dhe procedurat e ndjekura në rastet e dhunës në familje.

Gjatë periudhës 2019-2021, në **Shqipëri**, janë sekuestruar përkohësisht në kuadër të incidenteve të dhunës në familje 31 armë zjarri të mbajtura në mënyrë të ligjshme. Edhe pse numri total mbetet i ulët, është dokumentuar një rritje në vitin 2021 (20 sekuestrime), krahasuar

me vitet e mëparshme (6 në vitin 2019, 5 në vitin 2020). Në shumicën e rasteve (29 nga 31), këto armë zjarri nuk janë keqpërdorur gjatë incidentit të raportuar. Gjatë të njëjtës periudhë, janë konfiskuar në total 1977 armë zjarri të jashtëligjshme, nga të cilat një përqindje relativisht e vogël prej 3,4% (68 nga 1977) janë sekuestruar në kuadër të incidenteve të dhunës në familje. Në 23 nga 68 incidente të dhunës në familje në të cilat janë konfiskuar armë zjarri të jashtëligjshme, autorët i kanë keqpërdorur armët e zjarrit, ndërsa në 45 raste, autorët kanë pasur në zotërim armë zjarri të jashtëligjshme, por nuk i kanë përdorur gjatë incidentit të raportuar.

Revolverët, pistoletat me vetëmbushje, pushkët, karabinat dhe automatikët, ishin llojet më të sekuestruara dhe të konfiskuara të armëve të zjarrit, dhe përbënin rreth dy të tretën e të gjitha armëve. Më pas vinin shotganët (duke përfshirë pushkët e gjuetisë) me 18,6%, armët me fishekë manovër me 8,6%, si dhe pushkët automatike, mitralozat e lehtë dhe lëndët plasëse me 4,3%. Në vitin 2020, u kapën 14 kallëpe me lëndë plasëse të llojit tritol (TNT).

Tabela 6

### Llojet e armëve të zjarrit të kapura dhe të konfiskuara në rastet e dhunës në familje në Shqipëri, në % dhe copë, 2019-2021

Revolverë dhe pistoleta me vetëmbushje	22	31,4%
Pushkë, karabina dhe shotganë (duke përfshirë armët e gjahut)	13	18,6%
Automatikë	22	31,4%
Pushkë automatike dhe mitraloza të lehtë	4	5,7%
Armë me gaz	6	8,6%
Pajisje shpërthyesë	3	4,3%

Burimi: Ministria e Brendshme e Shqipërisë

Në **Bosnjë-Hercegovinë**, gjatë të njëjtës periudhë, u sekuestruan përkohësisht në total 849 copë armë zjarri të zotëruara në mënyrë të ligjshme. Gjatë periudhës 2019-2021, në Shqipëri, janë sekuestruar përkohësisht në kuadër të incidenteve të dhunës në familje njëzet

e dy copë armë zjarri të mbajtura në mënyrë të ligjshme. Tridhjetë armë zjarri janë sekuestruar në rastet e dhunës në familje në të cilat autori i dhunës ka pasur në zotërim një armë zjarri, por nuk e ka keqpërdorur atë.

Gjatë të njëjtës periudhë, u konfiskuan në total 362 armë zjarri të jashtëligjshme, nga të cilat 38,4% (139 nga 362) u konfiskuan në kuadër të incidenteve të dhunës në familje. Në 7 nga 139 incidente të dhunës në familje në të cilat janë konfiskuar armë zjarri të jashtëligjshme, autori i ka keqpërdorur armët e zjarrit, ndërsa në 12 raste, autori ka pasur në zotërim armë zjarri të jashtëligjshme, por nuk i ka përdorur gjatë incidentit të raportuar.

Në BH, u sekuestruan në total 60 armë zjarri gjatë periudhës së raportimit. Revolverët dhe pistoletat me vetëmbushje ishin armët e zjarrit të sekuestruara dhe konfiskuara më shpesh, me përkatësisht 41,7% të totalit, ndërsa kategoria e automatikëve dhe kategoria e pushkëve, karabinave dhe shotganëve (duke përfshirë armët e gjahut) zinin vendin e dytë, me 23,3% secila. Armët me fishekë manovër dhe pajisjet shpërthyesë përbënin pjesën më të vogël të armëve të zjarrit të sekuestruara dhe të konfiskuara, me përkatësisht 3,3% dhe 8,3%.

Tabela 7

### Llojet e armëve të zjarrit të kapura dhe të konfiskuara në rastet e dhunës në familje në Bosnjë-Hercegovinë, në % dhe copë, 2019-2021

Revolverë dhe pistoleta me vetëmbushje	25	41,7%
Pushkë, karabina dhe shotganë (duke përfshirë armët e gjahut)	14	23,3%
Automatikë	14	23,3%
Pushkë automatike dhe mitraloza të lehtë	/	/
Armë me gaz	2	3,3%
Pajisje shpërthyesë	5	8,3%

Burimi: Ministrinë e brendshme në Bosnjë-Hercegovinë

## 5.2 Miratimi, rinovimi dhe revokimi i lejes duke marrë në konsideratë dhunën në familje

Krahas të dhënave për sekuestrimet dhe konfiskimet e armëve të zjarrit, analiza synonte gjithashtu të siguronte informacion mbi procedurat institucionale për miratimin e lejeve për armë zjarri duke marrë në konsideratë dhunën në familje. Përmbledhja e shkurtër e të dhënave sasiore në këtë paragraf është plotësuar me informacione mbi praktikën e zakonshme që zbatohen nga ekspertët e përfshirë në proceset e dhënies së lejeve për armë zjarri.

Në Shqipëri, gjatë periudhës 2019-2021, 679 banorë aplikuan për leje të re për armë zjarri. Burrat përbënin 99,3% të aplikantëve, ndërsa

gratë 0,7%. Pothuajse një e treta e aplikantëve (216 nga 674) u refuzuan, nga të cilët burrat përbënin 98,1% të totalit. Gjatë të njëjtës periudhë, gjashtë aplikantë (0,9% e totalit të aplikantëve) u refuzuan për arsye të rrethanave, apo shqetësimeve të lidhura me sigurinë, pasi shfaqnin rrezik të mundshëm të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje; të gjashtë këta aplikantë ishin gra. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe u revokuan 31 leje mbi baza të dhunës në familje.

Në **Bosnjë-Hercegovinë**,<sup>47</sup> gjatë periudhës së raportimit (2019-2021), u regjistruan 24 072

kërkesa të reja për leje për armë zjarri. Burrat përbënin 97,8% (23 544) të aplikantëve, ndërsa gratë 2,2% (528). Të dhënat tregojnë se nga 24 072 aplikantë për leje të reja për armë zjarri, të regjistruar gjatë periudhës 2019-2021, 671 aplikantë u refuzuan. Burrat përbënin 96% (645) të aplikantëve të refuzuar, ndërsa gratë 4% (26). Gjatë të njëjtës periudhë, 134 aplikantë (0,6% e totalit të aplikantëve) u refuzuan për shkak të një dënimi të mëparshëm penal për dhunë në familje, ose për një kundërvajtje që përfshin elemente të dhunës në familje; të gjithë këta aplikantë të refuzuar ishin burra. Për më tepër, 107 aplikantë (0,4% e totalit), nga të cilët 102 burra dhe pesë gra, u refuzuan për shkak të rrethanave, apo shqetësimeve të lidhura me sigurinë, pasi shfaqnin rrezik të mundshëm të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje.

Gjatë periudhës së raportimit, u sekuestruan përkohësisht 2416 copë armë zjarri të ligjshme, përkatësisht 998 në vitin 2019, 783 në vitin 2020 dhe 635 në vitin 2021.

Nga viti 2019 deri në vitin 2021, u iniciuan 2659 procedura për revokimin e lejes. Në vitin 2019, u iniciuan 978 procedura për revokimin e lejes, shifër e cila u rrit në 1002 në vitin 2020 dhe u ul në 679 në vitin 2021. Burrat përbënin shumicën me 97,2% të procedurave të iniciuara, ndërsa gratë 2,8% të procedurave.

Gjatë periudhës së raportimit, u revokuan 3169 licenca/leje për armë zjarri. Bazuar në të dhënat e dorëzuara, dhuna në familje ishte përdorur rrallë si arsye për revokimin e lejes (9 leje në total ishin revokuar si rezultat i dhunës në familje). Këto shifra të ulëta mund të lidhen me praktikën e regjistrimit të të dhënave, pasi nuk japin detyrimisht informacion mbi arsyet e revokimit të lejeve dhe rrjedhimisht, kërkojnë një analizë të mëtejshme të imtësishme.

Në **Maqedoninë e Veriut**, gjatë periudhës 2019-2021, 18 883 banorë aplikuan për leje të re për armë zjarri. Burrat përbënin 99,3% (18,743) të aplikantëve, ndërsa gratë 0,7% (140). Pothuajse një e treta e aplikantëve u refuzuan (6173 nga 18,883), nga të cilët burrat përbënin 99,7% të totalit, ndërsa gratë 0,3%.

Nuk disponoheshin të dhëna për arsyet e refuzimit të lejeve për armë zjarri, çka e bën të pamundur të përcaktohet numri i rasteve në të

cilat dhuna në familje është përdorur si arsye për revokimin.

Gjatë periudhës së raportimit, u sekuestruan përkohësisht 386 armë zjarri të ligjshme, nga të cilat, 24 u sekuestruan përkohësisht mbi baza të dhunës në familje.

Gjatë periudhës në shqyrtim, u iniciuan në total 386 procedura për revokim. Gjatë të njëjtës periudhë, u revokuan 29 leje për shkaqe të dhunës në familje, dhe burrat përbënin 100% të personave të cilëve ju revokuan lejet. Nga numri total (386) i procedurave të iniciuara për revokimin e lejes, 7,5% u revokuan për shkaqe të dhunës në familje. Në vitin 2019 u revokuan 8 licenca, ndërsa në vitin 2020 kjo shifër u rrit në 11 licenca, dhe në vitin 2021 numri i licencave të revokuara për shkaqe të dhunës në familje u ul në 10.

Gjatë periudhës 2019-2021, numri total i aplikantëve për rinovimin e lejeve për armë zjarri ishte 6064, nga të cilët 19 ishin gra (0,31%) dhe 6045 ishin burra (99,69%). Nuk disponoheshin të dhëna për numrin e aplikantëve të refuzuar për shkak të dënimeve të mëparshme penale për dhunë në familje ose kundërvajtje me elemente të dhunës në familje.


Në **Malin e Zi**, gjatë periudhës 2019-2021, 5368 banorë aplikuan për leje të re për armë zjarri. Burrat përbënin 97,2% të aplikantëve, ndërsa gratë 2,8%. Vetëm 0,9% e aplikantëve u refuzuan (51 nga 5368), nga të cilët burrat përbënin 92,2% të totalit, ndërsa gratë 7,8%. Nuk disponoheshin të dhëna për shkaqet e refuzimit të kërkesave/aplikimeve.

Gjatë periudhës së raportimit, 3493 aplikantë në total aplikuan për leje për armë zjarri, nga të cilët 3447 burra dhe 46 gra. Nga totali i burrave që aplikuan, 2,6% (89) u refuzuan. Asnjë nga gratë aplikante nuk u refuzua. Gjatë periudhës në shqyrtim, u iniciuan në total 19 procedura për revokim. 5 leje për armë zjarri u revokuan në total gjatë periudhës së raportimit, mbajtësit e të cilave ishin të gjithë burra.

---

## Kapitulli 6

# Këndvështrim përtej shifrave: të dhëna cilësore mbi armët e zjarrit dhe dhunën në familje



Në vitin 2023, SEESAC zhvilloi 15 diskutime në grupe fokusi, përmes të cilave mblodhi informacion nga 68 oficerë policie, duke përfshirë nga oficerë të angazhuar në çështjet e dhunës në familje dhe oficerë përgjegjës për miratimin e lejeve për armë zjarri, si dhe nga përfaqësues të 17 organizatave të grave. Objektivi kryesor i mbledhjes së të dhënave cilësore ishte të sigurohej një panoramë më e larmishme e mënyrave se si armët e zjarrit prekin viktimat e dhunës në familje, duke u fokusuar veçanërisht në aspektet që nuk arrijnë të kapen nga të dhënat sasiore. Diskutimet mbuluan gjerësisht rreziqet

e lidhura me armët e zjarrit dhe procedurat institucionale, si dhe përfshinë rekomandimet e ekspertëve për të përmirësuar praktikën aktuale.

Gjetjet kryesore të këtyre diskutimeve në grupet e fokusit u organizuan bazuar në tre çështje tematike:

1. Roli i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje,
2. Përgjigja institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit,
3. Proceset e miratimit të lejeve për armë zjarri dhe dhuna në familje.

## 6.1 Roli i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit nënvizuan ndikimin e thellë dhe të shumanshëm të armëve të zjarrit te siguria dhe mirëqenia e viktimave të

dhunës në familje, si dhe rreziqet specifike që paraqesin armët e zjarrit në këtë kontekst.

### 6.1.1 Shtrëngimi, kontrolli dhe pengesat ndaj raportimit

Armët e zjarrit funksionojnë si mjete shtrëngimi dhe kontrolli në marrëdhëniet abuzive, duke thelluar pabarazitë ekzistuese të pushtetit dhe hierarkitë gjinore. Përfaqësuesit e organizatave të grave nga vendet e rajonit theksuan se thjesht prania e një arme zjarri është një mjet i fuqishëm për autorët për të ushtruar kontroll, duke argumentuar se keqpërdorimi i armëve të zjarrit nuk duhet të përkuftizohet ngushtësisht sikur përfshin thjesht kërcënimet e qarta, lëndimet, sulmet apo rastet e femicidit. Pjesëmarrësit përmendën shumë raste në të cilat abuzuesit kanë përdorur armët e zjarrit për të frikësuar gratë, si dhe për t'i kërcënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, duke treguar kapacitetin e tyre për të shkaktuar lëndime të rënda.

Prania e armëve të zjarrit redukton akoma më shumë gjasat që viktimat të raportojnë dhunën, duke kontribuar kështu në nivelet vazhdimisht të ulëta të raportimit të dhunës në familje. Shpeshherë, gratë ngurrojnë të raportojnë incidentet, veçanërisht në rastet kur armët e zjarrit janë të pranishme, si pasojë

e frikës së përshkallëzimit të dhunës dhe hakmarrjes nga abuzuesi. Shpeshherë, objektivi parësor i viktimave nuk është që abuzuesi të ndiqet penalisht, por që të ndalojë dhuna. Shumë viktimat raportojnë praninë e armëve të zjarrit vetëm pasi arrijnë një nivel të caktuar të ndjenjës së sigurisë, si p.sh. pasi janë vendosur në strehëza, apo gjatë bisedave konfidenciale me përfaqësues të organizatave të grave apo me oficerë ligjzbatues. Ka pasur raste në të cilat gratë kanë ngurruar që të raportojnë hapur praninë e armëve, të cilat shpeshherë ishin pa leje, por kanë shprehur frikën se partneri i tyre synon t'i lëndojë apo vrasë, duke theksuar nevojën për vëmendje të veçantë nga oficerët e policisë.

Për shkak të pranisë së armëve të zjarrit dhe frikës nga keqpërdorimi i tyre, shpeshherë dhuna nuk raportohet në fazën fillestare, duke rezultuar në pasoja edhe më të rënda për viktimat. Siç u nënvizua nga pjesëmarrësit në grupet e fokusit, zakonisht, gratë e raportojnë dhunën vetëm kur mendojnë se jeta e tyre, apo e fëmijëve të tyre, është në rrezik të menjëhershëm.

Kjo vlen edhe për rastet e mosraportimit të armëve të zjarrit të jashtëligjshme/pa leje, në të cilat viktimat fshehin informacione thelbësore si pasojë e frikës. Shpeshherë, viktimat udhëhiqen nga nevoja për t'i dhënë fund dhunës dhe u druhen pasojave ligjore me të cilat mund të përballen autorët, si dhe rrezikut të hakmarrjes. Disa pjesëmarrës sugjeruan se në një kontekst të tillë, organizatat e grave mund të luajnë një rol thelbësor duke lehtësuar barrën mbi viktimat dhe duke njoftuar oficerët ligjzbatues mbi praninë e mundshme të armëve të zjarrit. Përfaqësuesit e organizatave të grave u shprehën se gratë viktimat shpeshherë u kanë treguar atyre për praninë e armëve të zjarrit, por kanë refuzuar që të bëjnë të njëjtën gjë gjatë bisedave me policinë. Për më tepër, ata përmendën raste kur gratë e konsideronin normale praninë e armëve të zjarrit në shtëpinë e tyre dhe nuk e perceptonin si rrezik. Gjithashtu, janë konstatuar raste kur gratë nuk kanë treguar fillimisht për praninë e armëve në momentin që kanë kontaktuar me policinë,

me shpresën që dhuna do të ndalonte, dhe kanë treguar se abuzuesi është i armatosur vetëm pasi janë përballur me dhunë të vazhdueshme. Për më tepër, disa gra nuk kanë qenë në dijeni të pranisë së armëve të zjarrit në shtëpinë e tyre, veçanërisht në rastet kur armët mbaheshin në mënyrë të jashtëligjshme.

Pjesëmarrësit nga policia dhe organizatat e grave ranë dakord se edhe fqinjët dhe anëtarët e komunitetit hezitonin që ta raportonin dhunën dhe praninë e armëve si pasojë e shqetësimeve mbi sigurinë e tyre dhe frikës nga hakmarrja.

Mungesa e mbështetjes efektive nga familja, komuniteti përreth dhe institucionet, mund të çojë në izolimin e viktimave. Shpeshherë, viktimat mund të ndihen se nuk kanë mbështetjen e familjes së tyre, agjencive ligjzbatuese dhe shërbimeve sociale, çka rezulton në një mungesë besimi që i shkurajon ato të raportojnë dhunën në familje. Varësia ekonomike kontribuon gjithashtu në një masë të konsiderueshme në mosraportimin e dhunës në familje.

### 6.1.2 Aspektet kulturore dhe normalizimi i zotërimit të armëve të zjarrit

Aspektet kulturore të lidhura me armët e zjarrit, si pjesë të identitetit të burrave, mund të pengojnë më tej raportimin e dhunës në familje dhe të keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Pjesëmarrësit, në veçanti ata nga Mali i Zi, theksuan se shpeshherë armët e zjarrit shihen si pjesë thelbësore e identitetit të meshkujve, një perceptim mbizotërues i burrërisë, ose një element i domosdoshëm i traditës dhe trashëgimisë familjare. Për shembull, besimi se një familje është e paplotë pa një armë, mund të bëjë që raportimi i një arme zjarri nga ana e një gruaje të konsiderohet një akt “i pafalshëm”. Ky normalizim i armëve të zjarrit shkurajon

raportimin, pasi raportimi i armëve shihet si tradhti ndaj vlerave apo traditave familjare, çka e vështirëson akoma më shumë raportimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit nga gratë që jetojnë në marrëdhënie abuzive. Këto gjetje janë në përputhje me hulumtimin e mëparshëm të SEESAC,<sup>48</sup> dhe theksojnë se niveli në të cilin armët e zjarrit formësojnë konceptet gjinore, në veçanti perceptimet mbi burrërinë dhe maskilizmin, ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin masave për kontrollin e AVL-ve dhe në zbatimin e kuadrove përkatës normativë.

### 6.1.3 Armët e zjarrit si faktorë rreziku

Disponueshmëria e përgjithshme e armëve të zjarrit paraqet rreziqe të konsiderueshme në kontekstin e dhunës në familje. Shpeshherë,

viktimat raportojnë kërcënimet për vrasje dhe theksojnë se shumë prej abuzuesve mund të marrin lehtësisht një armë zjarri, qoftë duke e

blerë apo duke ja marrë dikujt hua. Pjesëmarrësit nga Bosnjë-Hercegovina nënvizuan se numri i madh i armëve të padorëzuara që mbeten në zotërimin e civilëve nga konfliktet e së kaluarës, rrit akoma më shumë nivelin e aksesueshmërisë. Ata nënvizuan lidhjet midis çrregullimeve të stresit post-traumatik (PTSD) të meshkujt dhe nivelit të përhapjes së dhunës në familje. Oficerët e policisë theksuan lidhjen midis mjedisit mbizotërues patriarkal dhe disponueshmërisë së gjerë të armëve të zjarrit, si faktorë që përshkallëzojnë dhunën në familje. Për më tepër, u konstatua se armët e gjuetisë, të cilat janë gjerësisht të përhapura, shpeshherë nuk perceptohen si të rrezikshme pavarësisht incidenteve të shpeshta që kanë ardhur nga gabimet njerëzore gjatë gjuetisë dhe konsumimit të alkoolit.

Armët e zjarrit janë një faktor rreziku i konsiderueshëm drejt përshkallëzimit të dhunës në pasoja fatale, në veçanti në rastet kur gratë tentojnë të largohen nga abuzuesi. Armët e zjarrit dhe lëndët plasëse përdoren gjithashtu për të rivendosur kontrollin mbi një viktimë kur abuzuesi ndjen se po humbet pushtetin.

Një rast nga Bosnjë-Hercegovina tregoi një grua që ishte përpjekur të largohej nga partneri i saj abuziv dhe kishte shkuar në shtëpinë e prindërve. Abuzuesi e kishte kërcënuar se do të shpërthente një bombë nëse ajo nuk kthehej, çka ilustron mënyrën se si armët e zjarrit dhe lëndët plasëse mund të përdoren për të rrënjosur frikë dhe për të ushtruar kontroll. Një organizatë e grave në Malin e Zi dokumentoi një rast në të cilin një bashkëshort, gjatë një debati, nxori armën e tij të zjarrit nga sirtari dhe qëlloi për

vdekje bashkëshorten pasi ajo kërcënoi se do e linte. Në Maqedoninë e Veriut, një person i cili ishte raportuar më parë se kishte kërcënuar verbalisht bashkëshorten e tij, përdori pushkën e gjuetisë për ta vrarë gruan pasi ajo ishte përpjekur të ndahej me të. Policia vendase ishte në dijeni të faktit se ai zotëronte një armë zjarri, por nuk kishte arritur t'ia konfiskonte gjatë hetimeve të mëparshme. Raste të tjera të dokumentuara treguan se edhe armët e zjarrit me leje mund t'i përshkallëzonin incidentet e dhunës, të cilat, pa praninë e një arme, nuk do të kishin rezultuar në pasoja fatale. Kjo nënvizon se potenciali vdekjeprurës i armëve të zjarrit rrit gjasat e pasojave fatale. Krahas viktimave, organizatat e grave theksuan se prania e armëve të zjarrit rrit ndjeshëm frikën e grave nga përdhunimi dhe dhuna seksuale.

Gjithashtu, armët e zjarrit kanë efekte anësore të mëdha tek anëtarët e tjerë të familjes dhe komuniteti, duke përfshirë të fëmijët, të cilët shpeshherë neglizhohen. Pas një rasti të vrasjes/vetëvrasjes, në të cilin bashkëshorti abuzues vrau partneren e tij me armë zjarri dhe më pas kreu vetëvrasje, edhe djali i tyre kreu më pas vetëvrasje si rezultat i pasojave psikologjike.

Armët e zjarrit ulin më tej kapacitetin e grave për të bërë rezistencë. Një pjesëmarrës përshkroi një incident në të cilin një abuzues, i dha viktimës telefonin për të marrë policinë dhe ndërkohë i drejtoi armën duke e kërcënuar se do e vriste brenda pak sekondash dhe duke ja bërë të qartë se nuk ka mundësi që të mbrohet pasi policisë do t'i duhet pesë minuta që të vijë.

#### **6.1.4 Sfidat specifike për grupet e cenueshme**

Gratë nga grupet e cenueshme, si p.sh. gratë në zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara, ose gratë rome, përballen me sfida specifike në raportimin e dhunës, dhe ende mungon informacioni lidhur me ekspozimin e tyre ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Në zonat rurale, si pasojë e rëndësisë simbolike dhe praktike që u atribuohet armëve të zjarrit, si dhe e bindjes së vazhdueshme se dhuna në familje është një çështje private, raportimi i pranisë së

armëve të zjarrit shpesh konsiderohet si një akt i pafalshëm. Situata ndërlikohet edhe më tej nga prania e vakët e policisë në zonat rurale.

Vështirësitë lidhur me raportimin janë veçanërisht më të theksuara te gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë rome, të cilat përjetojnë forma të shumfishta diskriminimi, çka e bën pothuajse të pamundur daljen nga cikli i dhunës. Në rastin e grave me aftësi të kufizuara, u theksua varësia e tyre e vazhdueshme nga abuzuesi

për të përmbushur nevojat bazë. Pengesa e përgjithshme që vjen si pasojë e varësisë ekonomike nga abuzuesi u përmend shpeshherë gjatë diskutimeve. Stigmatizimi kulturor shpesh frenon viktimat nga grupet e cënueshme që të raportojnë kërcënimet me armë zjarri.

Pjesëmarrësit nënvizuan raste të grave dhe

vajzave që janë viktimave të dhunës, si dhe vuajnë nga problemet e shëndetit mendor, duke theksuar se shpeshherë nuk dinë se ku t'i referojnë për asistencë të mëtejshme. Mungesa e strehëzave të posaçme për ofrimin e shërbimeve të specializuara për këta individë, ndërlikon më tej përpjekjet për mbështetje.

### 6.1.5 Punonjësit e sektorit të sigurisë nën petkun e autorëve

Gjatë diskutimeve në grupet e fokusit, oficerët e policisë dhe pjesëmarrësit nga organizatat e grave nënvizuan seriozitetin e incidenteve në të cilat autorët e dhunës në familje janë oficerë policie apo punonjës të sektorit të sigurisë. Këto raste janë veçanërisht sfiduese për viktimat që t'i raportojnë, si pasojë e statusit profesional të autorëve, pozitave institucionale dhe aksesit të tyre tek armët e zjarrit. Në disa raste, këta

autorë marrin gjithashtu mbrojtje joformale dhe shmangin llogaridhënien. Janë raportuar disa incidente specifike në të cilat punonjësit e sektorit të sigurisë kanë përdorur armët e zjarrit të shërbimit apo ato personale për të kërcënuar partneret e tyre apo anëtarët e familjes. Është diskutuar nevoja për vlerësime psikologjike dhe mbështetje periodike për oficerët e policisë për të parandaluar pasojat negative.

## 6.2 Përgjigja institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje

### 6.2.1 Procedurat e policisë dhe vlerësimi i rrezikut

Janë bërë përparime të dukshme në legjislacionin dhe politikat e kohëve të fundit me qëllim trajtimin e dhunës në familje, veçanërisht lidhur me keqpërdorimin e armëve të zjarrit. Protokollat e agjencive ligjzbatuese, të miratuara në mbarë rajonin, si dhe instrumentet për vlerësimin e rrezikut që shoqërojnë këto protokolle, trajtojnë armët e zjarrit si një faktor rreziku, edhe pse në nivele të ndryshme, dhe ofrojnë orientim mbi procedurat e policisë.

Kur u përgjigjen rasteve të dhunës në familje, oficerët e policisë verifikojnë rregullisht regjistrat e armëve për të përcaktuar nëse individ i raportuar zotëron një armë zjarri të ligjshme. Oficeri përgjegjës duhet të marrë gjithashtu informacion mbi faktin nëse janë përdorur armë, ose nëse ka pasur një kërcënim me armë, si dhe mbi vendndodhjen e armës në momentin e raportimit. Në kuadër të procedurave standarde, viktimat pyetet nëse autori zotëron një armë zjarri, megjithatë, një procedurë e tillë nuk

aplikohet gjithmonë dhe janë dokumentuar dallime në procedurat që zbatohen në vendet e rajonit. Nëse konstatohet se autori zotëron armë zjarri të ligjshme, ato sekuestrohen menjëherë pas mbërritjes në vendngjarje, së bashku me lejen përkatëse, dhe shpesh dorëzohen vullnetarisht nga vetë autori. Më pas, nisin procedurat e zakonshme administrative të parashikuara në ligjin për armët.

Nëse, bazuar në informacionin e marrë nga viktimat apo burime të tjera, policia dyshon se autori zotëron armë zjarri të jashtëligjshme, atëherë iniciohet një kontroll për konfiskimin e armës. Oficerët e policisë kanë theksuar se shpeshherë viktimat nuk i raportojnë armët si pasojë e frikës nga hakmarrja, ose mund të mos jenë në dijeni të armëve të jashtëligjshme. Oficerët e policisë nga Maqedonia e Veriut ndanë shembuj nga praktika e tyre, në të cilat viktimat nuk ka qenë në dijeni të armës së zjarrit të zotëruar nga autori, por abuzuesi e ka kërcënuar

se do përdorte armë, duke mbjellë frikë te viktimat.

Edhe pjesëmarrësit nga Kosova përmendën raste kur individët që kanë leje për armë, mund të zotërojnë edhe armë zjarri të tjera të jashtëligjshme. Ata ngritën shqetësime mbi mundësinë që individët të kenë më shumë armë zjarri (në mënyrë të jashtëligjshme) seç lejohen ligjërisht. U ndanë raste nga rajoni në të cilat është dorëzuar vetëm një armë zjarri, ndërsa pjesa tjetër e armëve janë mbajtur të fshehura. Në një rast, policia shkoi në një banesë për të konfiskuar një pistoletë të jashtëligjshme, por përfundoi duke zbuluar dhe sekuestruar disa armë.

Ka të dhëna se oficerët e policisë verifikojnë gjithashtu edhe nëse anëtarët e tjerë të familjes që banojnë në të njëjtën shtëpi zotërojnë armë zjarri. Megjithatë, këto praktika ndryshojnë ndjeshëm në vendet e rajonit, çka thekson nevojën për standardizim të mëtejshëm për të zbutur në mënyrë efektive rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Disa oficerë policie shprehën dilema lidhur me bazat ligjore për sekuestrimin e armëve që zotërohen nga anëtarët e tjerë të familjes, edhe në situatat kur viktimat ka raportuar praninë e armëve të zjarrit në banesë. Në dallim nga ta, një pjesë tjetër u shprehën se kanë sekuestruar vazhdimisht të gjitha armët e zjarrit të pranishme në banesë. Pavarësisht këtyre dallimeve në praktikën e zbatuar, pjesëmarrësit në grupet e fokusit ranë dakord mbi rëndësinë e kryerjes së kontrolleve lidhur me praninë e armëve të zjarrit që zotërohen nga anëtarët e tjerë të familjes, në veçanti duke pasur parasysh numrin e familjeve të mëdha apo të banesave ku jetojnë disa familje së bashku.

Në disa raste, pjesëmarrësit sugjeruan që të realizohej kontroll në banesë për çdo rast të raportuar të dhunës në familje. Duke qenë se diçka e tillë nuk është e mundur në praktikë, disa rekomanduan që të paktën të realizoheshin kontrolle në rastet që përfshijnë shkelësit e përsëritur/recidivistët. Koha e duhur për kryerjen e kontrolleve është thelbësore për të garantuar efikasitetin e përgjigjes së policisë dhe mbrojtjen e viktimave. Gjithashtu, u konstatua se vonesat në kryerjen e kontrolleve në banesë shpeshherë u japin autorëve mundësinë të fshehin armët e zjarrit, duke cenuar më tej

efikasitetin e masave mbrojtëse. Veprimet e papërshtatshme, apo të zbatuara me vonesë nga ana e policisë, vënë akoma më shumë në rrezik sigurinë e viktimës. Organizatat e grave ndanë shembuj të sekuestrimeve të armëve të zjarrit të realizuara me vonesë nga ana e policisë, çka u ka mundësuar autorëve të fshehin armët pas raportimit të dhunës.

Edhe pse është bërë progres, mbeten ende disa sfida në rajon. Vlerësimi i rrezikut është i detyrueshëm, por ka të dhëna që tregojnë se ai nuk kryhet në mënyrë të njëtrajtshme në çdo rast të raportuar të dhunës në familje, ose zbatohet në mënyrë të papërshtatshme. Janë ngritur shqetësime lidhur me faktin se formulari i vlerësimit të rrezikut shpeshherë plotësohet bazuar në gjykime personale, të cilat mund të ndikohen nga perceptimet tradicionale dhe mentaliteti patriarkal, duke u kthyer në faktor që vë në rrezik zbatimin e procedurave në institucionet e përfshirë në rastet e dhunës në familje. Vlerësimi i duhur i rrezikut është thelbësor për të parandaluar ndikimet negative dhe për të mbrojtur viktimat. Kjo perspektivë është ndarë edhe nga përfaqësuesit e organizatave të grave, të cilët nënvizuan se kur janë kryer në mënyrë të kujdesshme, vlerësimet e rrezikut kanë luajtur një rol thelbësor në mbrojtjen e të mbijetuarave. Megjithatë, suksesi i tyre varet nga angazhimi individual dhe njohuritë e oficerëve të përfshirë, çka thekson nevojën për standardizim sistematik dhe ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve. Në disa raste, vlerësimi është zbatuar në mënyrë të papërshtatshme duke përdorur qasjen “zgjidh kutinë”, pa eksploruar plotësisht situatën, apo pa bërë pyetje pasuese të rëndësishme. Zbatimi pengohet nga mungesa e trajnimit mbi qasjet me ndjeshmëri gjinore me në qendër viktimat. Pjesëmarrësit sugjeruan ofrimin e trajnimeve të duhura për oficerët, krijimin e njërive të specializuara për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe zbatimin e protokolleve që priorizojnë sigurinë dhe mirëqenien e viktimave.

Në Malin e Zi, takimet periodike mes ekspertëve që merren me dhunën në familje kanë rezultuar në rritjen e numrit të sekuestrimeve të armëve në rastet e dhunës në familje, duke garantuar që armët të mos u kthehen autorëve.

## 6.2.2 Sfidat në menaxhimin e informacionit

Oficerët e policisë nënvizuan shpesh se, sipas procedurës aktuale, nuk informohen rregullisht mbi faktin nëse një armë e sekuestruar i është kthyer abuzuesit, apo është konfiskuar në mënyrë të përhershme. Ata nënvizuan rëndësinë e faktit që kolegët e tyre në departamentin e çështjeve administrative t'i mbajnë të përditësuar mbi këto vendime, në mënyrë që të mos komprometohet siguria e të mbijetuarave, si dhe e oficerëve të policisë dhe e ofruesve të tjerë të shërbimeve në një rast të caktuar.

Një sfidë specifike për oficerët e policisë është aksesit i tyre në regjistrat e armëve dhe përditësimi i bazave të të dhënave për pronarët e armëve të zjarrit. Në disa raste, ata ngritën shqetësime se bazat e të dhënave mund të mos jenë të përditësuara, nuk mund të aksesohen 24/7 nga oficerët e policisë në vijën e parë, ose janë të paplota, në veçanti kur bëhet fjalë për armët e vjetra ose të paregjistruara.

Për shembull, në Malin e Zi, u krijua një bazë të dhënash elektronike për armët me leje, gjatë periudhës 1993-1995. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i armëve në zotërim të civilëve nuk u përfshinë në këto regjistra elektronikë. Për më tepër, çështje si migracioni apo ndërrimi i jetës së pronarëve të armëve, kanë bërë që disa armë zjarri të mbesin në banesa pa

dokumentacionin e duhur. Për shembull, banorët mund të zotërojnë armët e lëna nga një anëtar i familjes që ka ndërruar jetë, ose nga të afërm që janë shpërngulur në një shtet apo qytet tjetër. Edhe pse mund të ekzistojnë regjistra fizikë të mbajtur nga Ministria e Brendshme, oficerët e policisë që trajtojnë rastet e dhunës në familje nuk kanë akses në këto regjistra. Në Kosovë, çdo rajon ka zyrën përkatëse për dhënien e lejeve për armë zjarri, e cila ka bashkëpunim të mirë me agjencitë ligjzbatuese. Megjithatë, mungesa e një sistemi informacioni të unifikuar për armët me leje, vështirëson gjurmimin dhe monitorimin e armëve të zjarrit të zotëruara në mënyrë të ligjshme. Në Maqedoninë e Veriut, përpjekjet për sekuestrimin e përkohshëm të armëve të zjarrit me leje janë penguar nga ekzistenca e një sistemi elektronik për regjistrimin e armëve të zjarrit që shpeshherë nuk është i përditësuar dhe nuk mund të aksesohet nga oficerët e policisë.

Një shqetësim i rëndësishëm i ngritur nga disa oficerë policie lidhet gjithashtu me kapacitetin për t'i ruajtur në mënyrë të sigurt armët e sekuestruara apo të konfiskuara, pasi jo të gjitha komisariatet e policisë kanë dhoma të përshtatshme për ruajtjen e tyre.

## 6.2.3 Kapaciteti dhe bashkëpunimi ndërsektorial

Një sfidë e përbashkët është mungesa e personelit të policisë të trajnuar posaçërisht për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, e cila thellohet edhe më tej nga niveli i lartë i qarkullimit të stafit, pasi oficerët e rinj kanë nevojë për trajnim, çka pengon progresin në procedurat e policisë. Për të trajtuar këtë problematikë, pjesëmarrësit nënvizuan nevojën për përmirësimin e trajnimeve për oficerët, ngritjen e njësive të specializuara, në rastet kur nuk ekzistojnë, si dhe zhvillimin e protokolleve që prioritetizojnë sigurinë dhe mirëqenien e viktimave. Ata theksuan rëndësinë që punonjësit ligjzbatues të kuptojnë seriozitetin e dhunës në familje dhe të zbatojnë masa për të mbrojtur dhe mbështetur viktimat në mënyrë efektive.

Ekzistojnë gjithashtu sfida në bashkëpunimin ndërsektorial, në veçanti me institucionet e kujdesit shëndetësor, qendrat e mirëqenies sociale (QMS) dhe organet e prokurorisë. Bashkëpunimi në kohën e duhur me prokurorinë është thelbësor për të realizuar kontrolle efektive. Shpeshherë, profesionistët e kujdesit shëndetësor hezitojnë të raportojnë lëndimet e lidhura me dhunën në familje, duke cituar si arsye konfidencialitetin e pacientëve, apo frikën e përkeqësimit të situatave familjare, gjë që pengon zbulimin e hershëm dhe ndërhyrjen në kohë, veçanërisht në rastet që përfshijnë armë zjarri. Gjithashtu, profesionistët e kujdesit shëndetësor në vijën e parë, shpeshherë nuk janë në dijeni të rreziqeve që paraqet zotërimi i armëve të zjarrit

në ambientet familjare të dhunshme.

Sfidat në drejtim të koordinimit ndërmjet policisë, qendrave të mirëqenies sociale, prokurorëve dhe institucioneve të kujdesit shëndetësor, si dhe mungesa e një baze të dhënash të unifikuar për të gjurmuar rastet e dhunës në familje dhe pronarët e armëve të zjarrit në nivel ndërinstytucional, mbeten problematika të vazhdueshme në të gjitha juridiksionet, të cilat vënë në rrezik përpjekjet për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse rreziqet dhe për të monitoruar ndërhyrjet.

Në Shqipëri, Koordinatorët Vendorë kundër Dhunës në Familje, të cilët janë pjesë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për Rastet e Dhunës në Familje, kanë një bazë të dhënash online, të quajtur REVALB, i cili është një sistem gjurmimi kombëtar online për rastet e dhunës në familje që përdoret në nivel vendor, si dhe në nivel qendror nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ai përfshin një opsion që tregon nëse autori zotëron armë

zjarri ose jo. Sistemi REVALB lehtëson kryerjen e vlerësimeve të rrezikut dhe mundëson komunikim dhe koordinim më të mirë ndërmjet agjencive për të monitoruar rastet në mënyrë më efektive.

Gjithashtu, janë nënvizuar shembuj të bashkëpunimit të ndërsjellë pozitiv ndërmjet institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile (OShC). Organizatat e grave kanë bashkëpunuar me policinë për të identifikuar rreziqet, për të zbatuar urdhrat e mbrojtjes dhe për të ndihmuar viktimat.

Presioni nga rastet komplekse të dhunës në familje mund të ndikojë negativisht edhe tek oficerët. Pjesëmarrësit ranë dakord mbi natyrën sfiduese dhe stresuese të punës së tyre, si mendërisht, po ashtu dhe fizikisht. Për më tepër, ata ranë dakord se oficerët e policisë duhet t'u nënshtrohen vlerësimeve psikologjike periodike dhe se disa prej tyre mund të mos jenë të përshtatshëm për të mbajtur armë shërbimi.

## **6.2.4 Përgjigja e sistemit gjyqësor**

Pjesëmarrësit nënvizuan kohëzgjatjen tejet të lartë të procedurave për krimet e kryera në kontekstin e dhunës në familje, çka krijon rrezik që viktimat të sulmohen sërish, pasi konfiskimi i armës nuk garanton që autori nuk do të gjejë një armë tjetër.

Mbetet shqetësuese mundësia që armët e zjarrit të sekuestruara përkohësisht t'u kthehen autorëve që nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë. Edhe pse disa pjesëmarrës u shprehën se, në praktikë, është e vështirë që armët e konfiskuara të zjarrit t'u kthehen pronarëve edhe pas pushimit të akuzave penale (për shkak të arsyeve si presioni i viktimës apo mundësia e pajtimit), u ndanë gjithashtu shembuj të praktikave të kundërta.

Pjesëmarrësit nënvizuan nevojën për një analizë të mëtejshme të detajuar të përgjigjes së sistemit gjyqësor. Organizatat e grave ngritën

problematikën e tolerancës së gjykatave dhe të mungesës së efikasitetit të tyre në trajtimin e krimeve të lidhura me armët e zjarrit dhe dhunën në familje. Nivelet e larta të dënimeve të pezulluara apo të dënimeve me shërbim prove, si p.sh. në 65% të rasteve të dhunës në familje në Bosnjë-Hercegovinë, japin një mesazh shkurajues për viktimat, u japin kurajë autorëve dhe pasqyrojnë nivelin e ulët të zbatimit të kuadrit ligjor. Shpeshherë, gjykatat mbështeten te rrethanat zbutëse, madje edhe në rastet kur armët e zjarrit janë të lidhura qartësisht me dhunën. Gjithashtu, në shumë raste, gjykatat nuk përfshijnë në urdhrat e mbrojtjes një urdhër të menjëhershëm për sekuestrimin e armëve të zjarrit, duke kufizuar ndikimin e ndërhyrjeve ligjore.

## 6.3 Rregullimi i çështjes së mbajtjes me leje të armëve të zjarrit nga civilët: Miratimi dhe revokimi i lejes

### 6.3.1 Kuadri ligjor dhe verifikimet e së shkuarës

Ekzistojnë dispozita të forta ligjore në ligjet për armët dhe për mbrojtjen nga dhuna në familje, të cilat synojnë parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Parandalimi arrihet kryesisht duke **kufizuar aksesin** për aplikantët që kanë kryer, ose që rrezikojnë të kryejnë, akte të dhunës në familje, si dhe **duke sekuestruar armët e zjarrit apo revokuar lejet** në rastet e dhunës në familje.

Legjislacioni për armët e zjarrit përmban kritere kualifikimi gjithëpërfshirëse, dhe parashikon që, për të marrë leje për armë zjarri, aplikantët nuk duhet të kenë dënime të mëparshme penale, duke përfshirë për dhunë në familje, apo kundërvajtje që përfshijnë elemente të dhunës në familje, si dhe nuk duhet të ketë procedura në proces për shkelje/kundërvajtje të tilla. Një kërkesë për leje do të refuzohet nëse ka rrethana që tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren, duke përfshirë në kontekstin e dhunës në familje. Nëse një civil zotëron armë, konstatimi i rrethanave të tilla mund të çojë në sekuestrimin e armëve të zjarrit dhe në nisjen e procedurës së revokimit të lejes.

Procedurat standarde për shqyrtimin e kërkesave/aplikimeve janë të rregulluara gjerësisht. Pas paraqitjes së një kërkesë për leje, nis një verifikim sistematik dhe gjithëpërfshirës i së shkuarës, bazuar në disa burime informacioni, ku përfshihen të dhënat për precedentët penalë dhe kundërvajtjet, regjistrat e policisë dhe bazat e tjera zyrtare të të dhënave. Në përgjithësi, masat mbrojtëse të vendosura në përputhje me ligjet për mbrojtjen nga dhuna në familje, merren në konsideratë gjatë verifikimeve të së shkuarës në rajon, por oficerët nga Maqedonia e Veriut u shprehën se ankesat e regjistruara pranë policisë, apo masat mbrojtëse të përkohshme të vendosura nga një gjykatë civile në rastet e dhunës në familje, nuk merren në konsideratë.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në grupin e fokusit besojnë se kuadri ligjor ekzistues siguron baza të mjaftueshme për të parandaluar në mënyrë efektive fenomenin e keqpërdorimit. Për

shembull, në Shqipëri, zbatimi është tejet i rreptë dhe refuzimet bazohen në çdo lloj indikacioni apo të dhëne për dhunë në familje, edhe pa pasur një vendim të formës së prerë. Pjesëmarrësit në këtë juridiksion përmendën raste kur kërkesat për leje për armë zjarri janë refuzuar për shkak të “marrëdhënieve të trazuara familjare” apo edhe për shkak të dokumentacionit të paplotë.

Praktikat lidhur me “fshirjen/shlyerjen” e dënimeve penale dhe ndikimi i tyre te kërkesat për leje për armë zjarri, ndryshojnë në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor. Në Shqipëri, dënimet e mëparshme i shkualifikojnë kategorikisht aplikantët, edhe nëse ka kaluar periudha e rehabilitimit. Në Bosnjë-Hercegovinë, dënimet e fshira mund të shënohen gjatë verifikimeve të së shkuarës, por nuk mund të shërbejnë si bazë më vete për refuzimin e kërkesës për leje. Megjithatë, oficerët mund t’i konsiderojnë prirjet për dhunë si faktor rreziku. Në Malin e Zi, janë ngritur shqetësime se një person i dënuar për dhunë në familje mund të rifitojë aksesin në armë zjarri nëse dënimi është hequr nga regjistrat e precedentëve penalë. Në Kosovë, aplikantët kualifikohen për të marrë leje pas përfundimit të dënimit të tyre, përveçse kur dënimi është fshirë zyrtarisht.

Në proceset e apelimit administrativ, vendimi i ardhur nga shkalla e parë zakonisht rrëzohet pasi të dhënat operationale dhe verifikimet e së shkuarës nuk kanë të njëjtën peshë si dënimet dhe shpeshherë, nuk ka prova konkrete se arma e zjarrit do të keqpërdoret. U propozua që, në rastin e një personi të dënuar ligjërisht, disa dënime penale, si p.sh. krimet seksuale dhe të dhunshme, të mos fshihen kurrë nga regjistrat.

Në mbarë rajonin është theksuar rëndësia e verifikimeve gjithëpërfshirëse të së shkuarës që shtrihen përtej verifikimeve të bazave të të dhënave administrative dhe që përfshijnë vizitat në terren dhe intervistat. Gjatë një verifikimi të së shkuarës, oficerët e policisë mund të duhet të verifikojnë se nuk ka rrethana të tjera që tregojnë se arma e zjarrit mund të keqpërdoret, si p.sh.

abuzim me drogat dhe alkoolin, marrëdhënie të trazuara me pjesëtarët e familjes dhe fqinjët, sjellje të dhunshme dhe agresive, si dhe çrregullime të sjelljes. Me përjashtim të Kosovës, ku verifikimet e së shkuarës përfshijnë vetëm verifikimin e bazave të të dhënave administrative, në juridiksionet e tjera, ato përfshijnë vizitat në terren dhe intervistat. Megjithatë, janë dokumentuar dallime të konsiderueshme në rajon.

U theksua në veçanti rëndësia e kryerjes së vizitave në terren dhe e intervistimit të pjesëtarëve të familjes, duke pasur parasysh se shumica e rasteve të dhunës në familje nuk raportohen dhe nuk mund të verifikohen në mënyrë efektive vetëm përmes të dhënave për dënimet penale apo kundërvajtjet. Një vlerësim i besueshëm kërkon që verifikimet e së shkuarës të marrin në konsideratë këto specifika dhe të mos kufizohen vetëm tek informacionet në bazat e të dhënave.

Verifikimet e së shkuarës kryhen nga njësia e policisë në vendbanimin e aplikantit. Në rastet kur ka indicie se një aplikant ka sjellje abuzive, por dhuna nuk është raportuar kurrë, oficeri i policisë që kryen verifikimet e së shkuarës luan një rol kyç duke përmendur në raport faktin se aplikanti ka histori të sjelljes së dhunshme dhe agresive. Megjithatë, pjesëmarrësit kanë paralajmëruar se shpeshherë, verifikimet nuk janë kryer në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe se fokusi është vendosur te marrëdhëniet me fqinjët dhe jo me anëtarët e familjes.

Pjesëmarrësit nënvizuan rëndësinë e përkufizimeve të përshtatshme për termat kyçe, në veçanti për “marrëdhënie të trazuara familjare”, për të garantuar një vlerësim të duhur, si dhe për të ulur subjektivitetin dhe anshmërinë. Ata ranë dakord se oficeri i policisë duhet të jetë i ndërgjegjshëm ndaj dhunës në familje për t'i realizuar verifikimet në mënyrën e duhur. Në disa juridiksione, verifikimet përfshijnë intervista me drejtuesit në bashki, anëtarët e ngushtë të familjes, fqinjët, bashkëpunëtorët dhe kolegët, për të minimizuar subjektivitetin e një oficeri të vetëm policie. U ra dakord se oficerët që kryejnë verifikimet e së shkuarës kanë një përgjegjësi të madhe, pasi shpeshherë, vendimi përfundimtar bazohet në opinionet e tyre. Këto verifikime kërkojnë aftësi dhe kapacitete specifike dhe duhet

të realizohen si një proces i vazhdueshëm dhe jo të kryhen brenda një dite të vetme. Pavarësisht rëndësisë që kanë vizitat në terren për të kryer një vlerësim të duhur dhe gjithëpërfshirës, në shumë raste, mungojnë udhëzimet për këto vizita dhe intervista, duke lënë hapësirë për subjektivitet dhe mangësi.

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet oficerëve të policisë që shqyrtojnë kërkesat për leje dhe oficerëve që realizojnë verifikimet e së shkuarës është thelbësor për të pasur një vendimmarrje të besueshme, edhe pse shpeshherë ky bashkëpunim mungon. Në disa raste kontaktohen QMS-të apo organizatat e grave, por kjo mbetet në gjykimin e oficerit përkatës dhe nuk është e parashikuar ligjërisht. U nënvizuan shembuj të qasjeve proaktive, si p.sh. përpilimi i një liste me shkelësit e përsëritur të dhunës në familje dhe dorëzimi i kësaj liste pranë Departamentit të Çështjeve Administrative për të iniciuar procedurat e konfiskimit, apo për të shërbyer si masë paraprake për kërkesat e ardhshme për leje.

Oficerët që merren me miratimin e lejeve u shprehën se duhet bërë kujdes me aplikantët që paraqesin arsye të zakonshme për marrjen një arme zjarri, por që mund të kenë motive të fshehta, çka krijon nevojën për verifikime të arsyeshme për të përcaktuar arsyen reale për zotërimin e armës.

Procesi i rinovimit të lejes kërkon kujdes të veçantë për të garantuar që individit vazhdon të jetë i përshtatshëm për të zotëruar një armë zjarri. Procedurat e thjeshtuara të rinovimit mund të mos arrijnë të kapin ndryshimet në rrethanat e mbajtësit të lejes. Për rrjedhojë, procesi i rinovimit duhet të jetë gjithëpërfshirës, si dhe duhet të përfshijë intervista dhe rivlerësime të ngjashme me ato të realizuara gjatë dhënies fillestare të lejes.

Në disa juridiksione, u konstatua një rritje e numrit të grave që kanë aplikuar për leje për armë zjarri. Në disa raste kjo lidhet me trashëgimin e armëve të zjarrit nga babai, ose me faktin që partnerët e tyre nuk i përmbushnin kërkesat ligjore, çka mund të tregojë për një tendencë të blerjes së kamufluar.

### 6.3.2 Vlerësimi i aftësisë (fizike-mendore)

Procesi i lëshimit të vërtetimeve të aftësisë për miratimin e lejeve për armë zjarri përfshin një sërë sfidash. Një problem i vazhdueshëm është mungesa e vlerësimeve të standardizuara dhe të rrepta të aftësisë (fizike-mendore). Në disa juridiksione, aplikantët mund t'i anashkalojnë kontrollet e aftësisë duke paguar tarifa pranë institucioneve private të kujdesit shëndetësor, dhe në këtë mënyrë, marrin vërtetime me shpejtësi dhe pa kryer kontrollet e duhura të aftësisë. Shpeshherë, pjesëmarrësit nënvizuan nevojën për institucione të specializuara dhe për rritjen e llogaridhënies së profesionistëve të kujdesit shëndetësor, për të garantuar që vlerësimet e aftësisë të jenë të detajuara dhe të besueshme.

Bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe sistemeve të kujdesit shëndetësor në trajtimin e ndryshimeve në shëndetin mendor të mbajtësve të lejeve për armë zjarri, është i ndryshëm në juridiksione të ndryshme dhe shpeshherë i papërshtatshëm. Në disa juridiksione, edhe pse ligji autorizon mjekët që të njoftojnë policinë nëse një person që zotëron leje shfaq ndryshime të konsiderueshme të shëndetit, diçka e tillë rrallëherë ndodh në praktikë. Kjo mungesë komunikimi vjen nga dobësitë sistematike, si mungesa e bazave të të dhënave të integruara, gjë që thekson nevojën për një qasje sistematike sipas së cilës mjekët raportojnë çdo ndryshim të kushteve shëndetësore që mund të ndikojë në aftësinë për të zotëruar një armë zjarri.

### 6.3.3 Monitorimi i ruajtjes së armëve, rinovimi i lejes dhe arsyet për mbajtjen

Praktikat që lidhen me monitorimin e kushteve të sigurta të ruajtjes së armëve variojnë ndjeshëm dhe shpeshherë bazohen më shumë në masa reaktive se sa proaktive. Edhe pse ligji parashikon detyrimin për ruajtje të sigurt, zakonisht, kontrollet realizohen vetëm në përgjigje të raportimeve për dhunë apo shkelje. Janë konstatuar raste të ruajtjes së papërshtatshme, megjithatë, zbatimi i masave përkatëse është sporadik. Inspektimet janë

të rralla si pasojë e burimeve të kufizuara, ose bazohen ndjeshëm tek ankesat dhe nuk realizohen kontrolle rutinë. Shqipëria ofron një shembull të praktikës së mirë, pasi plani vjetor i inspektimeve, që realizohet nga specialistët, verifikon në mënyrë proaktive ruajtjen e sigurt dhe përputhjen e numrave të serisë. Megjithatë, ende ka sfida si pasojë e burimeve njerëzore të kufizuara.

### 6.3.4 Siguria e personelit të angazhuar në miratimin e lejeve


Oficerët përgjegjës për miratimin e lejeve për armë zjarri theksuan natyrën stresuese të punës së tyre, duke përmendur raste në të cilat aplikantët që u janë refuzuar kërkesat kanë ushtruar presion ndaj tyre ose i kanë kërcënuar. Ky shqetësim është veçanërisht i theksuar në juridiksionet ku

gratë përbëjnë shumicën e ekspertëve që merren me miratimin e lejeve për armë zjarri, dhe në juridiksionet ku vendimi përfundimtar u takon pikërisht këtyre oficerëve dhe jo komisioneve të posaçme apo zyrtarëve më të lartë.

---

Kapitulli 7

# Konkluzione dhe rekomandime



## 7.1 Konkluzione

Gjetjet kanë konstatuar se keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje përbën një rrezik të veçantë, thellësisht gjinor dhe tejet vdekjeprurës, dhe cenon në veçanti sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe të burrave në rajon, si dhe përbën një sfidë madhore ndaj përpjekjeve

për kontrollin e AVL-ve. Pasojat e tij janë të rënda dhe variojnë nga lëndimet fizike me pasoja fatale dhe jo fatale e deri në traumat psikologjike.

Për lehtësi referimi, konkluzionet janë grupuar në disa kategori kryesore:

### I. Natyra me bazë gjinore dhe serioziteti i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje

- Në kontekstin e kriminalitetit me armë zjarri, gratë dhe burrat përjetojnë modele të ndryshme viktimizimi, ndërkohë që niveli dhe konteksti i ekspozimit të tyre ndaj dhunës me armë kanë specifika thellësisht gjinore. Një krahasim i konteksteve tregon se gratë kanë pothuajse pesë herë më shumë gjasa se burrat që të përballen me keqpërdorim të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, përkatësisht 29,8% për gratë dhe 6,2% për burrat. Në shifra absolute, gratë përbënin shumicën e viktimave në incidentet e regjistruara me armë zjarri në kontekstin familjar gjatë periudhës 2019-2023, me përkatësisht 62,8%, ndërsa burrat përbënin 37,2% të viktimave.
- Në kontekstin e dhunës në familje, gratë dhe burrat përballen me rreziqe tejet të ndryshme. Të dhënat kanë dokumentuar një tendencë të vazhdueshme të ndikimit joproporcional që ka te gratë keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga partnerët intimë. Më konkretisht, gratë përbënin 97,7% të viktimave të dhunës me armë zjarri nga partneri intim gjatë periudhës 2019-2023, çka nënvizon natyrën me bazë gjinore të këtij fenomeni.
- Nga ana tjetër, burrat kanë më shumë gjasa që të bien viktimë të keqpërdorimit të armëve të zjarrit nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes. Në rastet kur gjinia e viktimave është regjistruar, burrat përbënin 72,3% të viktimave, ndërsa gratë 27,7%. Të dhënat e disponueshme tregojnë se këto incidente ndodhin ndërmjet anëtarëve meshkujt të rrethit të ngushtë familjar, kryesisht ndërmjet baballarëve dhe djemve, pavarësisht nëse janë viktimë apo autorë.
- Pasojat e rënda të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje pasqyrohen qartë

nga numri i lartë i viktimave të regjistruara në këtë kontekst. Gjatë periudhës 2019-2023, janë vrarë me shumë persona në incidentet me armë zjarri të lidhura me dhunën në familje (152 në total - 93 gra dhe 59 burra) se në çdo kategori tjetër incidentesh të mbuluar nga Platforma e Monitorimit të Dhunës me Armë (AVMP), duke tejkalluar numrin e viktimave në kontekstet kriminale (144) dhe mosmarrëveshjet në publik (135).

- Edhe pse një numër i konsiderueshëm i grave dhe burrave janë vrarë në kontekstin familjar, ndikimi joproporcional i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje te gratë është veçanërisht i dukshëm nëse i kategorizojmë viktimat nga armët e zjarrit sipas llojit të incidentit. 68,4% e grave të vrara me armë zjarri në rajon janë vrarë në kontekstin e dhunës në familje, një shifër kjo pothuajse tetë herë më e lartë krahasuar me numrin e grave të vrara në veprimtaritë kriminale. Gjatë të njëjtës periudhë, 10,9% e burrave të vrarë me armë zjarri në rajon janë varë nga anëtarët e tyre të familjes.
- Në kontekstin e dhunës në familje, gratë ishin më të rrezikuara nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga partnerët intimë aktualë ose të mëparshëm. Në Ballkanin Perëndimor, 50,7% e grave të vrara me armë zjarri janë vrarë nga një partner intim, ndërsa vetëm 0,6% e totalit të burrave të vrarë me armë zjarri gjatë të njëjtës periudhë janë vrarë nga një partnere intime. Gratë kanë tre herë më shumë gjasa që të vritet nga partnerët intimë aktualë ose të kohëve të fundit, se sa nga ish-partnerët.
- Në nivel juridiksioni, në Serbi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Maqedoninë e Veriut, numri i viktimave nga incidentet me armë zjarri në

kontekstin e dhunës në familje tejkalonte numrin e viktimave të regjistruara në të gjitha llojet e tjera të incidenteve. Në Shqipëri, për sa i përket numrit të viktimave, incidentet e dhunës në familje renditeshin në vendin e tretë (pas incidenteve në kontekstet kriminale dhe mosmarrëveshjeve në publik). E ngjashme ishte situata dhe në Mal të Zi, ku incidentet e dhunës në familje renditeshin pas kategorisë “Të tjera” dhe kontekstit kriminal, si dhe në Kosovë, ku incidentet e dhunës në familje renditeshin pas kategorisë “Të tjera” dhe mosmarrëveshjeve në publik.

- Në veçanti, viti 2020 regjistroi numrin më të lartë të vdekjeve të grave dhe burrave, një periudhë kjo që përkoi me vitin e parë të pandemisë dhe që u shënjua nga masat e rrepta të izolimit në të gjithë rajonin. Kjo thekson nevojën për hulumtime të tjera mbi mënyrën se si kushtet specifike gjatë COVID-19 kontribuan në këto pasoja.
- Burrat kishin më shumë gjasa se gratë që të pësonin plagosje me armë zjarri, edhe pse shifrat pësuan luhate të konsiderueshme gjatë periudhës pesëvjeçare. Gratë janë më të rrezikuara nga plagosjet me armë zjarri nga partnerët e tyre intimë, ndërsa burrat rrezikojnë kryesisht të plagosen me armë zjarri nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes.
- Dhuna me armë në kontekstet familjare ka natyrë thellësisht gjinore, pasi burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të autorëve në incidentet

që përfshijnë armë zjarri. Gjatë periudhës 2019-2023, të dhënat nga AVMP-ja tregojnë se burrat përbënin 98,1% të autorëve të këtyre incidenteve, ndërsa gratë vetëm 1,9%. Ky model është dokumentuar në mënyrë konsistente në të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor.

- Në rastet kur ekzistonin të dhëna të ndara sipas moshës, u konstatua se shumica e autorëve bënë pjesë në grupmoshën 36-60 vjeç, pasuar nga ata të grupmoshës 19-35 vjeç dhe më pas individët 61 vjeç e lart.
- Sipas AVMP-së, gjatë periudhës 2019-2023, u regjistruan në total 51 raste të vrasjes-vetëvrasjes, kryesisht në kontekstin e femicidit nga partnerët intimë. 52,2% e rasteve të femicidit të kryera me armë zjarri në kontekstin e dhunës nga partneri intim janë pasuar me vetëvrasjen e autorit.
- Gjatë periudhës 2019-2023, u regjistruan nga AVMP-ja 14 incidente me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje që përfshinin punonjës të sektorit të sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Shtatë gra dhe pesë burra janë vrarë në këto incidente, pesë viktima janë plagosur dhe tre persona janë kërcënuar.

## II. Mangësitë në të dhëna dhe mosraportimi i dhunës në familje

Endenukekzistojnë njohuri gjithëpërfshirëse mbi shkallën dhe karakteristikat e problemit si pasojë e kufizimeve në regjistrimin e të dhënave dhe mosraportimin e dhunës në familje.

- Numri i lartë i viktimave në rastet e dhunës në familje bie në kundërshtim me numrin relativisht të ulët të incidenteve të raportuara, çka nënvizon rreziqet specifike të lidhura me armët e zjarrit, të cilat rrisin gjasat e pasojave fatale.
- Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje raportohet shumë më pak krahasuar me llojet e tjera të incidenteve me armë zjarri, duke përfshirë ato në kontekstin

kriminal, mosmarrëveshjet në publik, apo të shtënat për shkaqe të papërcaktuara. Gjatë periudhës 2019-2023, incidentet e lidhura me armët e zjarrit në kontekstet e dhunës në familje përbënin vetëm 3,1% të të gjitha incidenteve të raportuara me armë zjarri, një tendencë e cila vijoi gjatë të gjithë periudhës së analizuar.

- Të dhënat zyrtare të disponueshme e konfirmojnë këtë tendencë. Megjithatë, numri i ulët i incidenteve të raportuara mund të vijë edhe si rezultat i praktikave për regjistrimin e të dhënave, çka sugjeron se nevojitet analizë e mëtejshme për të përcaktuar arsyet e mosraportimit.

- Edhe pse të dhënat mbi keqpërdorimin e armëve të zjarrit disponohen kryesisht për vrasjet/vrasjet e grave, plagosjet dhe sulmet, armët e zjarrit përdoren gjithashtu si një mjet kërcënimi dhe për të kryer forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, si p.sh. dhunë psikologjike, dhunë seksuale, ku përfshihet përdhunimi, lëndimi emocional dhe shtrëngimi, si dhe dhunë ekonomike. Edhe pse shpeshherë këto forma të dhunës pasohen nga ngjarje fatale, raportimi i tyre vazhdon të jetë në nivele tejet të ulëta.

- Të dhënat e kufizuara mbi rastet e regjistruara të përdorimit të armëve të zjarrit për kërcënime ofrojnë vetëm njohuri të pjesshme rreth këtij fenomeni. Gjatë periudhës 2019-2023, u regjistruan në AVMP një total prej 177 kërcënimesh me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje. Pak më shumë se dy të tretat e këtyre incidenteve kishin ndodhur në kontekstin e dhunës nga partneri intim (67,2%), duke sjellë pasoja për partnerët intimë (95 incidente), si dhe persona të tjerë (24 incidente). Për më tepër, 58 kërcënime ishin kryer nga anëtarët e tjerë të familjes.

### III. Armët e përdorura në dhunën në familje

- Armët e dorës janë lloji i armëve të zjarrit që përdoren më shpesh në dhunën në familje, pasuar nga pushkët dhe shotganët, disa AVL, armët automatike/ushtarake, lëndët plasëse dhe armët me ajër.
- Në rastet kur ka pasur të dhëna të disponueshme mbi llojet e pronësisë së armëve të zjarrit, është konstatuar në mënyrë të përsëritur

se armët e zjarrit pa leje janë raportuar më shpesh se armët e zjarrit me leje.

- Gjatë periudhës 2019-2023, AVMP-ja regjistroi në total 55 incidente në të cilat autorët përkatës (të gjithë burra) përdorën armët e gjuetisë në kontekstin e dhunës në familje.

### IV. Gjetjet cilësore mbi sfidat dhe përgjigjen institucionale

Të dhënat cilësore nga diskutimet në grupet e fokusit (DGF) konfirmuan ndikimin e armëve të zjarrit, shfaqën pengesat kryesore ndaj raportimit

dhe identifikuan sfidat specifike në përgjigjen institucionale dhe procesin e dhënies së lejeve.

#### **Shtrëngimi, kontrolli dhe pengesat ndaj raportimit**

- Armët e zjarrit shërbejnë si mjete shtrëngimi dhe kontrolli në marrëdhëniet abuzive, duke thelluar pabarazitë ekzistuese të pushtetit dhe hierarkitë gjinore.
- Prania e armëve të zjarrit ul akoma më tej probabilitetin e kufizuar që viktimat të raportojnë dhunën. Shpeshherë, gratë ngurrojnë të raportojnë dhunën në familje, veçanërisht në rastet kur armët e zjarrit janë të pranishme, si pasojë e frikës së përshkallëzimit të dhunës dhe hakmarrjes nga abuzuesi. Shpesh, dhuna nuk raportohet në fazën fillestare, duke rezultuar në pasoja edhe më të rënda për viktimat.

- Pjesëmarrësit në grupet e fokusit nënvizuan se, zakonisht, gratë e raportojnë dhunën vetëm kur mendojnë se jeta e tyre, apo e fëmijëve të tyre, është në rrezik të menjëhershëm.

- Kjo vlen edhe për rastet e mosraportimit të armëve të zjarrit të jashtëligjshme, në të cilat viktimat fshehin informacione thelbësore si pasojë e frikës nga hakmarrja dhe shqetësimeve lidhur me pasojat e mundshme ligjore për autorët.

- Fqinjët dhe anëtarët e komunitetit hezitojnë gjithashtu që ta raportojnë dhunën dhe praninë apo përdorimin e armëve, si pasojë e shqetësimeve mbi sigurinë dhe frikës nga hakmarrja.

- Armët e zjarrit reduktojnë kapacitetin e viktimave për të bërë rezistencë ndaj sjelljeve të dhunshme.
- Aspektet kulturore të lidhura me armët e zjarrit si pjesë të identitetit të burrave, mund të pengojnë më tej raportimin e dhunës në familje dhe të keqpërdorimit të armëve të zjarrit.
- Disponueshmëria e armëve të zjarrit vijon të jetë e lartë. Armët nga konfliktet e së kaluarës, të cilat nuk janë dorëzuar dhe mbeten në zotërimin e civilëve, rrisin aksesueshmërinë e armëve të zjarrit.
- Armët e zjarrit dhe lëndët plasëse përdoren për të rivendosur kontrollin mbi një viktimitë në rastet kur abuzuesi ndihet se nuk po arrin të ruajë pushtetin. Krahas mundësisë së pasojave fatale,

### Praktikat institucionale dhe sfidat e identifikuara nga ekspertët

- Zhvillimet e kohëve të fundit kanë forcuar kuadrot ligjore dhe të politikave për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës në familje, duke përfshirë keqpërdorimin e armëve të zjarrit.
- Oficerët e policisë në rajon raportuan se, në kuadër të procedura të vlerësimit të rrezikut që kryhen gjatë përgjigjes ndaj rasteve të raportuara të dhunës në familje, ata kontrollojnë rregullisht regjistrat e armëve për të përcaktuar nëse individit i raportuar zotëron një armë zjarri (të ligjshme/me leje).
- Nëse, pas marrjes së informacioneve nga viktimat apo burime të tjera, ekzistojnë dyshime se autori zotëron armë zjarri të jashtëligjshme, atëherë policia kryen një kontroll dhe konfiskon armën.
- Pavarësisht progresit të bërë, vlerësimi i rrezikut nuk kryhet në mënyrë të njëtrajtshme në çdo rast të raportuar të dhunës në familje, ose zbatohet në mënyrë të papërshtatshme.
- Oficerët e policisë theksuan shpeshherë se nuk informohen rregullisht mbi faktin nëse një armë e sekuestruar i është kthyer abuzuesit, apo është konfiskuar në mënyrë të përhershme, gjë që në disa raste mund të komprometojë sigurinë e tyre dhe të viktimës.
- Një sfidë specifike e ngritur nga oficerët e policisë që u përgjigjen rasteve të dhunës në familje është aksesit i tyre i kufizuar në regjistrat e armëve dhe besueshmëria e informacionit

organizatat e grave theksuan se prania e armëve të zjarrit rrit frikën e grave nga përdhunimi dhe dhuna seksuale.

- Armët e zjarrit jo vetëm që kanë pasoja të rënda te viktimat, por kanë edhe efekte anësore të mëdha tek anëtarët e tjerë të familjes dhe komuniteti, duke përfshirë te fëmijët, të cilët shpeshherë janë viktimat jo të drejtpërdrejta në kontekstin e dhunës në familje.
- Gratë nga grupet e cënueshme, si p.sh. gratë në zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara, ose gratë rome, përballen me sfida specifike në raportimin e dhunës, dhe ende mungojnë informacionet lidhur me ekspozimin e tyre ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit.

në bazat e të dhënave për pronarët e armëve të zjarrit.

- Një sfidë e përbashkët në të gjitha juridiksionet është mungesa e personelit të policisë të trajnuar posaçërisht për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Viojnë të ekzistojnë sfida në bashkëpunimin ndërsektorial, por ekzistojnë gjithashtu shembuj të praktikave të mira në mbarë rajonin.
- Mbetet shqetësuese mundësia që armët e zjarrit të sekuestruara përkohësisht t'u kthehen autorëve që nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë, pasi diçka e tillë rrit rrezikun e përsëritjes së dhunës.
- Oficerët e ministrive të brendshme që merren me miratimin e lejeve për armë zjarri u shprehën se, në mbarë rajonin, ligjet për armët përcaktojnë kritere gjithëpërfshirëse kualifikimi, ku parashikohet se çdo aplikant që kërkon miratim për të marrë armë zjarri nuk duhet të jetë dënuar ligjërisht për vepra penale, duke përfshirë për dhunë në familje apo kundërvajtje me elemente të dhunës, ose që ndaj aplikantit të mos jetë nisur asnjë procedurë për vepër penale apo për kundërvajtje.
- Megjithatë, referenca e kufizuar ndaj armëve të zjarrit tregon se dhuna në familje përdoret rrallë si arsye për refuzimin e kërkesave, apo për revokimin e lejeve.
- Në mbarë rajonin, është theksuar rëndësia e verifikimeve gjithëpërfshirëse të së shkuarës

që shtrihen përtej verifikimeve të bazave të të dhënave administrative dhe që përfshijnë vizitat në terren dhe intervistat. Pavarësisht rëndësisë që kanë vizitat në terren për të kryer një vlerësim të duhur dhe gjithëpërfshirës, në shumë raste, mungojnë udhëzimet për këto vizita dhe intervista, duke lënë hapësirë për subjektivitet dhe mangësi.

- Procesi i lëshimit të vërtetimeve të aftësisë mjekësore për miratimin e lejeve për armë zjarri përballet me një sërë sfidash në juridiksione e Ballkanit Perëndimor. Mungesa e vlerësimeve të standardizuara dhe të rrepta të aftësisë (fizike-mendore) është një problem i vazhdueshëm.
- Bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe sistemeve të kujdesit shëndetësor, veçanërisht në trajtimin e ndryshimeve në shëndetin mendor të mbajtësve të lejeve për armë zjarri, është i ndryshëm në juridiksione të ndryshme dhe shpeshherë i papërshtatshëm.

• Gjithashtu, oficerët verifikojnë nëse arsyet për marrjen e një arme zjarri janë të bazuara. Gjatë shqyrtimit të një aplikimi dhe të pajtueshmërisë së tij me kërkesat e parashikuara nga ligji, oficerët theksuan se duhet treguar më shumë kujdes në trajtimin e rasteve kur aplikanti paraqet një arsye të pranueshme për zotërimin e armëve të zjarrit, por mund të ketë motive të fshehta.

- Në përfundim, oficerët përgjegjës për miratimin e lejeve për armë zjarri, në disa raste janë përballur me presion nga aplikantët të cilëve u janë refuzuar kërkesat për leje. Aplikantët e refuzuar kanë ushtruar presion ndaj oficerëve dhe madje në disa raste i kanë kërcënuar.

## 7.2 Rekomandime

Konkluzionet dhe rekomandimet e mëposhtme bazohen në gjetjet kryesore të analizës dhe në masat e propozuara nga pjesëmarrësit në diskutimet në grupet e fokusit. Ato theksojnë nevojën për koordinim ndërmjet kuadrove për kontrollin e AVL-ve dhe kuadrove për parandalimin e dhunës në familje, si një

kusht paraprak thelbësor për parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në përgjithësi.

Për lehtësi referimi, rekomandimet për autoritetet e Ballkanit Perëndimor janë grupuar në disa kategori kryesore:

### I. Ulja e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje – rritja e ndërgjegjësimin dhe reduktimi i përhapjes dhe qarkullimit të armëve të zjarrit në zotërim të jashtëligjshëm

- Të planifikohen dhe zbatohen në mënyrë sistematike programe për legalizimin e armëve në zotërim të jashtëligjshëm dhe të nxitet dorëzimi vullnetar i tyre, si instrumente për uljen e disponueshmërisë dhe zotërimin të jashtëligjshëm të armëve, dhe rrjedhimisht, të keqpërdorimit të tyre në dhunën në familje.
- Të ndërthuren veprimtaritë për legalizimin dhe dorëzimin vullnetar të armëve të zjarrit me përpjekjet për reduktimin e dhunës në familje dhe parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në këtë kontekst.

- Të zbatohen veprimtari gjithëpërfshirëse për rritjen e ndërgjegjësimin dhe programe të tjera të synuara për të informuar banorët mbi rreziqet e lidhura me armët e zjarrit, duke përfshirë mbi keqpërdorimin e tyre në kontekstin e dhunës në familje, si dhe për të trajtuar normat sociale dhe kulturore të lidhjeve midis burrërisë dhe armëve të zjarrit, të cilat mund të pengojnë raportimin.

## II. Përmirësimi i vlerësimeve të rrezikut dhe forcimi i përgjigjes operacionale

- Të garantohet që, në çdo rast të raportuar të dhunës në familje, pa përjashtim, të verifikohet prania e armëve të zjarrit, pavarësisht nëse janë përdorur ose jo, dhe që oficeri i policisë në detyrë që merr raportin të regjistrojë informacionin mbi praninë dhe/ose përdorimin e armëve të zjarrit.
- Të garantohet se procedurat për vlerësimin e rrezikut janë miratuar dhe zbatohen në mënyrë të përshtatshme dhe me shpejtësi për çdo rast të raportuar të dhunës në familje, në përputhje me Konventën e Stambollit dhe legjislacionin e brendshëm.
- Të garantohet se vlerësimi i rrezikut merr në konsideratë të gjitha situatat specifike që përfshijnë armë zjarri, të tilla si: autori ose një tjetër anëtar i familjes (përfshirë viktimën) ka një armë me leje, autori ose një tjetër anëtar i familjes mund të ketë një armë pa leje, autori ka akses në armë zjarri si pasojë e detyrës së tij dhe është i trajnuar për përdorimin e tyre, ose autori mund t'i aksesojë lehtësisht armët e zjarrit.
- Të zhvillohet një grup treguesish të detyrueshëm që mund të lehtësojë kryerjen e një vlerësimi të besueshëm të faktit nëse armët e zjarrit pa leje janë të pranishme në një rast konkret dhe nëse mund të keqpërdoren.
- Të garantohet planifikimi i ndërhyrjes në mënyrë të përshtatshme dhe të garantohet siguria e oficerëve përgjegjës dhe e viktimave të prekura nga dhuna. Të familjarizohen oficerët e parë në vendngjarje me treguesit e rrezikut të lartë.
- Të garantohet se armët e zjarrit me leje në zotërim të autorit të sekuestrohen, pa përjashtim, në çdo incident të raportuar, siç parashikohet në ligjet për armët dhe dhunën në familje, si dhe të inicohen procedurat përkatëse dhe të konfiskohen menjëherë armët pa leje.
- Të garantohet që në rastin e një incidenti të raportuar, të sekuestrohen menjëherë armët që mund të aksesohen lehtësisht nga autori, si p.sh. armët në zotërim të anëtarëve të tjerë të familjes, apo të personave që jetojnë në të njëjtën banesë, ose armët e tjera lehtësisht të aksesueshme.
- Të garantohet që oficerët e parë në vendngjarje të kenë akses të besueshëm, të menjëhershëm dhe në çdo moment (24/7), në bazat e përditësuara të të dhënave për regjistrimin e armëve të zjarrit, për të mbështetur zbatimin e ndërhyrjeve efektive dhe në kohë, duke trajtuar çështjet e aksesit të kufizuar dhe sfidat e besueshmërisë së të dhënave.
- Të garantohet që oficerët e policisë që u përgjigjen një rasti të caktuar të dhunës në familje, të informohen menjëherë nëse arma e sekuestruar i kthehet autorit apo konfiskohet në mënyrë të përhershme, duke pasur parasysh rrezikun e përsëritjes së dhunës në rastet kur armët e zjarrit të sekuestruara përkohësisht i kthehen autorit.
- Të sigurohet ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve për të garantuar njëtrajtshmërinë e vlerësimeve të rrezikut, duke u siguruar që policia dhe oficerët e tjerë të parë në vendngjarje të jenë të trajtuar siç duhet për identifikimin e rreziqeve të lidhura me armët e zjarrit, qoftë të ligjshme apo të jashtëligjshme, në dhunën në familje, dhe që në përgjigjen institucionale të integrohet plotësisht një qasje me në qendër viktimat.
- Të lehtësohet dhe të forcohet bashkëpunimi ndër-institucional ndërmjet agjencive ligjzbatuese, organeve të prokurorisë, institucioneve të kujdesit shëndetësor, qendrave të mirëqenies sociale dhe organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbimeve për gratë dhe viktimat e tjera të dhunës në familje.
- Duke pasur parasysh nivelin e përhapjes së keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, të garantohet që armët e përdorura në këto incidente të gjurmohen siç duhet dhe të ekzaminohen teknikisht me qëllim që këto njohuri të përdoren për të informuar zhvillimin e politikave dhe përgjigjen operacionale. Gjurmimi në mënyrë sistematike i çdo arme zjarri të sekuestruar mbështet tablonë e përgjithshme të inteligjencës për armët e zjarrit të jashtëligjshme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të garantohet se çështjet të cilat përfshijnë autorë që janë oficerë policie apo punonjës të sektorit të sigurisë të trajtohen me kujdesin e duhur, të hetohen në mënyrë urgjente dhe të merren menjëherë masa disiplinore.

### III. Përmirësimi i procedurave për miratimin e lejeve për armë zjarri për civilët

- Të garantohet se regjistri i armëve është gjithëpërfshirës dhe i përditësuar, duke përfshirë me të dhëna sakta për të gjithë pronarët e armëve të zjarrit dhe armët e tyre të zjarrit të regjistruara. Duhet të kryhen kontrole të rregullta për të garantuar besueshmërinë e të dhënave të regjistrit dhe pajtueshmërinë me rregulloret për armët e zjarrit.
- Krahas precedentëve penalë dhe kundërvajtjeve, të garantohet që, gjatë shqyrtimit të një kërkesë për marrjen e armëve të zjarrit, të merren në konsideratë regjistrat operacionalë të policisë, si dhe çdo informacion mbi urdhrat e mbrojtjes dhe masat mbrojtëse të përkohshme.
- Të zgjerohet objekti i verifikimeve të sigurisë në mënyrë që të përfshihen precedentët penalë zyrtarë dhe modelet e dokumentuara të sjelljes së dhunshme nga raportet operacionale.
- Të aplikohet praktika e njoftimit të anëtarëve të rrethit të ngushtë familjar, duke përfshirë partnerët, lidhur me kërkesën e dorëzuar nga anëtari i familjes/partneri për marrjen e një arme zjarri. Këto njoftime duhet të marrin në konsideratë rreziqet e sigurisë me të cilat mund të përballen anëtarët e familjes.
- Të përmirësohen procedurat e verifikimeve të së shkuarës duke integruar intervista të detyrueshme me anëtarët e familjes, përfshirë me partnerët intimë aktualë ose të mëparshëm, si dhe me miqtë, fqinjët apo bashkëpunëtorët, përpara miratimit apo rinovimit të lejes për armë zjarri.
- Këto intervista duhet të zhvillohen me kujdes dhe oficerët e policisë duhet të kenë parasysh se viktimat e dhunës në familje mund të mos jenë të gatshme të flasin hapur me policinë nga frika e dhunës së mëtejshme ose hakmarrjes. Informacioni i dhënë gjatë intervistës duhet të trajtohet si konfidencial. Bashkëshortëve/anëtarëve të familjes duhet t'u ofrohet gjithashtu mundësia për të mos marrë pjesë në intervistë. Kjo vlen veçanërisht për viktimat e dhunës, pasi zhvillimi i një interviste mund të rrezikonte më tej sigurinë e tyre. Nëse vlerësohet se zhvillimi i intervistës mund të përbëjë kërcënim për sigurinë e tyre, duhet të përdoren burime të tjera informacioni. Në çdo rast, partnerët intimë/bashkëshortët duhet të informohen rreth kërkesës së dorëzuar për leje për armë zjarri dhe të kenë të dhënat e kontaktit të nëpunësit kompetent.
- Oficerët e policisë që zhvillojnë këto intervista duhet të jenë të trajnuar siç duhet dhe të zotërojnë njohuritë dhe instrumentet e nevojshme, si udhëzues me pyetje, lista kontrolli dhe materiale të tjera mbështetëse.
- Të standardizohen dhe përmirësohen procedurat për vlerësimet e aftësisë, duke u siguruar që të dokumentojnë në mënyrë të besueshme aftësinë e aplikantëve, duke përfshirë shëndetin mendor dhe historikun e abuzimit me substancat.
- Të garantohet që institucionet e kujdesit shëndetësor të njoftojnë rregullisht departamentet e policisë/MB-së, lidhur me ndryshimet në shëndetin e aplikantëve që mund të ndikojnë në aftësinë për të mbajtur një leje për armë zjarri.
- Të garantohet monitorimi i vazhdueshëm i përmbushjes së kushteve ligjore për zotërimin e armëve, ku përfshihet monitorimi efektiv i kushteve për ruajtjen e sigurt të armëve në banesë, përmes inspektimeve periodike, për të garantuar pajtueshmërinë me standardet ligjore të sigurisë.
- Të garantohet revokimi automatik dhe i përhershëm i lejes për individët e dënuar për dhunë në familje dhe kundërvajtje të dhunshme. Këtu duhet të përfshihet ndalimi i autorëve që të aplikojnë sërish për leje pas fshirjes së dënimeve.
- Gjatë shqyrtimit të një aplikimi, të garantohet që të ushtrohet kujdesi i duhur në trajtimin e rasteve kur aplikanti paraqet një arsye të pranueshme për zotërimin e armëve të zjarrit, por mund të ketë motive të fshehta.

#### IV. Përmirësimi i sistemeve të të dhënave dhe të monitorimit

- Të përmirësohen mekanizmat e mbledhjes së të dhënave për të garantuar që të gjitha incidentet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje të dokumentohen siç duhet.
- Të ngrihen baza të dhënash, apo të përmirësohen bazat ekzistuese të të dhënave, për të lehtësuar monitorimin e: kërkesave të dorëzuara dhe refuzuara për leje për armë zjarri (duke përfshirë ato të lidhura me dhunën në familje); armëve të sekuestruara të zjarrit (duke përfshirë ato të lidhura me dhunën në familje); armëve të zjarrit që u janë kthyer pronarëve pas sekuestrimit mbi baza të dhunës në familje; lejeve të revokuara, si dhe armëve të zjarrit të ligjshme dhe të jashtëligjshme që janë konfiskuar.
- Nevojiten më shumë hulumtime lidhur me:
  1. Arsyet për nivelin e ulët të raportimit të incidenteve të dhunës në familje me armë zjarri,
  2. Ndikimin e kushteve specifike, si p.sh. pandemia e COVID-19 dhe masat e izolimit, në numrin e lartë të vdekjeve në vitin 2020, për të shfrytëzuar mësimet e nxjerra dhe për të reduktuar rreziqet në situata të ngjashme në të ardhmen,
  3. Ndikimin që ka të fëmijët keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje.

#### V. Sigurimi i ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimi i qasjes së ndërlidhur me në qendër të mbijetuarat

- Të ofrohen trajnime për agjencitë ligjzbatuese lidhur me *Udhëzimet rajonale për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve që lidhen me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, Udhëzimet për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri*, si dhe të mbështetet qasja e të nxënësve mes kolegëve duke forcuar më tej grupin rajonal të trajnuesve.
- Të shqyrtohet mundësia e integritimit dhe përfshirjes së Udhëzimeve në procedura standarde të veprimtimit.
- Të zhvillohen trajnime me ndjeshmëri gjinore për të gjithë aktorët institucionalë për të përmirësuar njohuritë e tyre mbi dinamikën gjinore të keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe dhunën në familje, si dhe për të përshtatur më mirë përgjigjet me nevojat e të mbijetuarave.
- Të garantohet që oficerët e policisë që u përgjigjen rasteve të dhunës në familje të jenë të familjarizuar me përdorimin e instrumenteve të zbulimit, si p.sh. qentë K9 dhe detektorët e metalit, dhe që këto instrumente të jenë në dispozicion, sipas nevojës.
- Të garantohet që të gjitha ndërhyrjet në përgjigje të incidenteve të dhunës në familje, si dhe procedurat për shqyrtimin e kërkesave për leje për armë zjarri, të kenë në qendër viktimat; të integrohet një qasje me në qendër viktimat gjatë trajnimeve, duke prioritetizuar njëkohësisht të drejtat dhe sigurinë e viktimave (përfshirë të viktimave të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, si fëmijët), si dhe të garantohet që asistencë të ofrohet me dinjitet dhe respekt.
- Të garantohet që të gjitha ndërhyrjet dhe procedurat të marrin plotësisht në konsideratë pengesat specifike me të cilat përballen gratë nga grupet e cenushme (si p.sh. gratë në zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara, ose gratë romë), të cilat kufizojnë aftësinë e të mbijetuarave për të raportuar dhunën, dhe të garantohet aksesimi në shërbime mbështetëse gjithëpërfshirëse, si strehëzat, ndihma juridike dhe programet e ndihmës financiare.
- Të lehtësohet aplikimi i qasjes ndërsektoriale gjatë shqyrtimit të një kërkesë për leje për armë zjarri dhe të garantohet se njësitë e policisë për dhunën në familje, apo oficerët përgjegjës të policisë, të konsultohen në çdo fazë të procesit të verifikimeve të së shkuarës. Në rast se nevojitet më shumë informacion për të kryer një vlerësim të duhur, të merret në konsideratë konsultimi i qendrave për punë sociale, linjave të ndihmës SOS, strehëzave dhe organizatave të grave që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës në familje, si dhe i mjekëve të familjes.

## VI. Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit rajonal dhe ndarjes së njohurive

- Të lehtësohet shkëmbimi i njohurive ndërmjet juridiksioneve për të ndarë praktikën e mira dhe të harmonizohen qasjet për të përshtatur procedurat e tyre me kuadrot e detyrueshëm ligjorë ndërkombëtarë dhe rajonalë, si dhe me praktikën e mira në parandalimin e dhunës në familje.
- Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet oficerëve të parë në vendngjarje dhe organizatave të grave që merren me dhunën në familje dhe që ofrojnë shërbime për viktimat. Të garantohet përfshirja e organizatave të grave në çdo zhvillim të kuadrove normative apo të politikave lidhur me kontrollin e AVL-ve.

---

## Lista e referencave

---

Gligorijević, Jovana. Pavlović, Sanja dhe Cveticanin Knežević, Hristina. *Guidelines on Media Reporting on Violence against Women*. Beograd: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, 2021.

---

Kippert, Amanda. "What Are the Power and Control Wheels?," 16 gusht 2021.

---

Lacmanović. Vedrana. 2021. *Analysis of cases of femicide committed with firearms (June 2017 - June 2020)*. Beograd: UNDP.

---

OSBE. *OSCE-Led Survey on Violence Against Women: Well-being and Safety of Women - Main Report*. OSBE (2019).

---

"Regional consultations on practical tools to prevent the firearms misuse in gender-based violence." SEESAC, 29 dhjetor 2023. SEESAC.

---

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. *Security Barometer Survey (#SecuriMeter)*. Miratuar. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, 2022.

---

*SEESAC Armed Violence Monitoring Platform*

---

SEESAC. 2006. 'The rifle has the devil inside' – *Gun Culture in South Eastern Europe*. Beograd: SEESAC.

---

SEESAC. 2007. *Firearms Possession and Domestic Violence in the Western Balkans: A Comparative Study of Legislation and Implementation Mechanisms*. Beograd: SEESAC.

---

SEESAC. 2016. *Gender and SALW in South East Europe*. Beograd: SEESAC.

---

SEESAC. 2019. *The Misuse of Firearms in Domestic Violence in South East Europe*. Beograd: SEESAC.

---

SEESAC. 2024. *Guidelines for Assessing and Addressing Risks Related to the Firearms Misuse in Domestic Violence*. Beograd: SEESAC.

---

SEESAC. 2024. *Guidelines for Gender-Responsive Firearms Licence Approval*. Beograd: SEESAC.

---

SEESAC. 2024. *Analysis of Media Reporting on Firearm Misuse in Male Gender-Based Violence against Women in the Western Balkans*. Beograd: SEESAC, 2024.

---

SEESAC. 2025. *Research on Factors Fueling Demand and Misuse of Firearms in the Western Balkans*. Beograd: SEESAC.

---

SEESAC's Gender analysis of SALW control legislation and policies in the Western Balkans - *raportet*

---

SEESAC's In Focus – *Armed Violence Monitors*

---

Stepanov, Biljana. 2022. *Nasilje u porodici – šta govore podaci*. Beograd: UNDP në Serbi.

---

Stevanović Govedarica, Gordana. 2021. *Small arms and light weapons, gender-based violence and domestic violence: analysis of regulatory framework and practice*. Beograd: UNDP në Serbi.

---

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim. *Characteristics and prevention of intimate partner femicide-suicide cases committed with a firearm*. Beograd: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, 2023.

---

UNDP në Serbi. *Reduce Risk Increase Safety - Towards ending SALW misuse in domestic violence context* Project Pamphlet

---

UNDP në Serbi. *Reduce Risk Increase Safety - Towards ending SALW misuse in domestic violence context*. SEESAC. SEESAC, 25 nëntor 2022. SEESAC.

---

“Western Balkan Authorities to Make Firearms Licensing Gender Sensitive.” SEESAC. SEESAC, 1 dhjetor 2022. SEESAC.

---

Organizata Botërore e Shëndetësisë. 2012. *Understanding and addressing violence against women*.

---

---

CIP - Каталогизација у публикацији  
Народна библиотека Србије, Београд

343.54./55  
623.44

**KEQPËRDORIMI i armëve të zjarrit në dhunën në familje në Ballkanin  
Perëndimor** : tendencat kuçe dhe shqetësimet kryesore / [redaktoi Dragan Božanić]. -  
Beograd : UNDP SEESAC, 2025 (Beograd : Bigraf Plus). - 88 str. : graf. prikazi ; 30 cm

Nasl. izvornika: The misuse of firearms in domestic violence in the Western Balkans.  
- Kor. nasl. - Tiraž 50. - Napomene i bibliografske reference uz tekst. - Bibliografija:  
str. [89-90].

ISBN 978-86-7728-396-4 (broš.)

a) Породично насиље б) Ватрено оружје -- Злоупотреба

COBISS.SR-ID 180516873





